

Jeta Arbëreshe

e-mail: jetarbreshe@libero.it - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe> (Mondo Italo-Albanese)

Del nga gjashtë muaj - Semestrale online della Minoranza linguistica storica Albanese d'Italia - Eianina / Purçill (Cs- Italia)

Përmbajtja / Sommario

NGA KATUNDET ARBËRESHË

G.Chiaffitelli

faqe 2

EDITORIALI

Drejtori

f aqe 3

NGA KATUNDET ARBËRESHË

P. Figlia, C.Bellusci, F.Marchianò, C. Mazzei

faqe 4-6

TEKSTE, ZAKONE POPULLORË NGA KATUNDET ARBËRESHË

D., L.Cardamone, N.Russo, T.Guarino, Motimath, D.Moccia

faqe 7-10

GËZIMET E JETËS

D.

faqe 11-14

QISHA BIXANTINE ARBËRESHE

E. protopapas Giordano

faqe 15-19

KUJTIME

Z. Skirò Majit, C.Stamile, I.C.Fortino, D.

faqe 20-27

DORËSHKRIMI ARBËRESH

B. Bilotta, A.Vinca

faqe 28-29

POEZI SHQIPE

I.Gjoni, L.Petoshati, Bajame Hoxha-Celiku, A.Velaj

faqe 30-32

POEZI ARBËRESHE

G.Frate, Z.Beccia, Z.Chiamonte, M. Scilippa

faqe 33-34

KANTAUORET ARBËRESHË

faqe 35

PËRVJETORI I “KALENDARIT TË ARBËRESHVET”(1977-1992/3)

(D.)

faqe 36-44

STUDIME E ARTIKUJ MBI BOTËN ARBËRESHE

N.Merkuri, M.Lubishtani, M.Toçila, Z.Alimemaj, H.Grillo&A.Velaj, D.Tare

faqe 45-61

STUDIME E RECENSIONA MBI “TELET E ZËMRËS” TË BUZËDHËLPËRIT

BajameHoxha-Celiku, K.Kodra, P.Bruni

faqe 62-66

STUDIME E ARTIKUJ MBI BOTËN SHQIPTARE

L. don Gjergji, S.Gashi

faqe 67-74

SEMINARI NDËRKOMBËTAR I PRISHTINËS

faqe 75

BIBLIOGRAFI E PROF. DR. IMRI BADALLAJ-T

faqe 76-77

BIBLIOGRAFI ARBËRESHE MBI REVISTA SHQIPTARE

faqe 78-79

LIBRE E REVISTA

faqe 80

Taksa fokàtik, Mashqitë

Giuseppe Chiaffitelli

ka Mashqita (Pz)

Taksa që Aragonezat e Spanjollat kërkojnë ish “fokàtiku”, thënë ashtu nga fjala “focus” (zjarr, vatër) që nga fëmijë kish të paguaj.

Ndër 17 të majit të vitit 1507, zoti don Konsalvi i Kordovas, më parë sa të lëj Napulin, i dha Llaxarit Mattes kazalin Mashqitë, që ish pa fare gjënd e i lëshoj sa arbëreshet nëng kish paguajën mosnjë taks, kaq ordinarë sa straordinarë.

Të parat që zunë vend klenë suldëtrat e Llaxarit Mattes e prana arrunë tjettrat arbëreshë nga katundat lëtrirë pranë. Po më të shumë klenë, më se një qënd fëmijë, Koronëtë, që arrunë Mashqitë tek viti 1534 pas që ra Korone, e Karli V bëri paqen me Solimanin I. At’hera ishan zotra dherëvet të Mashqitës Peshpëku Vënozës e Priorati Shën Sepullkrit të Barit, që i shitëtin ta viti 1539 zotit don Giovanni-t de Icic.

Arbëreshet (Mashqitanet), të shprishura ndër dherat, ndë kalidha e pa shpi guri, vejan tura vjedhur e tura bënë shumë dëma, kaq sa “viçerrëgji”, don Pedro de Toledo urdhërojti të rrijn mblidhur e të rrojan ndë shpi guri të redhura e të mbillura nga mura ma një derë. Adhë sot thomi “Dalmi jasht nga Porta”. Don Giovanni de Icic te viti 1541 stisi shpitë guri, po kërkojti fokàtikun: një dukat nga fëmijë. Mashqitanet u zunë me zotin de Icic se, tura vënë këtë taksë, nëng nderoj dhuratan e don Konsalvit de Kordova, që i lëshoj “in perpetuo” të mos paguajan mosnjë taksë. Zoti de Icic kle ashtu shtrënguar të nxirriej këtë taksë e ta viti 1544 arrunë Mashqitë 24 fëmijë arbëreshë nga Trivigno e nga San Chirico Nuovo; ta viti 1647 erdhtin shumë Majnotë që iktin nga Majna. Koronëtë ishan “stratiotes”, bulara; e adhe sod, pas kaq mot, kur na do thomi sa një burr isht bular, thomi: “Ish dreq një Koronë”. Ta viti 1627, pë ftesë të monxinjorit Diodato Scaglia, peshpëku i Melfës, dhëbuartim ritin bixantinë, gjëmsan a shpirtit arbresh, po mbami adhe shtrënguar fort gluhan, besan e nderin, që na la loshi i madh Skanderbegu.

LA TASSA DEL FOCATICO, A MASCHITO - La tassa che gli Aragonesi e gli Spagnoli esigevano era il “focatico”, detto così da “focus”(fuoco, focolare) che ogni famiglia era obbligata a pagare.

Il 17 di maggio del 1507, Don Consalvo de Cordova, prima di lasciare Napoli, concedeva all’albanese Lazzaro Mattes il casale di Maschito disabitato e concedeva anche che gli albanesi non dovessero pagare nessuna tassa, sia ordinaria che straordinaria.

Per primi si stabilirono i soldati di Lazzaro Mattes, in seguito giunsero altri albanesi dai paesi latini vicini. Ma i più numerosi furono i Coronei, più di cento famiglie, che arrivarono a Maschito nell’anno 1534, dopo la caduta di Corone e la pace che Carlo V fece con Solimano I.

Allora possedevano il territorio di Maschito il Vescovo di Venosa ed il Priorato del Santo Sepolcro, i quali lo vendettero, nell’anno 1539, a don Giovanni de Icic. Gli albanesi (Maschitani), sparsi nel territorio in pagliai e senza case di pietra, andavano rubando e commettendo ogni danno, tanto che il vicerè don Pedro de Toledo ordinò che vivessero raccolti in case di pietra circondate chiuse da mura con una Porta. Don Giovanni de Icic costruì le case, ma pretese il “focatico”: un ducato per ciascun nucleo familiare. I maschitani fecero reclamo contro il signor de Icic, poichè, imponendo questa tassa, non onorava la donazione di don Consalvo di Cordova, che aveva concesso “in perpetuo” che non pagassero nessuna tassa. Il signor de Icic fu costretto a togliere questa tassa e nell’anno 1544 arrivarono a Maschito 24 famiglie albanesi da Trivigno e San Chirico Nuovo; nell’anno 1647 vennero molti Mainotti, che fuggirono da Maina. I Coronei erano “stratiotes”, nobili, ed ancora oggi, dopo tanto tempo, quando vogliamo dire che un uomo è nobile, diciamo: “E’ davvero un Coroneo!”. Nell’anno 1627, per colpa di monsignor Diodato Scaglia, vescovo di Melfi, abbiamo perduto il rito bizantino; però conserviamo ancora forte la lingua, la fede e l’onore, che ci lasciò in eredità il nostro grande avo Skanderbeg.

Ndëse do të shkruash arbërisht mbi

Jeta Arbëreshe

(+39) 0981-32539 / jetarbreshe@libero.it

Në 'Kosovën e pavarur' s'ka pension për klasën intelektuale

Janë aq "nëngjet" arbëreshë të pazgjidhur, mbi ku mund të ehja thonjtë. Jo, këtë herë dua të nderoj Universitetin Shtetëror të Prishtinës, tue folur për 'pensionet urije' të ish-profesorëveve ordinarë të saj. E thonjtë më duhshin më të ngurët se ata të një dhije malësore. Shkruajta për Kosovën kur ish pa liri e kur pra qe liruar; e mbrojtja ka turku e ka serbi. Po nani dua të flas mbi njetër "martirizim" që Kosova e Pavarur, sot, i ngarkon "inteligjencës" së saj në pension. E lë pa ngrënë. Njera pak vjet prapë, Universiteti Shtetëror i Prishtinës ish i vetmi i Kosovës: atje u formua e tërë klasa politike, kulturore, shkencore e Kosovës së sotme. Vet nga ndonjë vit e këtej roga mujore i njëj profesor ordinar të UP-isë ngau shifrën e 1000-1200 eurosh. Një rrogë e... lartë! Po, një herë në pension, profesor ordinar i UP-isë nget Parrrajsin me gjisht, ka tigani bie te prusht: nga muaj merr një 'lëmoshë urije': i pafati 80 euro, fatbardhi 112 euro. Një "jo-pension". Gjyhetari i madh shqiptar prof. Eqrem Çabej, gjatë një udhëtimi në Kalabri ndër vitet '70, rrëfyenej se 'shoku' Enver Hoxha shqiptarëveve i jip të hajin aq sa mos të vdisin. Po sa ndërron ajo "kafshatë shqiptare" nga kjo 'lëmoshë kosovare'?

Ka hyn një sjellje kështu e egër e Shtetit Kosovar ndaj 'inteligjencës' së saj? Parlamenti e Qeveria e Kosovës gjenden llargu nga Universiteti Shtetëror i Prishtinës jo më se 150 metra, në vijë ajrore. Domethënë, Institucjona Politike dhe ajo Shkencore të Kosovës rrojnë afër njera jetrës. Kish t'ecjin kraha-kraha, si vëllezër binjakë Jo, s'është kështu. Klasa politike ka thikën ka ana e mësimit: *mund të harë sa do; e klasa shkencore në pension? Mund të vdesë si do. Ka lidhje?*

"Pas 40 vjet pune në kushte fort të rënda, - më rrëfeyen një profesor ordinar i U.P.-isë në pension - Shteti i Kosovës lë Intelektualët Kosovarë në mes të udhës, pa pension; dhe pa asfarë shpërblimi për atë që ne bëmë, sidomos profesorët universitarë. Gjatë regjimit të egër serb ne profesorët e mbajtëm Universitetin dhe Shkollën shqipe nëpër objekte private pa kurrfarë kushtesh për punë. Por ia dolëm dhe, në vend që të shpërblehemi për mundin dhe sakrificën tonë, Qeveria e Kosovës na jep 80 o 112 euro mujore si ndihmë sociale. Ku ka Shtet, që, pas gjithë asaj pune, një profesor ordinar të mbetet me gishtërinj në gojë? Besoj se gjëkund nuk e gjen". Ka mot pyhem: "Sa punoi pramenda kulturore e Universitetit Shtetëror të Prishtinës, në fushën shterpe kosovare, për të zbuluqonej Pavarësia?".

Le të hapet një Kongres!

Drejtori

NELLA 'KOSOVA INDIPENDENTE' NON C'E' PENSIONE PER GLI INTELLETTUALI - Sono tanti

i "nodi" arbëreshë irrisolti, su cui potrei affilare le unghie. No, questa volta voglio onorare l'Università Statale di Prishtina, parlando delle "pensioni di fame" dei suoi ex professori ordinari. E mi servirebbero unghie più dure di quelle di una capra di montagna. Ho scritto sulla Kosova quando era senza libertà e quando poi fu liberata, l'ho difesa dal turco e dal serbo. Ma adesso voglio parlare di un altro "martirio" che la Kosova Indipendente, oggi, impone alla sua "intelligentia" in pensione. La lascia senza mangiare. Fino a pochi anni fa, l'Università Statale di Prishtina era l'unica della Kosova: lì si è formata la classe politica, culturale, scientifica dell'odierna Kosova. Solo da qualche anno lo stipendio mensile di un professore ordinario dell'Università Statale di Prishtina ha toccato la cifra di 1000-1200 euro. Uno stipendio...esagerato! Ma, una volta in pensione, il prof. ordinario tocca il Paradiso con un dito, dalla padella cade nella brace: ogni mese prende un "elemosina da fame": lo sfortunato 80 euro, il fortunato 112 euro mensili. Una "non-pensione". Il grande linguista albanese, prof. universitario Eqrem Çabej, durante un viaggio in Calabria negli anni '70, raccontava che "il compagno" Enver Hoxha agli albanesi dava da mangiare quanto bastava per non farli morire. Ma dov'è la differenza tra quel "boccone albanese e questa elemosina kosovara?"

Come si spiega un comportamento così crudele dello Stato Kosovaro verso la sua "intelligentia"?

Il Parlamento e il Governo Kosovaro si trovano distanti dall'Università Statale di Prishtina non più di 150 metri in linea d'aria. Cioè l'Istituzione Politica e quella Scientifica della Kosova vivono una accanto all'altra. Dovrebbero camminare affiancate, come sorelle gemelle. No, non è così. La classe politica ha il coltello dalla parte del manico: *può mangiare quanto vuole. E la classe scientifica in pensione? Può morire come vuole. Ha senso?*

"Dopo 40 anni di lavoro in condizioni pesantissime - mi racconta un professore ordinario dell'Università Statale di Prishtina, in pensione - lo Stato Kosovaro lascia gli Intellettuali Kosovari in mezzo alla strada, senza pensione, e senza nessuna ricompensa per quello che abbiamo fatto, specialmente noi professori universitari. Durante il feroce regime serbo, noi professori abbiamo tenuto in piedi l'Università e la scuola albanese in sedi private senza nessuna condizione di lavoro. Ma ci siamo riusciti e, invece di essere ricompensati per la fatica e il sacrificio profusi, il Governo della Kosova ci dà 80-112 euro mensili come aiuto sociale. C'è uno Stato, dove, dopo tutto quel lavoro fatto, un prof. ordinario resta con le dita in bocca? Credo che non lo trovi da nessun'altra parte". Da tempo mi chiedo: "Quanto ha lavorato l'aratro culturale dell'Università Statale di Prishtina, nella pianura sterile kosovara, perché sbocciasse l'Indipendenza?".

Si apra un Congresso!

Kajverici: një storje e gjatë

Patrizia Figlia

ka Kajverici (Cs)

Storja e Kajvericit është një storje që nën spicarn më. Ndë 11 të shëndreut 2013 doli sentenca të Konsilit i Shtetit që thot se katundi i ri që qe konstruirtur është abusiv. Mangon ajo që ndë xherg teknik sërritet VIA -Valutaciona e Impatit Ambiental. Nani është e pritët të dihet që ka të bëhet të dilet nga kjo situacion jo e mirë.

Asocjaciona “Kajverici Rron”, që gjasht vjet prap bëri rikursin, nën do demollicjonën e katundit që bën të ri, do vet të hapet katundi i vjetër e të recuperaret.

Shurbesi më i brut është se gjindja e Kajvericit jan edhe sod e, më se më parë, një kundër jetrit.

Ahiera Proteciona Çivile Nazionale deçidirti të bëjë gjith shpit e Kajvericit. Ata që bënë rikursin nën e dejin shpin ndë katund të ri: për ta ishë si një deportacion e nën deshtin të e subirëjin. Mbajm edhe mend se delokalixaciona qe deçidirtur shum shpejt, kur edhe gjith ishin të trëmbuj e pa ruajtur mirë si ishë situaciona e Kajvericit dopu fran’s.

Janë edhe njetër ca problemra mbi rikostrucionen, pse qe bënur pa ruajtur si ishin shpit më parë se frana. Qenë stisur ato tek rrijin gjind, ato të rata ka shumë, ato të rea, ato të vjetra tek nën rrij më mosnjeri që më se 40 vjet, ato abuzive. Qe thënë se ka të jipej një shpi gjithve atire që një shpi nën e kishin më, e pra qenë bënë edhe të ditat e të tretat shpi. Shum janë shurbiset që nën dihet mirë si qenë bënë. Nani Guardja e Financës është e indagarën mbi gjith këto shurbise.

LA STORIA DI CAVALLERIZZO SEMBRA

UNA STORIA SENZA FINE - L’11 dicembre 2013 è finalmente uscita la sentenza del Consiglio di Stato che stabilisce che la new town costruita è abusiva. Manca quella che in gergo tecnico si chiama VIA- valutazione di impatto ambientale. Ora si attende per capire come bisogna uscire da questa incresciosa situazione.

L’Associazione “Cavallerizzo viv”e, che sei anni fa ha presentato ricorso contro la delocalizzazione, non vuole la demolizione del nuovo sito, bensì che si riapra e si recuperi il vecchio.

La cosa più triste che si è verificata da subito, e ancora si verifica, forse più di prima, è che tra le due fazioni createsi ci sia grande tensione.

All’epoca la Protezione Civile Nazionale decise di ricostruire tutte le case del paese. Coloro che hanno presentato ricorso non volevano una casa nel nuovo sito, per loro questa imposizione era da equiparare a una vera e propria deportazione ed hanno deciso di non subirla.

Bisogna ricordare anche che la decisione di delocalizzare è stata estremamente affrettata, tra l’altro, presa in un momento in cui la popolazione era ancora emotivamente troppo labile e facilmente influenzabile per pensare in modo razionale a ciò che avrebbe veramente voluto; inoltre, senza avere ancora certezze sulle sorti del vecchio sito.

Ci sono anche altri problemi che minacciano la new town. La ricostruzione è stata fatta senza seguire criteri precisi: sono state, infatti, costruite le case abitate, quelle inagibili o addirittura crollate da tempo, le nuove, le vecchie non abitate da più di 40 anni, le abusive. E’ stato detto che si doveva dare una casa a chi non l’aveva più, ma poi sono state costruite anche le seconde e le terze case. Sono molte le cose poco chiare, e per questo c’è un’indagine in corso della Guardia di Finanza.

Jeta Arbëreshe

Semestrata online
di Cultura
e Informazione Arbëreshe,
in Italia e nel Mondo

Revistë gjashtëmujore online e Shoqatës Kulturore “Jeta Arbëreshe”,
Purçill / Eianina (Cs-Italia)

Drejtor përgjegjës / Direttore responsabile: **Agostino Giordano**
Drejtori, Redaksi e Administratë / Direzione, Redazione,
Amministrazione: via G.Marconi,30 – 87010 Eianina-Purçill (Cs-Italia)
Tel. (+39) 0981-32539 / e-mail: jetarbreshe@libero.it
sito internet - <http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Ku dërgohen e dhurohen tureset / Versamenti e Donazioni: Credito Cooperativo Mediocrati, cod.Iban IT 22 H 07062 70850 000000116918, intestato a: Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe” – 87010 Eianina/Purçill (Cs-Italia)

Regjistrim / Registrazione: Tribunale di Castrovillari (Cs), nr.4/2001 del 28-12-2001

Artikuj, Dorëshkrime e Fotografij, edhe ndëse s’botohen, nën prirën prapë / Articoli, Manoscritti e Foto, anche se non pubblicati, non si restituiscono

Drejtorja nën është përgjegjëse për përmbajtjen dhe formën e artikujvet të nënshkruar / La Direzione non è responsabile del contenuto e della forma degli articoli firmati

Gjithë të drejtat të rezervuara / Tutti i diritti riservati

Arbashkuar i tretë

Kostandin Bellushi

ka Pllatani (Cs)

Ndër pesëmbëdhjetë të majit, u prezentua Spixanë, me kazjuran e “Majit të librave”, ka Biblioteka “G. A. Nociti”, i treti vullum i Fjalorit ilustruar italisht – arbërisht – shqip, “Arbashkuar” (Arbërishtja e bashkuar), mbi Historinë dhe Gjuhën e katundave arbëreshë të Firmozës, Fermës, Ungrës, Picilisë, Spixanës dhe krahësuar me gluhan shqipe të Shqipërisë, kuratur ka bashkëautorët Kostandin Bellusi ka Pllatëni, dhe ka Flavia D’Agostino ka Çifti. Ka prezantimi muartin pjesë, pas autorëvat, nën-komisari i Prefetit, dott. Trecroci; përgjigjsja e Setorit IV të Bashkisë së Spixanës, dr.sha Guida A.; përgjigjsja e Bibliotekas bashkiake “G. A. Nociti” të Spixanës, dr.sha Milione D.; Presidenti i Istitutit Me.Me, on. Brunetti M.; i nderuari Ispetor MIUR, dr. Fusca F. – poetë ka Spixana, ç’ shkruajti Parathënia e Fjalorit t’ri; prof.Marchianò F., stori ka Spixana; prof.sha Blaiotta E., ç’kle drejtoreshe skollore dhe shkruajti Hirjan e Fjalorit tanë; prof. Mazzei G., Presidenti i Çendrit Internacionall mbi studimat e Xhirollamo De Rada.

ARBASHKUAR, TERZO VOLUME - Il 15 maggio 2014, è stato presentato a Spezzano Albanese, in occasione del “Maggio dei libri”, il III vol. del Dizionario illustrato italiano – arbërisht – albanese, “Arbashkuar” (lingua arbëreshe comune e unitaria), sulla Storia e la Lingua dei paesi arbëreshë di Acquafredda, Firmo, Lungro, Santa Caterina Albanese, Spezzano Albanese, con la comparazione anche della lingua albanese dell’Albania. Alla presentazione hanno preso parte, oltre agli autori, il sub-commissario prefettizio, dott. Trecroci; la responsabile del Settore IV del Comune di Spezzano Alb.se, dott.ssa Guida A.; la responsabile della Biblioteca comunale “G. A. Nociti” di Spezzano Alb.se, dott.ssa Milione D.; il Presidente dell’ Istituto Me.Me., on Brunetti M.; l’ Ispettore emerito MIUR, dott. Fusca F. – poeta di Spezzano Alb.se, che ha scritto la Presentazione al nostro nuovo Dizionario; il prof. Marchianò F., storico di Spezzano Alb.se; la prof.ssa Blaiotta E., già dirigente scolastica, che ha scritto l’Introduzione al nostro Dizionario; il prof. Mazzei G., Presidente del Centro Internazionale sugli Studi Deradani.

XXI* Sfaqe Kulturore-Folklorike

Cettina Mazzei

ka Garrafa (Cz)

Organizuar ka Asoçaciona kulturele “Projekti Garrafa”, bashkë me Shkollën e Komunën e Garrafës-Cz, me Institutin Shkollor e Komunën e Shën Mitrit e me Universitaten e Kalavris, Sfaqja XXI Kulturore Folklorike për Vleresimin e Pakicave Etnike, ju sosë me sukses e muarrën pjesë 15 Shkolla Arbëreshe: Garrafa-Cz, Fallkunara-Cs, Ferma-Cs, Frasnita-Cs, Jacaria-Cz, Kuntisa-Pa, Mashqiti-Pz, Pallaci-Pa, Pllatëni-Cs, Shën Mitri-Cs, Shën Sofia-Cs, Shën Vasili-Cs, Vakarici-Cs, Vina-Cz.

Edicioni i vitit 2014 të Rasenjës, me rastin e dyqindvjetorit të lindjes të Jeronimit De Rada - i lindur më 19 nëntor 1814 te katundi arbëresh Maqi, afer San Dhimiter Corone (CS) - kishte për temë "Jeronim De Rada, kolos i poezisë, i dashurisë dhe Atdheut". Manifestacionat filluan në Garrafë- Cz, te dita 30 maj 2014, me një konvenjë i cili kujton poetin De Rada para vendlindjen e tij ku, te Instituti i Shkolles ju ba inaguraciona i murales t’dedikuar Jeronimit De Rada "kolos i vjershërimit dhe i dashurisë".

Dita i dedikuar Jeronim De Radës (1814-1903), kle 31 maj në Maq , te katundi i poetit, afer te shtëpia e saj; ju mba një konferenc: “Tue kujtuar Jeronim De Radën”. Muarrën pjes: Concetta Mazzei Koordinator i Rasenjës, Konsoli shqiptar Gerarta Zheji Ballo, on. Mario Brunetti, prof. Altimari i Universitetit i Kalabrisë, prof. Mandala i Universitetit i Palermos, Franco Stirparo Presidenti i Asociaciones “ Projekti Garrafa”, e mbesa e poetit Giuseppina De Rada, Cesare Marini Kryetar i Bashkisë së Shën Mitrit, Antonio Sciumbata Kryetar i Bashkisë së Garrafës, Damiano Cadicano Këshilltar për Arsim, prof. Tommaso Bubba per shkollën e Garrafes.

Ishë mbledhja e shkollave që muarrën pjesë te manifestimi, studiues, profesorë, historianë, drejtorë shkollash, administratorë, politikanë, autoritete.

Kurë sosi Konvenji, ju dhanë atestatet për muralet më të bukura e konkursit të shkollave që muarrën pjesë me temë: “Jeronim De Rada, “kolos i vjershërimit dhe i dashurisë”.

Instituti i parë ju klasifikar shkolla e Fallkunares-Cs; pra Mashqiti-Pz e te fundi Instituti i Kuntises-Pallaci-Pa.

Në ore 15:30, sfilata e grupet e shkollave, bashku

XXI* Sfaqje Kulturore-Folklorike

me Kryetarët e katundevet, me gonfalonët Komunalë, gjatë rrugëve e udhët të Maqes, kanë kënduar e kërcuar me valle.

Esibicionat e grupevet folkloristike, ju banë të anfitratri komunal të Shën Mitrit. Dëpu esibicionavet, që ju sosun shumë natë, shkollat që muarën pjesë ju klasifikartën:

Koreografia më e mirë: një, Shën Mitri-Cs; dy, Frasnita-Cs; tre, Shën Sofia-Cs.

Këngë më të mirë: një, Shën Vasili-Cs; dy Pllateni Cs, tre Jacaria Cz.

Paraqitja më e mirë me temë: një, Kuntisa-Pa; dy Vina-C; tre, Vakaria-Cs.

Performancës më të mirë: Një, Fallkunara-Cs; dy, Mashqiti-Pz, tre Garrafa-Cz.

G.A.Nociti e veprat e tij të pabotuara

Francesco Marchiano

ka Spixana (Cs)

Me rastin e 200 vjetorit të lindjes së De Radës, është i detyrueshëm të kujtohen edhe miqtë e tij që kish të katundet arbëreshë. Një ndër këta ka qënë Giuseppe Angelo Nociti (1832-'99), me prejardhje nga katundi i Spixanës-Spezzano Albanese. Nociti është i konsideruar, deri sot, një autor arbëresh "minor" kurse zbulime të reja mbi veprën e tij do t'i japën, post mortem, vendin që meriton brenda të letërsia shqiptare.

G. A. Nociti lindi në Napoli dhe disa vjet pas, i vdiqën nëna dhe babai, gjuhëtari Giuseppe Maria Nociti. Si të gjithë pinjollët e familjeve pasanike ai studjoi te Kollegji i Shën Adrianit ku pati si mësues Don Xhillormin De Rada.

Pas studimevet dhe pas revolucionit e 1848, Nociti u vendos te katundi i familjes, Spixana, ku ishte i kontrolluar nga policia burbone. Ky kufizim i rreptë e detyroi të studjonte, sidomos klasikët e kulturës italiane (Dante dhe Petrarka) dhe latine.

Ai kishte teorinë se katundi i Spixanës mund të zhvillohej vetëm me përdorimin e italishtjes dhe prandaj konsideronte arbërishtjen "gjuhë barbare"! Për fat të mirë, ai ka shkruar te gjuha arbërishte të vendit "Rrëmënxa t'arbresha" (të botuara te viti 1992) dhe "Poezi të truzëmra t'arbresha" (1866), poezit të traditës arbëreshe të botuara te librat e Kamardës, "Ndihma e Krojes".

Kohët e fundit, prof. I. C. Fortino (Universiteti i Napolit) na njoftoi se te fondi i librave të prof. Giovanni Laviola gjeti disa dorëshkrime të G. A. Nociti-t: një studim mbi veprën e Varibobës ("Il Variboba tradotto dal prof. Giuseppe Angelo Nociti, 1877") me shënime dhe ndreqje gabimesh, një fjalor shqiptar ("Vocabolario albanese") më 16mij fjalë, të nxjerra nga e folmja vendase dhe nga veprat të Kristoforidhit, të Dorsës, poezi të ndryshme arbëreshe (te atit dhe të xhaxhait), një letërkëmbim me Antonio Argondizza, veprimtar të Rilindjes, me presidentin e Akademisë të Linxhejvet dhe me shtëpinë botuese Loescher, dhe dokumenta të tjera me vlerë filologjike dhe historike.

G. A. Nociti, që ka qënë i përmendur edhe nga Dora d'Istria (1866) si studjues me talent, gjatë jetës së tij mbajti kontakte epistolare jo vetëm me De Radën, por edhe me Gustav Meyer, Émile Legrand, Gennaro Lusi, Demetrio Camarda dhe dijetarë të tjerë arbëreshe dhe të huaj.

Te ditari i vitit 1898, Giuseppe Angelo Nociti, me thartësi, thotë se shpesh fati ka vepruar kundër atij sepse nuk ka pasur mjetet ekonomike të botonte veprat, dhe, kur kishte mundësinë, shtëpitë botuese i shkruanin se lënden që ai kishte trajtuar nuk kishte më interes.

Kurse, ditët e sotme – me mjetin e internetit – marrim vesh se G. A. Nociti është i përmendur nga dijetarët gjermane si një gjuhëtar dhe filolog me vlerë, sidomos te krijimi i fjalëve të reja shqipe.

Per jetën dhe veprën e Giuseppe Angelo Nociti kanë shkruar: prof. Giovanni Laviola (1988), prof. Italo C. Fortino (1992), Giuseppe Acquafredda (1992) dhe Francesco Marchiano (1993).

www. agm.calabria.it

Idiomatizme të Purçillit

Drejtori

ka Purçilli (Cs)

(vjen ka nr.75)

gjizë-a, sf = ricotta850. dridhet si gjizë, *trema come ricotta*, (trema tutta quanta)851. kutndohet me një gjiz, *si accontenta con una ricotta* (si accontenta di poco)852. është e njom si gjiz, *è morbida come ricotta*, (è molliccia, grassottella)853. mund 'jet se t' dhan t' trashen e gjizes!..., *sembra quasi che t'abbiano dato la parte più grossa della ricotta!*..(non sembra proprio che ti abbiano trattato bene!..)**gjon-i**, sm = assiuolo, gufo; maiale854. rri e bën gjonin, *fa il verso dell'assiuolo*,855. e di edhe gjonin, *lo sa anche il maiale* (lo sanno tutti)

856. gjo, gjo, gjo!..(kur ndillet derku / il verso che si usa quando si richiama il maiale per mangiare)

gju-ri, sm = ginocchio856. rrinë sembri me gjunjet e çar, si kuel ç'çambarjen (si Shën Roku), *stanno sempre con le ginocchia rotte, come cavalli che inciampano / come san Rocco* (vanno a cadere spesso)857. çan buk me gjunj, *rompe pane con le ginocchia* (mangia pane duro, è povero)**gjuhë-a**, sf = lingua858. shkurtò gjuhen!, *accorcia la lingua!*, (non parlare troppo!)859. zë gjuhen muckùn!, *da' un morso alla lingua!*, (sta' zitto!)860. lajti gjuhen me të, *ha lavato la lingua con lei/lui*, (glie l'ha cantata ben bene)861. e kam te malza gjuhs!..., *ce l'ho sulla punta della lingua!*.., (lo so, ma ora non me lo ricordo)862. ju bë lesht te gjuha, sa her ja tha, *gli son cresciuti i peli sulla lingua, quante volte glie l'ha detto*, (glie l'ha ripetuto mille volte)863. ka miàlthit te gjuha, *ha il miele sulla lingua*, (parla dolcemente)864. është një gjuh-zì, *è una lingua-nera*, (è un italiano)865. ka një gjuh si Paskallin, *ha una lingua come una Pasqualina* (è una linguacciuta)

(D. - 20 / është më)

Vjeshe ka Shën Sofia

Lucia Cardamone

ka Shen Sofia (Cs)

Vjeshe malli

Buza jote një kolënder
më pariren i bukuri ëmer;
tundullore si një qiqer
më pariren se je e viker .

Ti trëndofile e kuqe pjot ardur
çë kur u pakëzove , fanmirë ,
hënza qe ndrikull e dielli kumbar:
andajna ka do vete bën sperë .

Doja t' isha zog e një vullat t'e bëja
te qaramidhet e mallit doja të veja
nëng e dekuroja se pangrënë u rrija
se ish malli çë më jip e haja .

Më muari malli çë nëng mënd rronj
mbësomë ti si kam t'e bënj
se jam llargu e nëng mënd vinj
se mb'udhë m'u bi një ferr
e nëng mënd shkonnj .

U vete rahj mbë rahj si zog i zi
tue thërritur : Malli im, ku je?

Vjeshe kunder

Ti vete tue thën se kush je
te kallandari nëng të vë mosnjeri
drethë atà sy si drongole
e rrashinare si gjalper i zi .

Ka t' digjeç si korqë morri
e si kamastra çë rri te zjarri
kur nxir atò fjalë si vohë furri .

E kush e di se dheu tundet si sita
me mot u bi t'i qaq ti këtò shkata.

Si zog kllosie çë te lumi u mby(t)
është trimi yt i lartë sa një mi .

T'u gris xhaketa e të qindroj mbëfurra
e vete koc mbë koc tue vrrar morra.

Sën Andoni i Padova-s

Nicoletta Russo

ka Farneta (Cs)

Leu Lisbon në 1195, kle pakëzuar me ëmërin Fernand. Sot mësegjithë është “Shëjti i mirakulvet”. “Liber miracolorum” i tij është ai më i djovasur. Sën Andoni vdiq që kish 36 vjet, ndër 13 të feristiu 1231, Padov, po devuciuna për atë mbijetoi edhe u bë më e madhe për mirakulit që pra erdhëtin. Në folklorin italisht Sën Andoni i Padovas është i njohur si shëjti i zambakut. Ai është “patruni i 13 gjërave e bënd bënë 13 graxje”; për të kesh një graxje, thuhet në Abruc, se sosan të thuash 13 herë qetëth e qetëth lutjen: (Sën Andon i Padovas / që ka Padova vjen, / trimbdhjetë graxje atij që i kërkon, / të trimbëdhjeta t’i ket. / Bëni një graxje mua, / për të pesat plaga të Zotit Krisht). Sën Andoni lutet edhe për të gjësh gjë që bore.

Farnetë, Sën Andoni festohet di herë: një herë ndër 13 të majit e ndër 13 të feristiu. Ndër 13 të majit festohet për devuciun. Kish shumë mot që s’binej shi, dherat u kishin bërë hjersa, njerzit pënxuan të nxirin shëjtin për të bëjnë përcjonan. Sën Andoni bëri graxjen, gjithnjëhërje zu shiu.

Ndër 13 të feristiu bëhet një festë shumë e bukur. Manatet, ndër 10, thuhet Mesha, pra bëhet përcjona dhe ngandi me gjërat që njerzit japan; turrësët që mbjedhan ja vën shëjtit. Vjen banda muzikore e ka qaca luhet: gjithë njerëzit janë të gëzuar; vinjan edhe shumë njeriz ka katundet afar e bënjan fest bashkë me ne. Ndër 5, pas mjesditës, thuhet rruzari. Pra mbremnet vjen një kompleks muzikor, i bìa muzikës njera natë.

Pas përcjonës grat këndonjan një kënkë Shën Andonit që zë fill kështu:

Sën Andoni shëjt leu, / lulëzoj gjithë dheu;
gjithë dheu lulëzoj, / shkoj Krishti e bekoj.
Shën Mëria m’i këndo; / aq bukur që i këndo.
Sën Andoni avukat / u nis e vate te një çitat
Me karviquezan mbë dorë / shprishnej graxje nga orë;
/ e m’i shprishnej me pënxier: / fluturoj, vate ndër qiell.

SANT’ANTONIO DI PADOVA – Sant’Antonio nacque a Lisbona il 1195 e fu battezzato col nome di Fernando. Oggi soprattutto egli è “il santo dei miracoli” e il suo Liber Miracolorum (Libro dei Miracoli) sembra il più letto. S. Antonio morì a 36 anni, ma la devozione per lui sopravvisse e crebbe sempre più con la fama dei miracoli arrivati. Nel folklore italiano S. Antonio di Padova è conosciuto come il santo del giglio. Egli è il “padrone di 13 cose e può fare 13 grazie”; e per ottenere da lui qualcosa si crede – in Abruzzo – che basti recitare 13 volte, in silenzio, l’orazione:

“Sand’ Andònie de Pàduve / che dde Paduve aveniste / tridece grazij a Ddi’ cerchiste, / tutt’a tridece l’aviste. / Facète na grazij’ a mmé, / pe le cinghe piaghe de Ggesù Criste” (dialetto abruzzese).

Sant’Antonio viene invocato anche per ritrovare cose perdute.

A Farneta, Sant’Antonio si festeggia due volte: il 13 maggio e il 13 giugno. Il 13 maggio si festeggia per devozione. Poiché non pioveva da molto tempo ed i terreni erano diventati tutti aridi, la popolazione di Farneta decise di portare il Santo in processione: la grazia fu concessa, improvvisamente iniziò a piovere.

Il 13 giugno si fa una festa molto bella: alle ore 10 della mattina si celebra la S. Messa, si fa la processione, si mette all’incanto ciò che la popolazione offre e il ricavato viene devoluto al santo. Viene la banda musicale, in piazza si balla e tutta la popolazione è felice; vengono anche molte persone dai paesi vicini a festeggiare insieme a noi. Alle cinque del pomeriggio si recita il rosario. Poi la sera viene un complesso musicale per allietare la serata e vi rimane fino a notte fonda.

Appresso alla processione le donne intonano un canto a Sant’Antonio, che inizia così:

“Sant’Antonio nacque santo / e fiori tutta la terra; / tutta la terra fiori / passò Cristo e la benedì; / la Santa Madonna cantò, / molto bene Ella cantò: / Sant’Antonio avvocato / partì e andò in una città / con un piccolo pane in mano / spargeva grazie ogni ora / e le spargeva con sentimento / volò e andò in cielo”.

JETA ARBËRESHË

KËRKON KORRESPONDENTE/Ë NDËR KËTA KATUNDE :

Sëndahstinë (Pa), Karfic e Puhëri (Kr), Vinë e Andall (Cz), Frasnitë, Çivit, Kastërnexh, Qanë, Marr, Strigar, Shën Mitër, Mbuzat, Vakarie, Picili (Cs), Barill, Zhur, Shën Kostandin (Pz), Këmarin, Portkanun (Cb)

Telefononi o shkruani Drejtorit: 0981-32539 / e-mail: jetarbreshe@libero.it

Festa e Shën Sepit, në Kuntisë

Tommasina Guarino

ka Kuntisa (Pa)

Festa e Shën Sepit te hora jonë është shumë e ndieshme pas asaj të Shën Mërisë së Favarës, tetë shtator.

Për këtë ndodhje në Kuntisë, si te të tjera horë të Siçilisë perëndimore, është një tradicionë shumë e bukur, bëhen utaret ose tryezat e Shën Sepit, prapa një taksje.

Nga nëntë javë më para të festës, çdo mërkurje te klisja arbëreshe, ku ndodhet statuja e shëjtrit thuhet mesha o projazmena (nëse jemi te Kreshmit), bekohet buka, ngaherë e taksur nga ndonjeri e pas shpëndohet gjindëve, ndërsa menatnet njize tamburinari i horës kute rarë bën dhromin e përçisjones për t'ë kujtuar kremtimin.

Njera pas të dyjtës luftë botërore, më shumë se “utari”, sot shumë i qozëm, bëhej “tryeza”, vetëm me bukë, me brumë e me mëlikë (bukë e bluar) e dërtuame.

Kute shkuar vitrat, “tryeza” o më mirë “utari” jo vetëm u ka zbuluar me palaca antike e me mësallë të qindisura por edhe u ka mbluar me gjëra të ngrëni të tiganisur, me fruta e me ëmbëlsira.

Zakonisht përballë vëhet një kuadër me fëmijën e shëjtë, te anët degë dafnje, ku viren kuleçë bukje të vegël, në mes mbi tryezen “spera” (një ëmbëlsirë me brumë e fiq që simbolizon sakramendin), buka nga aq forma të ndryshme, brumë, mbëraj e aq gjelbërim të tiganisur.

Përpara janë kuleçët e mëdhenj (pesë, shtatë o nëntë) me shenjën e shejtrave më të njohur.

Një herë te tryeza o te “utari” hajin vërtet mavrit, të varfërit, sot si sot bën shejtin (ashtu thuhet) miku, gjiri, gjitoni.

Nga viti 1998 “utari” vjen bërë edhe te shkolla me ndihmën e prindërve.

Te vixhillja e festës vizitohen utaret, muzika e horës, si edhe gjatë përçisjones, bie “Partët e shën Sepit”; të gjithë këndojnë, në siçilist “Lu viaggio dulurusu”, “Dhromi i helmuar, që më të vërtetë është novena e Baminëlit.

Kur u mbësjoja, një pjesë e këtij këndimi e kam përkthyer në arbërisht dhe atëherë ja kam mbësuar nxënësve.

I zoti i shpisë bashkë me të tjerët e fëmijes japën të gjithëve të hanë (më shumë ëmbëlsira e qiqa) e të pinë.

Mbrëmjet e ditës 19 mars, statuja e Shën Sepit është

qellur në përçisjone për udhët e horës, shumë marrën pjesë me këmbë të xathur.

Partët e Shën Sepit

Dhromi i helmuar

Shën Sepi një ditë rrij
në mes sheshit të Nacaretit,
duke ecur ai vej
një trumbetë ai dëgjoj.
Një edikt të zgjidhin gjegji
dhe atëherë u shqetësua

Ky edikt ashtu thosh:
Çdo njeri, i madh o i vogël,
te hora atij kish të vej
për të shkruar familjen
e pastaj kish të paguaj
detyrimet e tij.

Me këtë lajm ashtu të keq
Shën Sepi në shtëpi shkoi
e Shën Mërisë që ish brënda,
i mërzitur ashtu i tha:
një edikt tashti gjegja
në mes sheshit të horës.

Një dhrom kemi të bëjmë
dhe shpenzimet kemi të paguajmë
na qëndron të marrëm vesh
e të shkojmë në Betlem,
mirr aty katër shërbise
edhe nisemi njize njize.

Vangjeli + Fjalor

(të Emanuele Giordano - s)

€uro 30

Ccp. nr. 12994760

Associazione Culturale “Jeta Arbëreshe”
87010 Eianina / Purçill (Cs)

Vjershe ka Shën Sofia

(mbjodhi) **Motimadh**

ka Shen Sofia (Cs)

Shërtim Fati

U gholqa një shërtim e t'ë dërgova.
Doja t'ë dija ndë zëmëren t'ë ngava.
E, ndë t'ë ngava, ti dërgome thën.
Sa t'mos bi t'vëdes me këtë penë.
Se losem gju si bora nd'ato llavën.
E vete tue kodhirtur afecion.
Të ligjen fat pata per moter.
Ju shprisha gjakun im. E godhir ndonjeter.

Mendimi Zemëres

U mbanjë mendë se kur ishim të vogël.
Ka prapa mur bridhim me lomadez.
Ka trapza e ka qaca bridhim shegur.
Ka qisha vieter vej e ghajim mënez.
Kalive bëjim me bot e gur.
Sa t'bëjim si të mbëda na tue par.
Shi sa bukur është të jeçë i vogël.
Se gjithë miket ti ke per vëllezër.

(Kërkime Shën Sofi 1990)

Gjëegjëza ka Shën Bendhiti

Daniela Moccia

ka Shen Bendhiti (Cs)

Brekrat me brek ndë dor
vate mbjodhiqë pëmbëdorë:
pëmbëdorë nëng kishë
mbjoji gjiunë të pjotë me mish

Pantalonecaduto con i pantaloni in mano / è andato a rac-
cogliere pomodori: / pomodori non ce n'erano, / ha riem-
pito il seno pieno di carne.

Vem, Serrakò,
vem e marrimë ata pajaca
Serrakòji u martua
mori Saverjën si një xhoje grua;
e grua si do ish
tre shtupel galuce kish;
e kish me një dhifjet:
grikën e kish si dhjet.

Andiamo, Serracò, / andiamo a prendere quelle coperte,
Serracò si è sposato / ha preso Saveria come una brava
donna; / e donna com'era, / tre misure di galletti aveva /
e ce l'aveva con un difetto: / la bocca ce l'aveva come
dieci.

BIBLIOTEKA e JETËS ARBËRESHE

Zëri i Arbëreshvet (1972-82) – riv. cult.	€ 200; për Institucionet	€ 400
B.Bilotta : <i>Circa i Pelasgi</i> – anno 1893 – ff.53		€ 35
B.Bilotta : <i>Versi Lugubri (poezi)</i> – 1894 – ff.34		€ 35
B.Bilotta : <i>Gli Enti Sacri della Bibbia – I parte</i> – 1897 – ff.127		€ 40
B.Bilotta : <i>Stima agli ottimi, biasimo ai tristi (poezi)</i> – 1898 – ff.12 – (fotok.)		€ 10
B.Bilotta : <i>Gli Enti Sacri della Bibbia – II parte</i> – 1899 – ff.128		€ 40
B.Bilotta : <i>Dottrina</i> – 1908 – ff.26 – (fotok.)		€ 10
B.Bilotta : <i>Nota compendiosa circa l'Eden</i> – 1911 . ff.23		€ 35
B.Bilotta : <i>Le mie opinioni archeologiche e preistoriche</i> – 1911 – ff.58		€ 35
B.Bilotta : <i>Archeologia di Romolo e Roma</i> – 1912 – ff.107		€ 40
B.Bilotta : <i>Studio filologico circa Dardano e Corinto</i> – 1913 – ff.111		€ 40
B.Bilotta : <i>Studio filologico circa gli Eroi preistorici</i> - 1915 – ff.151		€ 40
B.Bilotta : <i>Va' fuori d'Italia, o barbaro straniero (poezi)</i> – 1916 – ff.7		€ 20
B.Bilotta : <i>Italia e Francia brindando...</i> (poezi) – 1916 – ff.22		€ 20
B.Bilotta : <i>Canti Albanesi</i> – 1916 – ff.10		€ 20

Lena Markut bën nj'qind vjet, mburoftë!

Lena Markut (Elena Blaiotta) bën 100 vjet. U le Purçill/Eianinë-Cs, ka Vasili Pjetrit Vasilit (Basilio Blaiotta) e Zabela Markut (Isabella Miranda) ndër 14 llanar 1914. U martua me Sepmariën e Parapunjes (Giuseppe M. Parapugna), patë di bila e është mëmajetër e 4 niprave dhe 5 stërniprave.. Këngëtare graxetash e vjershesh, mësemë i këndoj me t'bilat, me t'motren Anita Markut (mëma ime) e me t'kushreren, Maria Markut; si edhe me cje Ronen e cje Dilen e Markizit, gjitone. Të parët Qind Vjet dish t'i kremtojnë te katundi saj, Purçill. Si bashkëpunatore e J.A., i dhuron një macetë... Poezish. Të sajat. Rroftë sa rroi Noea! (D.)

a) Poesi e Shkrime të publikuar

Një Poesi ka Purçilli

Kur isha vash e im vëlla guanjùn
ish e kuarjem Nënkatund:
ahina bënej vapë shumë
bënej vapë sa s'und e rrëstojem
e na vam mb'hje e më këndojem.
Aq këndime që më shtumë
sa m'i zgjuam ndë katund.
Dual një pjak te një ballkun:
"Doj t'prirsha papa guanjun,
t'martoja nj'vashë me këndime shumë:
se mua zëmren më m'e mbjonej
e nj'mil vjet na mund rrojem".

(Jeta Arbëreshe, nr. 7/2002, faqe 3)

Marku Zabeles

(Purçill 1910 – Kroaçje 1943)

Një katund i vikerr i kulton e i nderon vjershtaret dhe këngëtarët popullorë. Vllau jonë Marku Zabeles (o, më mirë, Marku Vasilit Pjetrit Vasilit) është një ndir kta. U le te viti 1910, ka Vasili Pjetri Vasilit e ka Zabela Markut, te një fëmilë me trembëdhjetë bil. Sa u bë k a l a s t r u n s h t a t ë m b ë d h j e t ë v j e t s h z u e këndoi vjershe e graxeta. Si u pruar ka suldati, për ndënj dhjetë vjet, njera ndër 1940, mbjoi me vuxhen e tij të bukur gjithë udhat e rugat e Purçillit dhe të Frasnitës. Kta ishen shokt mek Marku dil e këndoj: Ndoni Pizandit, Sallvaturi Rokut, Viçenxi Piçellit e Pjetrandoni Karetit. Ai bënej t'paren vuxhë. Vëndarnej vjershet atjë për atjë, ture ecur, o i pënxonej ditën e pra naten i këndoj. Ish vjershtar e këngëtar. E fjalët e vjershevet e të graxetavet që këndoj, qindruan stisur te koca e gjindjes. Një e kushërira jonë, dhe e tija, Maria Markut, i mbanej mendë gjithë, e ja rrëfijati e ja këndoj, një e një, Gustinit Buzëdhelprit, të nipit Markut tonë dhe (birin t'Anitës), për tezin e llaures tij. Te viti 1940 u martua me një çivijtote, Maruca Milljunarit, e iku ka Purçilli. Vitin pas, qe i thrritur e pat venej nd'guerret. Guerra firnoj po vllau jonë s'u pruar më ndi shpi: e

vrane bumbat e një aeroplani që s'dinej se kish qënë firmartur armistixi. Kish 33 vjet. Vjershet që ai venej ture studhjtartur e pra këndoj, i shkruanej mbi një librit, që vate i bjerrë. Marku s'bënej vet poezi popullorë mbi motivet e vjershëve po edhe ai vet e krijoi një motiv vjershi, që sot njihet si "vjershi laj Markut". Zë kshu: "Dolla te sheshi që shprishjen bëlic, / kallarmu, lule, se t'i solla këpuct...". Kultimi tij sot rron kështu, bashkë me vuxhen e me vjershin e tij.

(e shkruajtin Anita e Lena Markut (motra), mbi Jeta Arbëreshe, nr. 30/2004, faqe 14)

Katundi jonë i vogël shumë

Katundi jonë i vogël shumë,
gjëndshin burra shumë të mirë.
Shurbien me kroq e me capill,
rrëmbejen male edhe marinë.
Ndë malt bëjen karuzë të bardhë,
bukë e viskote si kuralë;
ndë marinet bëjen mumbak
e iajen vashaz me bondat.
Nd'argali bëjen pëlhurë,
qepjen kurredhin me amur:
zhgjetza më m'i ndringllonej,
faqja vashes zbukuronej,
pa ngrënë fetina i dritësonej.
Mirenda tire ishen tre fiq,
sit e tire i bëjen dritë.
Vet tri fëmilë të bgetëz shumë:
një Paxh, nj'Miralë e nj'Parapunjë.
Paxhi ish shumë i bgate
se ish kumbar me rregjin pjak:
kur vijen servjendrat t'zotit rregj,
makina tire karroc e kuel.
Paxhrat Krishti s'i bekoj
e rrëkiet e tire i vanë te prroi.
Storja tire është e gjatë,
mund folja sot njera menatë.
Ma folmi pir kta Parapunj
q'katundit tire bën mirë shumë.

Lena Markut bën nj'qind vjet, mburoftë!

purtuni tij ish sembri hapt:
si dihej, gjënde zballankat.
Ngjitshin t'bgjet e poverjel
e jipjen fting e kunxlér;
kunxile jipjen pa paguar
se turres kishen pa nëmruar:
ish e gavarjen nj'pedhamend
gjet'tin nj'kakavë me shumë mareng.
Spëndojoen ver me at kanatùn,
pijen pjeq edhe guanjun
e pra i bëjen ftingë shumë.
Dhën Andoni ish shumë simbatk
e grat i kish me at lopat.

(Jeta Arbëreshe, nr.32/2005, faqe 4)

Urime cje Rones

Cje Rona leu nj'qind vjet si sot
e na mbjoth Bashkia me nderë pjot,
për kët gjell ç'i dha Inzot.
Leu tek një e madhe fëmilë,
është ajo e dijta bilë
(sot me ne kemi edhe at cje Dilë
ç'është me nipa e me bil):
kater motra si suldet,
kto Markizla, hajdhjar vërtet.
Kur cje Rona u bë kopile,
faqja saj një trondofile:
kurmi saj një mes-piret,
veshnej stolizit me mburrllët.
Ësht vërtet, ndënj sembri vet,
po pat urtësi edhe shëndet;
bëri ftingë ture kënduar
sikur kish gjetur një terzuar.
Vet vet kuarnej një cop
se shum fuqi i dha Inzot:
ndë malt mbill karuz të bardhë
t'bënej kravele si kuralë.
Me time bilë bëri skollë serall
për t'xënej firmen e asaj pagë.
Pra kur holl-holl zënej atë vjersh,
harroje t'lodhurit e dilje mb'shesh;
e kur ulej nd'gjitori
gëzjoen pjeq edhe të ri;
e ndëse ishen shtat o tet,
nj'mellodhi ish ndëpir jetë.
Me kangjele e me graxeta

vashat rrijen si maceta:
tue kujtuar motin e parë,
kur, edhe pa ngrën, rrihej hajdhjar;
kur dashuria edhe shkulqia
folej me prindin, bashk, te shpia.
Kur këndojoen pra ka udha re,
thrrisjen: "Ngreu, cje Ronë, e nga me ne".
Cje Rona ndihu miq edhe gjiri
sikur kish një masari;
pse te jeta u kutëndua,
ajo me prindzit kshtu m'u mbsua.
Moj cje Ronë, sot ç'bën nj'qind vjet,
do t'na e shllosh ti një graxetë?
Na t'rrimi afer me hare
se ke t'rrosh si ai Noë!
Pra vet Qielli ka të t'bekonj
e neve edhe s'ka t'na harronj!

(Jeta Arbëreshe, nr.40/2005, faqe 2)

Zotit Manuell

Zoti jonë me vitra shumë
çë servirti këtë katund:
ai na dish mirë shumë.
Na mbësoi meshen arbresh:
kur meshen ai këndon,
vuxha tij i ndringëllon,
mosnjari mund e harronj.
Ai bëri nj'Vokabullar
se gjuha jonë mos t'ish e ndarë.
Kur ai bën predhken e gjatë
na jep kunxile dhaj si tatë.
Zoti është një studhjatur
sa doj t'e bëjen bonxinjur:
ai dish të rrij te kopshti tij
se gjith katundi e dish mir.
Pregarmi gjith të rronjë shum
mos t'lërë si dhenzit kët katund.

(Jeta Arbëreshe, nr.52/2007, faqe 11)

Urim zotit Mink

Katundi jon na bën drit sot,
se shumë trima me bes na bëhen zot.
Sot na u çel një ill i thjell
Se na u ordinar Minku Randell.

Lena Markut bën nj'qind vjet, mburoftë!

T'ish e jëma te kjo ditë!,
 ajo e ëndërrnejt t'birin prift.
 Po prindt gzojen te jetra jet
 se tre katund i bëjen nder për këtë Mesh.
 Ai ka Krishti qe i thrritur e i bekuar
 pse fjalën e Vangjelit ka t'ver tue msuar.
 Ai e di, nëng gjën udh mbar,
 po me Shpirtin Shëjt ka t'jet prift hajdhjar
 të llargonj mbëkatjen si ushtar.
 Sa t'kemi një jet më lipisjar,
 më shumë ka t'mbjeth trimat e ri:
 atyre besa Krishtit më ju ngri.
 S'vijen mb'Qish me dashuri
 se zëmra tire ë' pshtjellë me errsi.
 Po ti je nj'arbresh me shumë fuqi
 e vete gjën të miren ka do rri.
 Si bëri Skanderbeku nd'at Shqipri
 që luftoj pir Besen, me turkun aq i zi.
 Zoti Pishkop na bën nder sot
 E thot se kam rrimi qast ka Inzot.
 Urime për t'rroni me shumë shëndet
 sa t'thoni mesh për një qindez vjet!

(Katundi Ynë, nr. 97/1998, faqe 18)

b) Të tjera Graxeta e Poesi

Graxeta

Moj ti spasez me kulëndra,
 mirr trimin që t'thot zëmra;
 se nat e dit u të pënxonj
 se zëmra tënde të shërton.
 Ndë të marrsha u, të shëronj
 pa jatrë e pa jatronj.

Paparune ka Pulini,
 Thumnie drejt se s'do t'm'e jini;
 po ndë s'm'e dhëfshi me të mir,
 hinj mbrënda e e marr pa hir;
 bilen ndë s'm'e dhëfshi mua,
 ju e kallonj kur t'vér mbë krua!

(ka teza e llàures e të nipit Agostino Giordano: "Poezi popullore Frasnitë e Ejaninë, faqe 705, Universiteta e Rromës, Viti. Akademik 1973-74; Regjistrime 1973).

Graxetë

Dilni shok e vem e kndomi,
 ktij katundi kem t'i thomi:
 Pesëqind vjet edhe sot
 Prindët tanë erdhtin nd'at mot
 Ka Shqipria me shumë keq
 Po prima të rri i dhan jet.
 Ata zun rrënj e shurbien shumë,
 shqiptin dhera e mbulltin grur.
 Stistin shpi e bën amur,
 Hajen pak e kndojen shumë.
 Mbajtin besen e luftuan,
 Atdehun llargu nëng harruan.
 Tez zëmra tyre mbajen vluar
 Se ishen të but e dhe gëzuar,
 E mbësjojen Skanderbekut storjen
 Se tek vallet t'e këndojen;
 e bëjen nderë ndë Italli
 që i dha buk edhe Liri.

(16-4-1991)

Fjëm, ti bir, me buz mb'gas...

Qeni Math dirgoi Konondrenë
 Shën Bumbimin do t'e vras,
 i Jati s'do që të m'e ngas...
 ...Fjëm ti Bir me buz mb'gas,
 parë se Judha tij të t'ngas;
 fjëm, ti Bir, me fasht ngjeshur,
 parë se Judha të t'përqeshenj;
 fjëm, Ti Bir, ti njeter or
 par se t'vën kallmrin mb'dor;
 fjëm, ti Bir, ti njeter kuart
 par se të t'vën tirkuzen ngrah;
 fjëm, ti Bir, ti njeter çik
 par se tij të t'vën mbë kriq.
 U më qanj e më firohem
 e ku e di gjindjat ndë kultohen.

(kalimere Natallesh / 9-2-1991)

Dì fjal Peshkopit

Mir se mbijdhemi sonde, shok,
 se na kemi këtë Peshkop:
 na hapmi zëmren me haré
 se du d'gjegjmi një fjalë të ré.
 Një fjal të ré edhe të urt

Lena Markut bën nj'qind vjet, mburoftë!

t'xëmi se Krishti ish një i but.
Te kjo e mira e e liga jet
Na dishromi nje vertet.
Oj Peshkop, i miri zot,
çë na thua neve sot?
Çë na thua për këtë mot
ç është zbandat e me turp pjot?
Kush kallon, kush thot lik, kush vret,
kush drogaret e do vet turres!
U harrua ai mot i par
Kur prindt tan erthtin tue qar
Ka Shqipria me shum keq
Për të mbajen Krishtin a at fjalën vet?
Ata mbajtin besen e dhe luftuan
E atdheun llargu nëng harruan
E na lan thën se kish rrijem vëllezëruar!
Nani, ku vanë gjithë kta të mbësuar?
Ma u kam bes se te kjo jet
Krishti s'mund na lër maj vet!
Ndihna sot, oj ti peshkop,
të kapirmi Vangjeli çë na thot:
t'e mbami vlaur te zëmra jon
sa të rromi për gjithmon.

(27 maj 1992)

T'pregarenj u, zoti Peshkop,
të folsh me kta trima t'ri
se atire besa më ju ngri,
s'vijen më mb'qish me armuni.
Foli ti, zoti peshkop,
t'vijen mb'qish ka Inzot;
se ndëse s'janë t'kndojen at Mesh
qisha qindron si një disërt.

(pa datë)

Per Zotin Manuell

Zoti jonë me vitra shum
Çë sirviti këtë katund:
sirviti e m'i dish mir
sikur ishen bilt e tij.
Zoti jon i urtë shum,
doj t'e bëjen bonxinjër:
ai dish t'rrij te kopshti tij
se katundi e dish shum mir.
I augurarmi një mil vjet
Të rronjë sa do vet.

(9-7-2010)

Frasnitë është ajer i mirë

Frasnitë është ajer i mirë
me ver shum e Çimenderi:
çë dha turres pa nomruar,
s'është faregjë pa dishëruar.
Edhe t'vdekurit mbjojen me lule:
fra me lule e me maceta
sikur jan te nj'Parrajs virteta.
Pjot kto udha me makina shum
se jan turreszit pa dhullur,
se Guverni shum i finanxjaren
e kriet gjindjes ja mbishkaren.
E turrest s'dimi si t'i spëndomi
e bjemi mish e Kokakòlen
e pra thomi se kemi kolesteròlen
e rrangarmi ka jatroj;
ai nëng ka më çë t'na thorë,
thot:"Bëni dhjetën me shkarollë".

(pa datë)

Graxetë

Një dit na kuarjem "Nënkatund":
tri vasha imshem e im vlla guanjùn.
Benej vap sa s'und e rrstojem
E u vum mbë hje e më këndojem.
Me këndimet zgjuam nj'katund
Sa dall një pjak te një ballkun;
tha:"Do të prirsha u guanjùn
t'martoja nj'vash me këndime shum;
se ajo zëmren më t'e mbjonej
sa nj'mil vjet na mund të rrojem!...
...Gusti, nisu e më nxhidhir
Këta vjershe e kndime t'mir,
ka kta burra çë m'i din
e ç'i kënduan Ejanin.
Nd'zëmret time m'lan nj'shërtim
Se gjegja vjershin e vllaut tim.
Nxhidhiri parë se t'trakulòjen
Se pra s'jan më kush t'i kndojen...
Mbjith kopile e trima t'ri
E mbësoji kënka e melodi...
T'mos t'i marr ajri vorë
kòto vasha... pa porë...

(9-7-2010)

Apòdhipnon mikron, arbërisht

(pruar arbërisht) **Emanuele protopapas Giordano**

ka Frasnita (Cs)

Prifti: I bekuar Perëndia ynë, për gjithmonë, nani e përherë e në jetët e jetëvet.**Populli:** Amin:**Prifti:** Lavdi Tij, o Perëndi, o shpresa jonë, lavdi Tij.

O mbret qiellor, ngushëllimtar, Shpirt i së vërtetës, që ndodhe kudo e mblon të gjitha; thesar i të miravet dhe jetëdhënës, eja e qëndrë në mes të neve, e pastrona nga çdo mbëkat dhe shpëtò, o i mirë, shpirtrat tanë.

Trishëjtore (Trisajon)**Populli:** Shëjt Perëndi, Shëjt i Fuqishëm, Shëjt i pavdekshëm, kijna lipisi (3 herë).

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjt, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Trini e tërëshëjtë, kijna lipisi; o Zot, falna mbëkatat tona; o Zot i madh, ndëlena paudhësitë tona për lavdinë e ëmrit tënd.

Lipisi o Zot (3 herë)

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet. Amin.

Ati ynë, që je ndër qiel, u shëjtëroftë ëmri yt; ardhhtë rregjëria jote, u bëftë vullimi yt si në qiell ashtu mbi dhé. Bukën tonë të përditshme ëna neve sot dhe ndjena neve detyrat tona si edhe na ja ndjejmi detorëvet tanë, dhe mos na shtjer në ngasje, po lirona nga i Ligu.

Prifti: Se jotja është rregjëria, fuqia dhe lavdia, e Atit, e Birit dhe e Shpirtit Shëjtë, nani e përherë e në jetët e jetëvet.**Populli:** Amin

Lipisi, o Zot (12 herë)

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi Perëndisë, Rregjit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi Krishtit Perëndi, Rregjit tonë.

Ejani t'i falemi e t'i përmisemi vetë Krishtit, Rregjit e Perëndisë tonë.

Psalmi 50 (këndohet)Kij lipisi për mua, o Perëndi, pas lipisisë sate të madhe
dhe, pas dhëmbshurivet të tua të shumta, shuaje paudhësinë time

Lajmë më shumë prej paudhësisë sime

edhe pastromë prej mëkatit tim

Se u e njoh paudhësinë time

e mëkati im është kurdoherë përpara meje

Bëra mëkat kundër tij vetëm

edhe përpara teje bëra të ligën,

kështu që ti je i drejtë ndër fjalët e tua

e i këthjellët ndër gjykimet e tu

Se njo ndër të ligat qeva i piksur

e ndë mëkata më leu mëma ime

Se njo ti dishe mirë të vërtetën,

të fshehurat e të panjohurat e urtësisë sate ti m'i zbulove

Lyejmë me hisop e u do të pastrohem,

lajmë e u do të bëhem më i bardhë se bora

Bën të gjegjënj gëzim e haré,

eshtrat e mi të përlurur do të gëzohen

Prir mënjane faqen tënde nga mbëkatat e mia

edhe shuaji gjithë paudhësitë e mia

Stis një zëmër të pastër tek u, o Perëndi,

Apòdhipnon mîkron, arbërisht

dhe përtërir përmbrenda meje një shpirt të drejtë
 Mos më resht llarg prej faqes sate
 e mos nxir prej meje shpirtin tënd të shëjtë
 Ëmë prap gëzimin e shpëtimit tënd
 e fortëromë me shpirt madhështor
 Do t'i mësonj të paligjëvet udhët e tua
 dhe të pabesët do të priren tek ti
 Shpëtomë prej gjakrash, o Perëndi, Perëndia i shpëtimit tim,
 e gjuha ime do të lavdëronjë me gëzim drejtësinë tënde
 O Zot, hapi buzët e mia
 e gola ime do të rrëfeynjë lavdinë tënde
 Se ndëse ti kishe dashur një therore, u t'e kisha dhënë,
 po tij holokaustet s'të pëlqejn
 Therore ndaj Perëndisë është shpirti i përdhëmbur:
 një zëmër të përdhëmbur dhe të përulur Perëndia nëng do t'e shanjë
 Bën'i mirë, o Zot, Sionës pas mirëdashjes sate dhe le të ndërtohen
 muret e Jerusalemit.
 Ahiera do të të pëlqejn therore
 drejtësisje, dhurata e hollokauste
 Ahiera do të të sjellën viçra mbi altarin tënd.

(Shih: *Emanuele papas Giordano, Himne Liturgjike..., faqe 135*)

Psalmi 69

Eja e lirômë, o Perëndi,
 eja shpejt, o Zot, e ndihmë .
 Qofshin tërbuar e turpëruar
 ata që duan të më vrasën,
 U pjërrshin prapë e qofshin shajtur
 sa duan dëmin tim.
 Për turpë u pjërrshin prapë
 ata që më përqeshjën.
 Gëzim e harë të madhe
 për ata që të kërkojnë.
 Thofshin ngamot: "Perëndia është i math",
 ata që duan shpëtimin tënd.
 Po unë jam i nëmur e i pafat,
 eja shpejt, o Perëndia im;
 ti je ndihma ime e Shpëtimtari im;
 o Zot, mos mënò!

Psalmi 142

O Zot, gjegj të falurit tim,
 mirr vesh lutjen time pas vërtetës sate,
 gjegjmë pas drejtësisë sate.
 Dhe mos hyr mbë gjykim me shërbëtorin tënd,
 se mosnjë i gjallë mund të dalë i drejtë përpara teje
 Se armiku rrahu shpirtin tim,

Apòdhipnon mikron, arbërisht

përuli jetën time për dheu:
 më vu të rri ndër vende t'errët
 si të vdekurit ç'ka mot.
 Prandaj m'e zu hijdhia shpirtin tim
 e zëmra ime u taraks përmbrenda meje.
 Kujtova ditët e shkuara,
 mendova gjithë të bënat e tua, tue menduar mbi të bënat e duarvet të tua.
 Ndëjta duart e mia drej teje,
 shpirti im ka etë për tij si dhé i thatë.
 Shpejt gegjimë, o Zot,
 m'u zu fryma.
 Mos prir mënjane faqen tënde prej meje,
 se mos t'i gjas atyre që zbryten ndë varrt.
 Bën të gegjënjë lipisinë tënde që menatet,
 se u tek ti pata shpresë.
 Bën të njoh udhën tek cila kam ' ecënj,
 se tek ti ngrëjta shpirtin tim.
 Shpëtomë nga armiqtë e mi, o Zot,
 tek ti u erdha e u fsheha.
 Mësomë të bënj vëlimën tënde,
 se ti je Perëndia im.
 Shpirti yt i mirë le të m'udhëronjë mbi dhé të drejtë.
 Për ëmrin tënd, o Zot, ngjallmë;
 në drejtësinë tënde nxir shpirtin tim nga ngushtica.
 Dhe në lipisinë tënde asgjësò armiqtë e mi,
 e humb gjithë ata që helmojnë shpirtin tim,
 se u jam shërbëtori yt.

Dhoksollojia (këndohet)

- Lavdi Tyj që na buthtove dritën, lavdi Perëndisë në të lartat edhe mbi dhé paqë ndër njerzit mirëdashje.
- Të himnojmë, të bekojmë, tyj t'adhurojmë, të lavdërojmë, të falënderojmë për lavdinë tënde të madhe.
- O Zot, mbret qiellor, Perëndi, Atë i tërëfuqishëm, Zot dhe Bir i vetëmlindur, Jisu Krisht dhe Shpirt i Shëjtë.
- O Zot Perëndi, Qengji i Perëndisë, Biri i Atit që nxier mbëkatën e jetës, po kijna lipisi, ti që nxier mbëkatet e jetës.
- Prite faljen tonë, ti që rri ndë të djetat të Atit, edhe kijna lipisi.
- Se ti je i vetmi Shëjt, ti je i vetmi Zot, Jisu Krisht, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin.
- Për çdo ditë do të të bekonj dhe do t'ë lavdëronj ëmrin tënd për jetën dhe në jetën e jetës.
- Vlerësoma, ti o Zot, ndë këtë ditë, të ruhem pa ndonjë mbëkat.
- I bekuar je, o Zot, Perëndi i Etërvet tanë, dhe ëmri yt është i hymnuar dhe i lavdëruar në jetët. Amin.
- Le të jetë, o Zot, përdëllimi yt mbi ne, sikundër kemi shpresuar tek ti.
- I bekuar je, o Zot, ti mbësomë të drejtat e tua. (3 herë)
- O Zot, u bëre ti streha jonë gjeneratë mbë gjeneratë; unë thashë: o Zot, kijmë lipisi, shëroje shpirtin tim sepse të mërijta
- O Zot tek ti gjeta strehim, mbësomë të bënj dëshirën tënde sepse ti je Perëndia im
- Se ti je burimi i jetës, me dritën tënde do të shohim dritë
- Ti zgjate lipisinë tënde mbi ata që të njohin
- Shëjt Perëndi, Shëjt i Fuqishëm, Shëjt i pavdekshëm kijna lipisi (3 herë)
- Lavdi Atit e Birit... Nani e përherë Shëjt i Pavdekshëm kijna lipisi
- Shëjt Perëndi, Shëjt i Fuqishëm, Shëjt i pavdekshëm kijna lipisi.

(Shih: Emanuele papas Giordano, Himne Liturgjike..., faqe 136)

Apòdhipnon mikron, arbërisht

Besonj në një Perëndi / Pistëvo is ëna Theon

Besonj në një Perëndi, Atë të tërëpushtetshëm, krijues të qiellit e të dheut e të gjithë të dukuravet e të padukuravet. Dhe në një Zot, Jisu Krishtin, Birin e Perëndisë, të vetëmlindurin, që leu prej Atit para gjithë jetëve. Dritë prej Dritje, Perëndi të vërtetë prej Perëndije të vërtetë, të lerë, jo të bërë, të njëqënëshëm me Atin, me anën e të cilit u bënë të gjitha. Çë për ne njerëz e për shpëtimin tonë zbriti prej qiellvet dhe mori kurm prej Shpirtit Shëjtë edhe Virgjërës Mëri e u bë njeri. Dhe që kryqëzuar për ne nën Ponc Pillatin dhe pësoi dhe që varrosur. Dhe u ngjall të trejtën ditë sipas Shkronjavet. Dhe u hyp në qiell dhe mri ka e djathta e Atit. Dhe do të vinjë përsëri me lavdi të gjykonjë të gjallët e të vdekurit, e rregjësia e tij s' do të ketë mbarim. Dhe në Shpirtin e Shëjtë, Zot e jetëbërës, që buron prej Atit, që adhurohet e lavdërohet bashkë me Atin e me Birin, që foli me anën e Profitëvet. Në një Qishë të shëjtë, katolike dhe apostolike. Rrëfenj një pagëzim për ndjesën e mbëkatëvet. Pres ngjalljen e të vdekurvet. Dhe gjellën e jetës s' ardhshme. Amin.

Të ka hjé / Áksion estin

Të ka hjé me të vërtetë të të lumturojmë Tyj Hyjlindësen gjithmonë të lumturën dhe të pëmbidëlirën dhe Mëmën e Perëndisë tonë.

Më të nderuarën se Hjeruvimet dhe më të lavdëruarën pa përjasje se Serafimët; që, pa u përlyer, linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindësen Tyj të madhërojmë.

(Shih: *Emanuele papas Giordano, Himne Liturgjike..., faqe 149 / 166*)

Trishëjtore / Trisajon) (shih më lartë)

Tropare

O Perëndi i Etërvet tanë, ti që je gjithmonë me ne, sipas butësisë sate, mos e llargò ka na lipisinë tënde, po me lutjet e tyre drejtoje në paqë jetën tonë

Me gjakun e martirëvet të tërë jetës e stolisur me purpur e me bis tyj të thërret Qisha jote, o Krisht Përëndi. Dërgoji lipishtë e tua popullit tënd, jipi paqe shoqërisë sate edhe lipisinë e madhe shpirtit tanë (*Ton en olo...*)

(Shih: *Emanuele papas Giordano, Himne Liturgjike..., faqe 18*)

Lavdi Atit...

Bashkë me shëjtrat prëji, o Krisht, shpirtat e shërbërorëvet të tu, atjë te nuk ka më dhëmbje as hijdhì, as shërtim, po vetëm jetë të pambaruar. (*Metà ton Ajlon...*)

(Shih: *Emanuele papas Giordano, Himne Liturgjike..., faqe 195*)

Nani e përherë...

Me ndërmjetimet e gjithë Shëjtravet e të Mëmës së Perëndisë, ëna neve paqen tënde, o Zot, e kijna lipisi, si i vetmi lipisjar.

Prifti: Ti, që në çdo mot e çdo herë, në qiell e mbi dhe, je i adhurar dhe i lavdëruar, o Zoti Krisht Perëndi, zëmërgjerë, shumë lipisjar e plot dhëmbshuri; ti që do mirë të drejtët dhe i ke lipisi mëkatarëvet, ti që thërret çdo njeri të shpëtohet me të taksurit e të miravet të ardhshme; ti vetëm, o Zot, mbliidhi në këtë herë edhe lutjet tona e drejtoje jetën tonë sipas kumandamentevet të tu. Shëjtërona shpirtat tanë, bëj të pastër kumet tanë, drejtësò të folurit tanë, pastrona mendimet tanë, dhe lirona nga çdo helm, ligësi e dhëmbje. Rrethona me ëngjëjt e tu të shëjtë, ashtu që, të ruajtur dhe të udhëtuar nga ata, të mund 'erëjmë te njësia e besës dhe te njohja e lavdisë sate të paafreshme; se ti je i bekuar në jetët e jetëve.

Pop.: Amin.

Lipisi o Zot (3 herë) Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit ' Shëjtë, nani e përherë dhe në jetët e jetëve. Amin

Më të nderuarën se Hjeruvimet dhe më të lavdëruarën pa përjasje se Serafimët, që pa u përlyer linde Fjalën Perëndi, me të vërtetë Hyjlindëse, Tij të madhërojmë.

Në ëmrin e Zotit, o zot, bekona.

Apòdhipnon mikron, arbërisht

Lutje Shën Mërisë

Prifti : O Virgjëreshë e papërlyer e pangarë, e panjollëshme, e pakorruptuar, e pastër, kryezonjë, nuse e Perëndisë, që bashkove Fjalën Perëndi me njerëzit, dhe me të lerit tënd të çuditshëm bashkove natyrën tonë të ratë me qielloret. E vetmja shpresë e të dëshpëruarvet dhe ndihma e të luftuarvet; përkrahja e gatshme e atyre që vijën tek Ti; strehë e gjithë të krishterëvet; mos më resht mua, mbëkatarin, të mallkuarin, që zhyejta të tërë jetën time me mendime, fjalë dhe vepra të turpshme, dhe u bëra shkllav vullnetarisht për varesi mendore e ka gëzimet e jetës; po Ti, si Mëmë e Perëndisë që do nirë njerë zit, me dashuri e lipisi tundu për mua mbëkatar e të turpëruar dhe prit lutjen që të dhurohet ka buzë të zhyera dhe parkalës birin tënd dhe Zotin tonë të më hapën edhe mua zëmren njeridashës të mirësisë së Tij; dhe, tue mos ruajtur fajet e mi të panomruar, të më prier në pendim dhe të më bënë punëtor të sprovuar të urdhërimevet të tij. Dhe ji ngamot mbanë meje, si e tërëlipisjare, hirplotë dhe mirëdashëse; te kjo jetë, mbrojtëse dhe ndihmëse e ngrohtë, tue reshtur sulmet e kundështarëvet dhe tue më udhëtuar drej shpetimit; dhe, te hera e vdekjes sime kujdesu për shpirtin tim të mjerë dhe llargò pamjet e djelvet të keq; dhe te dita e trëmbëshme e gjykimit shpëtomë ka pisa e bëmë trashgimtar të lavdisë së pathënëshme të Birit tënd e Perëndisë tonë. Këtë lavdi e patsha, o kryezonja ime, dhe e tërëshëjtja Mëmë e Perëndisë, me lutjet e ndihmës sate, per hirin e njeridashjen e birit tënd, Zotit Perëndi e shpëtimtarit tonë Jisù Krisht; kuj i nget çdo lavdi, nderim dhe adhurim bashkë me Atin e Tij të pafillim dhe me Shpirtin e tij të Tërëshëjtë, të mirë dhe jetëbërës nani e përherë e në jetë të jetëvet. Amin.

Lutje Zotit tonë Jisù Krisht

Prifti: Dhe jipna neve, o Kryezot, që shkojmi të fjëmi, prëhje kurmi e shpirti; dhe ruajna ka gjumi i errët i mbëkatit dhe ka çdo dëshirë e errët të natës; qetësò sulmet e epshevet, shuaji shigjetat e zjarrtat të të ligut që djallzisht prier kundër neve; shuaje kryengritjen e kurmit tonë dhe qëllò çdo mendim jetje e materjale; dhe jipna, o Perëndi, mendje vigjilluese, mendim të zgjuar, zëmër të përmbajtur; gjumë të le, pa ndonjë fantazi satanike; dhe zgjona te hera e lutjes të fortë suar me urdhërat e tu, tue pasur gjithmonë ndër mendjet tona kujtimin e gjykimevet të tu; jipna se himni i lavdisë sate të mbjonjë tërë natën, se të kremtojmë, të bekojmë, të lavdërojmë ëmrin tënd të përnderuar e madhështor, të Atit, të Birit dhe të Shpirtit ‘ Shëjtë, nani e përherë e në jetë të jetëvet Amin.

O e Përmblavdëruar Virgjëreshë, e bekuar Hyjllindse, dërgoji faljen tonë Birit tënd dhe Perëndisë tonë dhe lypi të shpëtonjë, me anën tënde, shpirtrat tanë.

Shpresa ime Ati, strehimi im Biri, mbulesa ime Shpirti ‘ Shëjtë, Trini e Shëjtë, lavdi Tij.

Gjithë shpresën time e vë tek Ti, o Mëma e Perëndisë: ruajmë nën mbrojtjen tënde.

Prifti: Me uratat e Etërvet tanë të Shëjtë, o Zoti Jisù Krishtit Perëndia ynë, kijna lipisi edhe shpëtona.

Populli: Amin.

ALFABETIZZAZIONE ARBËRESHE

(Abetare, Gramatikë, Histori, Letërsi, Folklor, Rit, Muzikë, Glosar)

2 libre - euro 5,30

(editor Shoqata Aiadi, Ungër; botues “Il Capitello”, Torino 2000;

Redaktorë: I.C.Fortino (koordinator), V.Bruno, A.Giordano, papas E.Giordano, C.Stamile, E.Tocci)

Telefononi Antonio Uberti-t

0982 - 582241

Rosolino Petrotta, Zef Skirò jr., Matteo Sciambra

Zef Skirò Majit

ka Hora e Arbëreshëvet (Pa)

Gustini më lyp “kujtime” për tre personazhet sikulo-arbëreshë të shkruar te titulli, sikurse u të kisha një moshë matuzalemiane, ndërsa nga pak kam mbushur shtatëdhjetat.

Të zotit **Rozolino Petrotta (1894-1969)** ka Hora e Arbëreshëvet, e dimë gjithë punën që i kushtoi për shumë vjet bashkësisë arbëreshe të Siçilljes. Më dukej se pa ‘të ngë mënd t’u kishën mbajtur shtuara as Eparhia e Horës së Arbëreshëvet as Instituti për Gluhën e letërsinë shqiptare te Universiteti i Palermës as ngjarjet kulturore që organizoj Qendra Ndërkombëtare për Studimet Shqiptare tek ai universitet, Qendër i së çilës ai ish presidenti. Një studim objektiv mbi veprimtarinë e tij në të mirën e Arbëreshëvet do të vëjë në dritë patjetër rëndësinë gjellësore që ai pati te të ruajturit identitetin tënë. E para herë që pata nderin t’ë përpigja nga ndanëz ndodhi pas botimit te “Annuario Accademico 1965/66” të Qendrës Ndërkombëtare të një poezije time kushtuar Zef Skiroit (1865-1927) për qindvjetorin e të lerit. Falë papasit Mateo Shambra, asistent për shqipen te Universiteti i Palermës, që tek ato vjet frekuentoja, ajo poezi jime kish sosur te “Annuario” i thënë. Si u mbyll mbledhja e festës së 28 Nëntor, festë vjetore venë sipër nga Qendra Ndërkombëtare, papas Mateo Shambra i tha presidentit se isha u atje përpara fizikisht autori i asaj poezije. Rosolino Petrotta një herë më dhuroi fjalorin e çmuar të Leottit me kushtim.

Profesorin **Zef Skiro Junior (1905-1984)**, ka Kuntisa (Junior përballë Senior-it të Horës, emërim i dhënë për vlerat e tij prej studiuesi të shërbisevet bizantine e arbëreshe) e përpoqa vetëm një herë thomse te gushti i vitit 1985 Kuntisë, hora ku leu, në ndodhjen e njëj Ditje kulturore kushtuar atit Lorenzo Tardo (i çili, te të parat vjet 1960 Grottaferratë, pajisur kamot me shkopin e pleqërisë, ngaherë na thoshëj: ‘Mësoni tri fjalë të gluhës neogreke nga ditë e tek pak qëro do t’ë përvetësoni’). U qasa te profesori Zef Skiro (Junior) e i thashë se thrritesha si ai, por për përlulësi dallimi kisha shtuar mbiemrin mëmësor Di Maggio. Isha një thrime i emocjonuar e i pasigurtë për një shërbes që do të rrëfyen. Zef Skiroi (Junior) ish edhe një nga personazhet të poemës sime në tetërrokëshe të lira “Ndëpër udhat e Parrajsit shqiptarë dhe t’Arbëreshë” që kisha sosur të shkruaja te viti 1974, e kisha dre mos atij ngë do t’i kish pëlqyer. Mbajëm mend një skenë parrajsore te sektori shqiptar pikërisht të parrajsit. Atje ndodhet një shesh me një pedanë (mbështetëse këmbësh) rrumbullake, rrotulluese mbi një strumbull, e dy

Agostino Giordano mi chiede “ricordi” dei tre personaggi siculo-arbëreshë nominati nel titolo, come se io avessi un’età matusalemmitica, mentre ho appena compiuto settant’anni.

Dell’**on. Rosolino Petrotta** conosciamo tutti l’impegno profuso per lunghi anni a favore della comunità arbëreshe in Sicilia. Mi sembrava che senza di lui non avrebbero potuto reggere né l’eparchia di Piana degli Albanesi né l’Istituto di Lingua e letteratura albanese all’Università di Palermo né le iniziative culturali annuali che metteva in campo presso la stessa università il Centro Internazionale di Studi Albanesi, di cui era presidente. Uno studio obiettivo sulla sua attività a favore degli Arbëreshë metterebbe in luce sicuramente l’importanza vitale che egli ebbe nella nostra difesa identitaria. La prima volta che ebbi l’onore di incontrarlo da vicino fu in seguito alla pubblicazione nell’Annuario Accademico 1965/66 del suddetto Centro Internazionale di una mia lirica dedicata a Giuseppe Schirò (1865-1927) nel centenario della nascita. Tramite papas Matteo Sciambra, assistente di albanese all’Università di Palermo che in quegli anni frequentavo, quella mia lirica era finita nell’Annuario. Alla fine della manifestazione del 28 Novembre, festa annuale organizzata dal Centro Internazionale, papas Matteo Sciambra disse al presidente che ero l’autore in presenza fisica di quella poesia. Rosolino Petrotta una volta mi regalò il prezioso dizionario Leotti con dedica.

Il professor Giuseppe Schirò (Junior rispetto al Senior di Piana, appellativo acquisito per meriti di studioso di cose bizantine e arbëreshe), lo incontrai solo una volta, forse nell’agosto del 1985 a Contessa Entellina, suo paese natale, in occasione di una Giornata culturale dedicata a p. Lorenzo Tardo (il quale, già dotato di bastone di vecchiaia, nei primi anni ‘60 a Grottaferrata, ci ripeteva: ‘Imparate tre parole di neogreco al giorno e lo avrete in poco tempo acquisito’). Mi avvicinai al professore Giuseppe Schirò (Junior) e gli dissi che mi chiamavo come lui, ma che per umiltà di distinzione avevo aggiunto il cognome materno Di Maggio. Ero un po’ emozionato e trepidante per via di un fatto che esporrò. Giuseppe Schirò (Junior) era anche un personaggio presente nel mio poema in ottonari liberi “Ndëpër udhat e Parrajsit shqiptarë dhe t’Arbëreshë – Viaggio nel Paradiso Albanese” terminato di scrivere nel 1974, e temevo che non avesse gradito. Immaginiamo una scena paradisiaca nel settore albanese appunto del paradiso. C’è una piazza con una pedana rotonda, ruotante su un perno, e due poltrone che essendo attaccate alla pedana ruotano in sintonia.


Rosolino Petrotta, Zef Skirò jr., Matteo Sciambra

frone që, ngase janë ngjitur me pedanën rrumbullake, rrotullojnë bashkë me këtë. Dy fronet janë për dy poetat tanë të mëdhenj, Jeronim De Rada e Zef Skiroi. Poetrat, veç kur bëjnë prëhje te bari për të pirë një kafë, rrinë ulur te fronet e rrotullojnë tue kënduar vjershat e tyre. Lëvizja rrotulluese e pedanës do të thotë se dy poetat janë paraq (barabar) për sa i nget vlerës poetike. Shi' kur bëj emrin e Zefit Skiroit (Junior), ndër spektatorët e fenomenit rrotullues: Afër rrotës njoha gjinde / që po shkruajtën në botë / mbi Poetrat e ndo një / përse thritej Zef Skirò / pati dhënë nga Poeti / gjith' trashgimin letrator / tuke u thritur "Zefi Junior" (Ndëpër Udhat e Parrajsit... K. VIII, vv. 228-236). Prisja nga ai ndo fjalë qortuese. Ndryshe, profesor, që thomse ngë kish zgledhur Parrajsin tim, që ca vjet më parë i kisha dërguar me postë, u dëftua i stërsjellshëm e, ngase bëhej fjalë për "Zef Skironjrat" e gjithë rruzullit tokësor, tha për Seniorin: "Ish një estet i math."

Papa Mateu Shambra (1914-1967), ka Kuntisa, kle këshilltari i mirë i fillimevet tim. Një herë, thomse te muajt e parë të vitit 1965, vajt'e e gjeta te Martorana, ku ish famullitar, e i dëftova ca poezi shkruar litisht. I shturi një sy e më tha: Përçë ngë i shkruan arbërisht? I shkruajta, ia paraqita, kle i gëzuar, ia dha at Zef Valentinit titullar i katedrës për gjuhën shqipe te Universiteti i Palermës, i çili ia dorëzoi, te një kuvend Napul, Ernest Koliqit, që i botoi te Shejzat (X, 1966, 3-4), tuke lajmëruar me një parathënie të shkurtër vazhdimësinë e poezisë arbëreshe. Një menatë e qershorit, thomse, të vitit 1966, ndodhem te terraca e Martoranës të flas me papa Mateun e me papa Vitin Stassi, që ngë mënd të japënj më deshmi për këtë gjë se për fat të keq na la dy vjet prapa. Shkon postjeri e i jep papa Mateut një zarf. Ai e hap, nxier rivistën "Shejzat", e shfleton, qëndron te faqja e kërkuar e tuke shënuar poezitë time të botuara thotë: "Ky ë një moment historik". Mbanj mirënjohje për ato fjalë që tha papa Mateu Shambra, me gjithë se atje për atje i mora me të zakonshmin shpirt tim sarkastik. Kushedi në kle vërtet një moment historik.

Le due poltrone sono per i nostri due grandi poeti, Girolamo De Rada e Giuseppe Schirò. I Poeti, salvo quando fanno una sosta al bar a sorbirsi un caffè, stanno immersi nelle poltrone e ruotano declamando i loro versi. Il movimento rotatorio della pedana indica l'assoluta parità d'importanza dei due poeti. Ecco il momento in cui nomino Giuseppe Schirò (Junior), tra gli spettatori della rotatoria: Afër rrotës njoha gjinde / që po shkruajtën në botë / mbi Poetrat e ndo një / përse thritej Zef Skirò / pati dhënë nga Poeti / gjith' trashgimin letrator / tuke u thritur "Zefi Junior" (Ndëpër Udhat e Parrajsit... K. VIII, vv. 228-236). Mi aspettavo qualche battuta. Invece il professore, che forse non aveva letto il mio Paradiso, che qualche anno prima gli avevo spedito per posta, si dimostrò gentilissimo e, a proposito dei "Giuseppe Schirò" di tutto l'orbe terracqueo, disse del Senior: "Era un grande esteta".

Papas Matteo Sciambra fu il mentore dei miei esordi. Una volta, forse nei primi mesi del 1965, lo andai a trovare alla Martorana, dov'era parroco, e gli mostrai alcune poesie in italiano. Dette un'occhiata e mi disse: Perché non le scrivi arbërisht? Le scrissi, glieste presentai, ne fu contento, le consegnò a padre Giuseppe Valentini titolare della cattedra di albanese all'Università di Palermo, il quale le diede, in un convegno a Napoli, a Ernest Koliqi, che le pubblicò su Shejzat (X, 1966, 3-4), annunciando in una breve premessa la continuità della poesia arbëreshe. Una mattina di giugno, forse del 1966, mi trovo sul terrazzo della Martorana a parlare con papas Matteo e con papas Vito Stassi, che non può più testimoniare quanto dico, perché purtroppo è deceduto due anni fa. Passa il postino e consegna a papas Matteo una busta. Lui la apre, estrae la rivista "Shejzat", la sfoglia, si ferma alla pagina cercata e accennando alle mie poesie pubblicate esclama: "Questo è un momento storico". Sono ancora grato a papas Matteo Sciambra per quelle parole, anche se lì per lì le captai col mio solito spirito sarcastico. Chissà se fu veramente un momento storico.



W
W
W

ARBITALIA

.it
.net

Francesco Antonio Santori

Kënka,” **Karkaleci bën tri-tri**”, pakë e njohur, gjëndet tek faqja 11 të veprës “I burgosuri politik” të Ndon Sandorit, botuar ndë vitin 1848 ndë Napulë. Kënkat të botuar ndë këtë Poem, Italisht, janë pesë e kjo është e dita. Kjo kënkë është një himn naturës pushtjerare. Poeti i këndon punës fshatare; i këndon zogjve, animëjve, pemeve, arave, ecc. Sigurisht kjo është një kënkë shumë realiste.

Karkaleci bën tri-tri

Karkaleci bën tri tri
karkarelja bën kua kua
thot thelëza shokut ri:
“Trashigonjëm gjellën na;
spavet jeta e na lëshon,
lum ai kush e strëngon”.

Moti verës është i mirë
Prë dulinë që rri me të:
Kuarëzori merr pjaxhirë,
kallëzorja nëng e lë,
delëmeri kudo vend
Karramunxat frinë kutjend.
Karkaleci bën tritri ecc.

3.
Fjë guallani mbi dhemate
Meku qerren ngrakoi:
Vasha që te lëmi vate
Agëzohet se grure çoi
Pjono grumbull, e ndë hje
Vete ulet gjithë hare.

4.
Gardhulliqja bën cicli:
kardhakaça bën çllaçla :
polloqidhja bën çici:
korbi bën ndë brinja kra:
bën piçuni tupitu,
vashës i thom: Ti ea këtu.

5.
Të martuames i gëzon
Zëmëra, kur te kallamea

(transkriptoi e pruar lëtisht) **Carmine Stamile**
ka Shën Japku (Cs)

La poesia “**Il Grillo fa tri-tri**”, poco conosciuta, si trova a pagina 11 dell’opera: Il prigioniero politico di Antonio Santori, pubblicata a Napoli nel 1848. Le poesie pubblicate in questo poema, scritto in italiano, sono cinque e questa è la seconda. Questa poesia è un inno alla natura e alla vita del contadino. Il poeta canta al lavoro del campagnolo; canta agli uccelli, agli animali, ai frutti, alle messi, ecc. Certamente questa è una poesia molto realistica.

Il grillo fa cri-cri

Il grillo fa cri cri,
la ranocchia fa qua qua,
la pernice dice al nuovo compagno:
“Godiamo anche noi la vita;
passa il tempo e ci lascia,
beato solo chi sa viverlo”.

Il tempo estivo è buono
per il fresco che (la notte) porta con sé
è felice il mietitore,
la spigolatrice non lo abbandona,
il pastorello dovunque (riposa)
suona la zampogna contento.
Il grillo fa cricri ecc.

Dorme il bovaro sui covoni
caricati sul carro.
la ragazza che si è recata sull’aia
si rallegra perché lo vede
colmo di grano e all’ombra
Va a sedersi tutta contenta.

Il cardellino fa cicli:
la cornacchia fa clacla:
il pulcino fa cici:
il corvo nei dirupi fra cra:
il picchio fa tupitu,
Alla ragazza dico: tu vieni qua.

Alla sposa gioisce
il cuore, quando tra le stoppie

Francesco Antonio Santori

Sheh të birin, se kapton
Pas një fjuturë, e hare
M'i shkëlqen te vogëli ballë
Ku t'e puthinjë, i vjen mallë.
Gardhulliqja bën cicli ecc.

vede il figlioletto saltare
dietro una farfalla e la gioia
brilla sulla piccola fronte
che vorrebbe baciare con desiderio.
Il cardellino fa cicli ecc.

6.
Moi buthtonet neve më
Tas e mirë, se vera, vjeshta,
teku vapa as ndihet gjë
mose gjellbuore vreshta,
rrushet verdha na buthtonjën
e me mushtë na ëmbëlësonjim.
Karkaleci bën ecc.

Ma migliore dell'estate
si presenta a noi l'autunno,
dove il caldo non si sente
e le verdeggianti vigne
ci mostrano i grappoli di uva gialla
che ci danno il dolce mosto.
Il grillo fa ecc.

7.
Delet janë te vjeshta bars
Prë ndë gjithë ato barere
se të kemi, pjela ndë mars,
qëngjet na ndë paravere.
Arëza edhe gonodhin bën,
ku të harë ndë dimërë gjën
Gardhulliqja bën ecc.

Le pecore in autunno sono grvide,
pascolano in ogni prato,
per avere, partorite a marzo,
gli agnelli in primavera.
Anche la vespa prepara il suo favo,
dove in inverno trova da mangiare.
Il cardellino fa Ecc.

8.
Bjeta jep ndë vjesht mjalë.
Është ahierna e pjekur dardha:
janë ullinjet pjot me valë:
mollat janë të kuqe e të bardha:
Janë pushtjerat gjithë karpos,
vashat vetëm agaristos.
Karkaleci ecc.

L'alveare in autunno ci da il miele.
Le pere allora sono mature:
Gli ulivi portano l'olio:
le mele sono rosse e bianche.
Le campagne sono cariche di frutta,
Solo le ragazza sono ingrante.
Il grillo ecc.

Jeta Arbëreshe

(12 vjet: 2002 - 2013)

76 numra, 1.562 faqe

Gjuhë, Letërsi, Histori, Folklor e Lajme ka Arbëria e ka Bota Shqiptare

500 euro

Gjithë 76 numrat në DVD

50 euro

Tel. (+39) 0981-32539 - Associazione Culturale "Jeta Arbëreshe" – 87010 Eianina (Cs - Italia)

Aristi Manes e Domill Tavullari

Janë dy personaxhe nga Shën Benedhit Ullani: Aristi diqi ndë vitin 1974 ndë Santiago të Çile-s, ku shurbeu ndë një Bank, e Domilli diqi Shën Benedhit ndë vitin 1984, ku shurbeu si prevesur ndë skollat elementare.

Pse te ky artikull i vëmë bashkë këta dy intelektualë? Pse simbjë bien për të parin, Aristin, 40 vjetët e për të dytin, Domillin, 30 vjetët që kur diqtin; pra pse, të dy nga Shën Benedhiti, u interesuan të dy për kulturën arbëreshe, e ndë fund pse ishin kurshërinj. Këta dy ativistë për kulturën arbëreshe, megjithëse gjëllitin një ndë Kalabrje e jetri ndë Merik, mbetin ngaherë ndë kontat me letra ku thojin jo vetëm si rrijin e që bëjin, po edhe që penxojin për kulturën e arbëreshëve, si mund të zviluparej kjo kulturë e që mund bëjin ata dy për katundet arbëreshë.

Aristi i shkruaj Domillit: “Kuxhi, shih se u jam e shkruanj dica poezi arbërisht: dica më dalin me një armoni speciale, janë të ëmbëla si mjali, e më ngasin zëmrën e më shkundin kurmin; këto poezi më shkundin jo vetëm kurmin po të tërë shpirtin e më ndërrojin jetën. E di se kur vitin që shkoi erdha më parë Romë e pra Shën Benedhit, - kur u pamë e shkuam ato ditë të bukura si ndë një ëndërr,- u kishnja shkruajtur tre poezi, që më kishin dalur nga zëmra të vetma. Qenë ato poezi që më shtunë sa të nisëshnja të vinja te katundi im, që nga ditë më këndoj një këngë pjotë me mall. Qenë poezitë që më tundtin e bën e u nisa.

Kuxhi, e kapin nani që fuqi kanë fjalët e poezive? Po më shumë se fjalët, sa fuqi ka vjenmethënia e fjalëve? E mban mend atë që thotë Vangjeli? ‘Ndë nismen ish fjala e Fjala ish Ynë Zoti, e Fjala ish ndanë t’Ynë Zotit’”.

Domilli ju përgjegj me një liter ture i shkruajtur: “U e di se ti që kur ishnje këtu, djalë i vogël, thonje ca fjalë që mua më ngitin zëmrën. Ca herë më dukej se nga fjalë që thonje ish si një këngë.

Kuxhi, bëj mirë e shkruaj, kur ndien atë fuqi mbrënda që të merr shpirtin, shkruaj se ato janë fjalë që qëndrojin, janë fjalë për jetën që nëng shuhet. I mban mend ato fjalë që më thonje ture kënduar? Më dukej se ishin fjalë që ti kishnje mbësuar nga tradiciuna e vjetër, më dukej se ishin këngë popollarë, përkundra ishin fjalë që të dilin tij nga shpirti. Gjegj një cik, se edhe i mbanj mend pse më këndojin ato vetë mbrënda shpirtit tim. Gjegj, gjegj,

Italo Costante Fortino

Instituti Orientale i Napolit, ka Shën Bendhiti (Cs)

ARISTIDE MANES E DON EMILIO TAVOLARO -

Sono due personaggi di San Benedetto Ullano. Aristide morì nel 1974 a Santiago del Cile, dove lavorava in una Banca, e don Emilio morì a San Benedetto nel 1984, dove lavorò come professore nelle scuole elemnetari.

Perché in questo articolo li mettiamo insieme questi due intellettuali? Perché quest’anno ricorrono, per il primo, Aristide, 40 anni, e per il secondo, don Emilio, 30 anni da quando sono morti; poi perché, ambedue da San Benedetto, si sono interessati entrambi di cultura arbëreshe; e infine perché erano cugini. Questi due attivisti della cultura arbëreshe, anche se vissero uno in Calabria e l’altro in America, restarono sempre in contatto con lettere, dove dicevano non solo come stavano e cosa facevano, ma anche cosa pensavano della cultura degli Arbëreshë, come poteva svilupparsi questa cultura e cosa potevano fare loro due per i paesi arbëreshë.

Aristide scriveva a don Emilio: “*Cugino, vedi che io sto scrivendo delle poesie in arbresh: alcune mi escono con una melodia speciale, sono dolci come il miele, e mi toccano il cuore e mi scuotono il corpo; queste poesie mi scuotono non solo il corpo ma tutta l’anima e mi cambiano la vita. Lo sai che quando l’anno scorso venni prima a Roma e poi a San Benedetto - quando ci vedemmo e trascorremmo quelle belle giornate come in un sogno - io avevo scritto tre poesie, che mi erano uscite dal cuore da sole. Furono quelle poesie che mi spinsero a partire e venire al mio paese, che ogni giorno mi cantò un canto pieno d’amore. Furono le poesie che mi scossero e mi fecero partire.*

Cugino, lo capisci adesso che forza hanno le parole delle poesie? Ma più delle parole, quanta forza ha il significato delle parole? Lo ricordi quello che dice il Vangelo? In principio era la parola e la Parola era Dio, e la Parola era presso Dio”.

Don Emilio gli rispose con una lettera, scrivendogli: *Io lo so che tu, da quando eri qui, piccolo ragazzo, dicevi delle parole che a me toccavano il cuore. A volte mi sembrava che ogni parola che dicevi era un canto.*

Cugino, fai bene a scrivere, quando senti quella forza interiore che che ti afferra lo spirito; scrivi, perché quelle sono parole che rimangono, sono parole per la vita che non si spegne. Le ricordi quelle parole che mi dicevicantando? Mi sembra che fossero parole che tu avevi imparato dalla tradizione antica; mi sembrava che fossero canti popolari, invece erano parole che ti

Aristi Manes e Domill Tavullari

sa të bukura janë këto vjersha që shkruajta kur ishnje i ri e m'i kendonje me mall e me fuqi:

Zojushe që hjeron si një namustaqe,
sit ke të kaltra e buzët keq të kuqe,
ngjiret të trondofiles ke ndë faqe,
e-hjeshme je më ti se një bumbuqe!

E sheh, Ari, se edhe ndëç kishnje shkruajtur vetëm këto katër vjersha ti qëndron në storjen e kulturës e leteraturës arbëreshe, përkundra u që nëng di e shkruan poezi, jam si një njeri që kur fjet i duket se fjalët bien në një graminë”.

Kur Aristi mori literën e të kushiririt, gjithë i pjetë me mall zu të qaj për emocionën, për atë muzikë që kishin ato vjersha që i mbajti mend Domilli. Po më shumë qajti, gjithë ditën, për atë vashëz që ai kish lënë në katund kur u nis për Merikën. Po qajti gjithë ditën, e ditën pas edhe më shumë, pse kish ditur se ajo vashëz, e bukur si një namustaqe, kish dekur me një sëmundje të keqe.

Aristi, kur u qetësua pra ju duk se Domilli kish shkruajtur edhe gjë që nëng ish e drejtë në fund të literës e ju përgjegj kështu:

“Kuxhi, ti e thua mirë se poezia nëng humbet e se qëndron për jetët e jetëve, po mos shtir poshtë atë që bën ti që nëng u leve poet, pse jo gjithë mund të jemë poetë. Ti, kuxhi, je e mbësos fëmijët e je e i mbësos jo vetëm kulturën italiane, po u di se ti i mbësos atyre edhe storjen e arbëreshëve, i fjet për atë që na nga Shën Benedhiti thërresim Bek, vjenmethënë Skanderbek; i rrëfien se njera kur Beku qe i gjallë Turkët nëng arvuan të okuparin Arbërinë, po kur ai diqi i biri i tij, Gjoni erdhi në Pulje e me të erdhtin shumë arbëreshë. Pra ture i rrefiejtur storjen i spiegan pse Shën Benedhit gjendet edhe sod Shpia e Kollexhit, e që bëri ky Kollexh, që funxiunë pati. U di edhe se ti i fjet studentëve për Venxhezlòm, Milanin, pse e vran Anapul në vitin 1856 e se sa kuraxh pati ai sa t'i bëj një atendat Rregjit. I rrefien edhe atë që bëri Dhumink Mauri, Janar Pllaku, Thanas Dramisi, Xhirolam De Rada, Vinçenx Dorsa për Risorxhimentin italian. Kuxhi, u ka t'e buthtonj gjithë të vërtetën nani. Nëng e di si vate e si qe, u gjeta në mest libravet time, që më dërguan nga katundi dica vjet prapa, një kuadern që shkruajta ti me pendë, e kam edhe sod këtu mbi triesë. Është një kuadern që për mua ka shumë vlerë. Atje ti, kuxhi, ti

uscivano dall'anima. Ascolta un po', ch  ancora le ricordo, che mi cantano ese stesse dentro l'anima mia. Ascolta, ascolta quanto sono belle questi versi che hai scritto da giovane e meli cantavi con amore e con forza:

*Ragazza che profumi di violetta,
gli occhi ha azzurri e labbra troppo rosse,
i colori della rosa hai sul volto
sei pi  bella tu di un bocciuolo!*

Lo vedi, Ari, che se anche avessi scritto solo questi quattro versi tu resti nella storia della cultura e della letteratura arb reshe; mentre io, che non so scrivere poesie, sono come una persona che quando parla sembra che le parole cadano in un burrone”.

Quando Aristide ricevette la lettera dal cugino, tutto pieno d'amore cominci  a piangere per l'emozione, per quella musica che avevano quei versi che gli aveva ricordato don Emilio. Ma pianse maggiormanet tutto il giorno, per quella ragazza che lui aveva lasciato quando parti per l'America. Ma pianse tutto il giorno, e di pi  anche il giorno successivo, perch  aveva saputo che quella ragazza, bella come una violetta, era morta per una grave malattia.

Aristide, quando poi si calm , gli sembr  che don Emilio avesse anche scritto qualcosa che non era vera, in fondo alla lettera, e gli rispose cos :

“Cugino, tu dici bene che la poesia non scompare ma rimane per sempre, ma non sottovalutare quello che fai tu che non sei nato poeta, perch  non tutti possiamo essere poeti. Tu, cugino, stai ammaestrando i bambini e stai loro insegnando non solo la cultura italiana, ma io so che tu insegni loro anche la storia degli arb resh , gli parli di colui che noi a San Benedetto chiamiamo Bek, cio  Skanderbek; gli ricordi che fino a quando Beku fu vivo, i Turchi non arrivarono ad occupare l'Albania, ma, quando lui mor , suo figlio Giovanni venne in Puglia e con lui tanti arb resh . Poi, raccontandogli la storia, gli spieghi perch  a San Benedetto si trova ancora oggi la Casa del Collegio, e cosa fece questo Collegio, che funzione ebbe. Io so che tu parli agli studenti di Agesilao Milanom perch  l'hanno ucciso a Napoli nel 1856 e quanto coraggio ha avuto nel fare un attentato al re. Gli racconti anche cosa ha fatto Domeinico Mauri, Gennaro Placco, Atanasio Dramis, Girolamo De Rada, Vincenzo Dorsa per il Risorgimento Italiano. Cugino, io devo mostrarla tutta la verit  adesso. Non so com'  andata e come fu, io ho trovato in mezzo ai miei libri, che mi mandarono dal paese alcuni anni fa, un quaderno che hai scritto tu a penna, ce l'ho ancora oggi qui sul tavolo. E' un

Aristi Manes e Domill Tavullari

shkruajte gjithë storjen e arbëreshëvet, që kur erdhtin ndë Talje e njera sod, shkruajte për leteraturën arbëreshe, për gjuhën arbëreshe. U atje mbësosa kush është Variboba, Keta, Filja, Brankati, De Rada, Santori, Serembe, Skiroi, Billota, e sa e sa më skritorë që nderuan jetën tonë arbëreshe e italiane. Kuxhi, mos thuaj më se fjalët tënde bien ndë një graminë, pse u ndë mest atyre librave që të thash gjeta edhe këta libra që shkruajte ti. Gjegj, gjegj sa shurbise shkruajte e që nëng ranë ndë një graminë. Ti jie i biri i Zotit, i priftit Don Napuliuinit, që qe parrok te katundi jonë më parë se Don Xhuzepi Alesandrini, e njeh mirë edhe storjen e ritit tonë, njeh mirë edhe storjen e Shën Mërisë së Bokonxhijit. Nani ki paçenxë se të mbanj mend atë që shkruajte e mos më thuaj se të nojarin. Ki paçenxë. Ti shkruajte gjithë këta libra që këtu të shëngonj:

1) *Notizie storiche sulla Chiesa del Buon Consiglio in S. Benedetto Ullano* (1948); 2) *S. Benedetto Ullano e gli Albanesi d'Italia* (1952); 3) *Il contributo degli italo-albanesi al Risorgimento* (1961); 4) *Origini e sviluppo delle comunità albanesi di Calabria* (1963); 5) *Vicende storiche e giudiziarie del 'Collegio Corsini' in S. Benedetto Ullano* (1966); 6) *Il contributo dei Rodotà de' Coronei alla storia e alla cultura nazionale albanese* (1965); 7) *Lembi di Albania in Calabria: esempio di difesa e di valorizzazione delle tradizioni etno-storiche linguistiche* (1967); 8) *Gli albanesi d'Italia* (1967); 9) *Skanderbeg nella storia, nella tradizione e nell'arte* (1968); 10) *Panorama storico della realtà albanese in Calabria* (1973).

Kuxhi, nani që djovase këta tituj, bin'e të priren ndë tru gjithë shurbiset që bëre e që shkruajte për Arbëreshët e sheh se edhe ti shkruajte fjalë që qëndrojnë ndë jetën e jetëvet. Amin.

Domilli këtë herë, ndë zëmrën e tij, i dha të drejtë. Pra Domilli kur u bë pjak vej ture rrëfier se gjithë shurbiset që bëjnë arbëreshët për dheun e për kulturën e tyre qëndrojnë për jetën e jetëve.

E ture i dhënë trimave këtë mesaxh i vijin ndë tru fjalët e një poezie që Arist Manesi kish shkruajtur kur bëj suldatin mbi malet e Alpeve Karnike ndë vitin 1917. Kjo poezi, e pjetë me mall për katundin, Shën Benedhitin, thotë kështu:

Sa llargu jami...
Sa llargu jam nga Katundi im,
Katund i-vogël që më vjen ndë gjum,
Tek leva u rrita e kam mallin e-tim,
mallin të bukur që më vret më shumë!

Det ishnja një ndallanishe o nj'rreshinjuall,
o një pëllumb i-bardh o nj'korv i-zi,
sat fjeturonja shepit tek ai truall

quaderno che per me ha molto valore.. Lì tu, cugino mio, hai scritto tutta la storia degli Arbëreshë, Da quando sono venuti in Italia e fino ad oggi; hai scritto sulla letteratura arbëreshe, sulla lingua a rbëreshe. Io lì ho imparato chi è Variboba, Chetta, Figlia, Brancati, De Rada, Santori, Serembe, Schirò, Bilotta, e tanti altri scrittori che hanno onorato la nostra vita arbëreshe e italiana. Cugino, non dire più che le tue parole cadono in un burrone, perchè io, in mezzo a quei libri che ti ho detto, ho trovato anche questi libri che tu hai scritto. Ascolta, ascolta quante cose hai scritto e non sono cadute in un burrone. Tu sei figlio sacerdote, di don Napoleone, che fu parroco del paese nostro prima di papas Giuseppe Alessandrini, e conosci bene anche la storia del rito nostro; conosci bene anche la storia della Madonna del Buon Consiglio. Adesso abbi pazienza che ti ricordo quello che hai scritto., e non mi dire che ti annoio. Abbi pazienza. Tu hai scritto tutti questi libri:

Cugino, adesso che hai letto questi titoli, fatti tornare in mente tutte le cose che hai fatto e che hai scritto per gli Arbëreshë e vedi che anche tu hai scritto parole che restano nei secoli dei secoli. Amin.

Don Emilio questa volta, in cuo suo, gli dette ragione. Poi don Emilio, quando si fece vecchio, andava raccontando che tutte le cose che ghe fanno gli Arbëreshë per il loro mondo e per la loro cultura, restano per sempre.

E mentre dava questo messaggio ai giovani, gli venivano in mente le parole di una poesia che Aristide Manes aveva scritto quando faceva il soldato sui monti delle Alpi Carniche nel 1917. Questa poesia, piena di nostalgia per il paese, San Benedetto, dice così:

Quanto sono lontano...
Quanto sono lontano dal mio Paese,
Paese piccolo che mi viene in sogno,
dove nacqui, crebbi e ho il mio amore,
l'amore bello che mi uccide di più!

Vorrei essere una rondine o un usignolo
o una bianca colomba o un corvo nero,
per volarmene presto in quel suolo

Aristi Manes e Domill Tavullari

tek vasha ime me tiert shoke rri.

E i shpendallisnja rreth ture kënduar,
e i venja ndan t'i thonja një fjal ndë vesh,
e ndë të m'mirrij bëj vasha me duar
u iknja llargu take shtur një vjersh!

Jan ëndrra, mbraztari jan këta fjal...
Jan fjeta vjeshti që nisën një lum...
Katundi është llargu, u rri mbi një mal,
pres natën vashën të më vinj ndë gjum!

dalla mia ragazza, che con le altre compagne sta.

E le volerei intorno cantando,
e le andrei vicino per dirle una parola all'orecchio,
e se la ragazza tentasse di afferrarmi con le mani
io me ne andrei lontano intonando un vjersh!

Sono sogni, vanità sono queste parole...
Sono foglie d'autunno che trasporta un fiume...
Il Paese è lontano, io sto su un monte,
aspetto la notte la ragazza che mi venga in sogno!

Purçilli, njatër vjershtar na la

Xhuanini Kaçafritullit (Giovanni Pace), ka Purçilli, poet popullor, arbresh i kulluar, mik i ngusht i ksaj rivistje, gjithnjëherje na la: ndë fjavat. Vet di poezi pata nderen t'i publikarja mbi Jetën Arbëreshe, sepse qellej me turp, thoj se s'dij t'shkrunej arbrisht. U e shtijta të shkrunej, si dij e si mundnej. E ai shkrujti. Gjuha arbreshe i kish hijtur mb'zëmer, aq sa afër shtratit tij, mbi kollonët, mbanej librin e 'Gramatikes Arbreshe' të zotitlal, Emanuele Giordano. E këtë libër të bilt i vunë te tavuti. Këtu do t'e mbami mendë me një poezi (Senaturit Vasil Giordano) që i publikarta tek numri 61/2009. Jetren poezi, (U leva pjot turpëri) kish par driten te nr.55/2007, ku rrfienez si përpoqi e njohu të shoqen, Filluçen. E cila, e smur ka shumë, vdiq pak jav pas të shoqit. Të ktij poeti popullor ndonjeter poesi ka qindruar e pabotuar; e tek jetri numar patjetet më gjë e botomi. Ture zënë, pse jo, ka ajo që i bëri së shoqes. Të bilvet i thom të kirkohen mir ndër kartat e t'jatis, ndëse gjetshin më gjë shkrime t'tija. Ëmri i tij mos u harroftë! (D.)

Senaturit Vasil Giordano

Shumë t'urtë Arbëreshë dhá ki katund dhe u të shkruanj arbërisht një mall të kam: ata e nderuan po aq sa e di tërë jeta e u së jam i rremë, se është vërteta. Mua zëmren me hare m'e mbjon pjot se u, si ata, u leva purçilot: ka mot ç'emrin ja ndërroi në Ejaninë ai zoti i motit shkua dhën Pjerin. Ndër njerzit që katundin kanë nderuar ë fëmila e Xhordanvet lavdëruar: i sprasmi bir më i ndier është Vasili që bëri e bën dritë po më se illi: Senatúr e zgjotthin ata Itall-Merikán, e sot është ulet ndë Parlamend Talljan. Ju thom që nderë ai mua më dha e zëmren me hare ai pjot m'e la. Ish ndir njëzetekater t'muajit shëndrë kur vajt'e mora posten u njenjë: busten m'e hapa e timbri ish rroman: urimet e Natallvet të Vasilit Xhordan! Ki kùndith më la mua shumë të gëzuar sa thash: këtë t'mirë u kam e lë të shkruar. Nderove ngjezet tët at e mëmzen me hare, që tij birith pjot urtësi të vunë mbi dhe:

Xhuanini Kaçafritullit

(1924-2014), vjershtar ka Purçilli (Cs)

pir nënd muaj i mbshove mall ndë barkut asaj hajdhjare Anitës Zabeles Markut. Njëng thom pir atë vlla bular pjot urtësi, që kur këndon mbë qishë të siell ngullí; njëng thom pir motrat që kanë mall pazallë se kanë ndi shpi një Senatur kshtu t'rallë: një vlla që s'gjëndet, hajdhjar e me urtësi, që gjithve, frasnjot e purçilot, bën simbatí. Këtë nderë mbànie shtrënjtë ju që m'e kini, se nipa jini të zot Manolit e t'lal Gustinit. Vasili Buzdhelprit nderon Tallje e Arbëri: Merka e Kanadhàu m'i bëjen hajdhí.

(28-12-2008)



Magarat

(1894)

(transkriptoi) Agostino Giordano

ka Purçilli (Cs)

“Magarat” (“Fattucchiere” lëtisht, “Shortare” në shqip) është titulli i një “rrëfimi” poetik të pabotuar të

B. Bilotës, që mbaroi s’shkruari ndër 25-5-1894. Fleta katerfaqesh me vija, të mbledhura bashkë me një shpinë, ka stërnipi zoti Emanuele Giordano. Dorëshkrimi është i math 13,5 cm.x 20,7 cm., numëron 40 faqe. Rrëfimi është i ndajtur në nëndë pjesa. E para pjesë, që botomi këtu poshtë, përmban 68 vjershe/vargje njëmbëdhjetërrokësh; distikë me rimë të puthur, njëri pas jetrit. Të nënda pjesat, përgjithësisht, numërojnë 919 vjershe/vargje. Bilota s’i numëron faqet e fletëve, as vargjet e poezisë. (Këtu këtë shihet ndonj numër vjershë i shtuar me laps ka stërnipi, o ndonj fjalë e singuar, ka stërnipi) Tekstin Bilota s’e pruar lëtisht, si t’ijera herë, e teksti s’ka shumë korrigjime: dmth. është një kopje e pastër. Te ky Rrëfim Bilota folen mbi “magarat”, gra që bëjnë magji, që nd’at mot gjëndshin edhe Frasnitë e Purçill. Atyreve i drejtohet ato gra që kishen probleme me t’shoqrat ç’i bëjnë britë, o ato kopile që dishrojnë t’martojnë një trim që s’i donej, o doj t’i bëjnë dëm të tjerëve për zili.

1. Qelbet Frasnita edhë, se vën përpara
grā t’egra, që kallzohen t’jën magara.
Ka grāt e ka kopilet jān lēmuer,
ka burrat e ka trimat tē jēn ruer.
Me prēhrin e me trasten xheshjen shpīn
magaravet tue qellur kurtizīn. 6
I duen mīr sa ndē prindt e tire dojen
ashtu, ndē shpīt tire po sa e gzojen.
Me to mbajen fort e shprishjen līr
pēr to fjalat e mira se i duen mīr.
Kēshtu magarat po ngadit mīr hān
ndomos se sē shurbejen e gjē s’kān. 12
Kūr vete e i gjēn ndonj grua o ndonj kopile,
se t’lidhenj kē duen, me at vandile
tē pjot kan vēn se ato duen mīr tē hān:
kēshtu me to mund fjasen e dēr kān.
“Mirsevini”, t’i thōn sa nēnga i shohen
me prēhrin e me trasten pjot: i vēhen 18
rrēz e “Ndrikull - i thōn - ti si mē rrī?
“Dōj t’vija tē tē gjēja dhjā ndē shpī,
“se dī se ti do ndihur si ka u,
“Fol dreq se u mē jam pēr tīj kētu”.
Ndrikulla thot magares:”Za kēt trast. 24
“Ē pak që ni tē solla e prime mbrast.
“Tutjē pra vinj mē mīr e t’rriçidhonj,
“se t’miret, që t’mē bēç, u s’tē harronj”.
Magara pra që trasten me harē
tē mbrazen, si ka ndrikulla njenjē
tē priret e t’i ulet mbān e e pien
ēmbliht si jatresh: “Thuej si kā krien 30
“me tīj it shoq: tē do mīr si t’i nget
“o pak tē ruen e eger dhe tīj fjet?”.
“U pēr kēt erdha, ndrikull: kē t’m’e shroç
“si dua u: kēt ‘ mīr ti kē t’mē bēç.
- “Ai mbjidhet me një dos e shpīn mē xheshen:
“grūr e val s’mē lē: sā mē pērqeshen”. 36
“U dī që do tē bēn, i thot magara:
“Dī kush e shkatarrōj. Pa mē përpara
“se tē taksenj u tē t’e shēronj,
“me shoqezit kam fjas, tē dī ç’kam bēnj.
“Na gjith si jemi gjē māj vet mund bēmi;
“se t’bēmi gjē, gjith fjal e duer kem vēmi. 42
“Kam pienj edhe që duen se tē vēn duer,
“it shoq ka kjo sēmūd tē jēt shēruer.
“Tē shtunen që tē vīnj u dī e tē rrfienj
“çē thōn, se t’prēmten mbjedhur gjith i pienj.
“Ndrammendi dhjet kuleçe tē mbdhenj ti bēn
Pē tē ēnjten e m’i sīll pra që perndon, 48
se t’ja shprishenj shoqezvet e mia
kūr mbjidhemi tē fjasmi te shoqria.
Me kēta i butsonj e bē, t’mē thōn
pēr burrin tēnd, ç’kā t’zgjidhet, ç’është me bēn”.
“Ēh, ndrikull, se t’i siell pēr kūr mē thē;
po shi ti çē kē t’bēç ka balta ç’rē 54
si tē mē shkunjesh: pra që mē tē dueç
tē jap e s’tē prier kraht me një mērrueç”.
“Poka që ti kto trū tē mira kē,
mbāj ndē kushallet se kutjend bēn jē”.
“Shih, ndrikull, se kēt thik u s’und duronj
Hartuesit e mëdhenj të gramatikave zgjedhin shembuj për ushtrimet nga autorë që kanë kontribuar në shekuj me veprat e tyre. Kushdo që i shfleton apo zhvillon mësim të rregullt nxjerr përfundimet se gjuha zhvillohet nëpërmjet ligjërimit të shkruar apo gojor. Vazhdon t'i shtojë përfundimet se gjuha e sotme shqipe ka ndryshuar në krahasim me gjuhën e Mesharit të Buzukut, të atyre shqiptarëve që përmend Brocardi më 1332 apo dhe më herët, tek shkrimet e kanuneve të principatave të Arbrit. Nuk ka dyshim se zhvillimi që ka pësuar shqipja është rrjedhim i veprimtarisë ligjërimore të milionave folësve gjatë shumë brezave.

Zhvillimi i jetës shoqërore dhe ekonomike ka shtuar pa ndërprerë para tyre nevojën e krijimit të njësive të reja për të emërtuar dukuritë dhe sendet e reja, të formave gramatikore për këtë emërtim, të skemave të përshtatshme të fjalive e të periudhave, ku hyjnë këto emërtime të reja së bashku me formën gramatikore, ndërtimin e marrëdhënieve të reja në këto njësi më të mëdha. Nën shtysën e këtyre kërkesave kanë lindur njësi dhe mjete të reja që janë shtuar në thesarin e përgjithshëm të gjuhës shqipe, e cila paraqitet në skemën e mëposhtme :



Skema e mësipërme e paraqet qartë rolin e shumës së folësve individë $(I_1+I_2+I_3..+I_n)$ i cili është vendimtar në zhvillimin e gjuhës, çfarë zotëron në magazinën e tij folësi i ri dhe çfarë trashëgon.

Ndër individë të veçantë që mund të lënë gjurmë të dukshme në zhvillimin e gjuhës janë në radhë të parë lëvruarit e gjuhës. Fjalët e krijuara në fillim janë fakte të ligjërimit. Po kur tërësia e folësve i përvetëson ato kthehen në fakte të ligjërimit, në fakte të gjuhës, d.m.th, hyjnë në gjuhë, në segmentin e shkruar (SSH) apo gojor (SG).

Mendimi përbashkues ka sjellë pas shumë shekuj rrjedhojën se Arbërishtja dhe ngulimet e diasporës kanë qenë dhe vijojnë të jenë edhe një gjuhë kulture e folur, por edhe e shkruar. Rruga shekullore është përshkruar shumë qartë nga prof. Agostino Giordano: "Të mbrujtura me vjershe e me lot, me djersë e me erë. Moti këto fjalë i ngurti, e i stisi një e një rreth zëmrvat arbëreshe. Kështjella më të larta se Kruja." ¹

Shkrimtarët arbëreshë, kush më shumë e kush më pak, kanë njohur edhe gjuhën shqipe të këtej Adriatikut dhe kanë pasqyruar prej saj jo vetëm fjalë, por edhe trajta të strukturuar gramatikore.

Zef Skiroi e zbuti shumë arbërishten duke iu afruar gjuhës së atdheut, kurse Zef Serembja mblodhi dhe futi në veprat e veta fjalë prej viseve të ndryshme shqiptare.

Në ditët tona shumë nga studiuesit arbëreshë jo vetëm që e njohin shqipen letrare, por edhe e përdorin atë gjerësisht në shkrimet e veta. Një numër i madh shkrimtarësh, mësuesish dhe veprimtarë arbëreshë njohin zotërojnë dhe sipas rastit me shkrim edhe gjuhën letrare.

Këto përpjekje janë shoqëruar me argumentet e gjuhëtarit F. Solano i cili ngrihet kundër opinionit tashmë të vjetruar që shihte në të folmet arbëreshe "një gjuhë të vjetër", të folmet që kanë pasur një evolucion paralel me atë të mëmëdheut të origjinës. Dhe forma arkaike gjenden njësoj edhe në të folme të mëmëdheut, qoftë në Veri, qoftë në Jug." ²

Po ky gjuhëtar ndalet tek inventari i plotë i të folmeve arbëreshe.

E folmja arbërisht pas Kongreseve Gjuhësore

Të folmet arbëreshe kanë 6 fonema zanore: /i/, /u/, /e/, /ë/, /o/, /a/. Në të gjitha të folmet mungon fonema /y/. Fonemat bashkëtingëllore të të folmeve arbëreshe janë: këto:

/p/, /b/, /t/, /d/, /k/, /g/, /q/, /ç/, /xh/, /c/, /xh/, /x/, /f/, /v/, /th/, /dh/, /h/, /g/, /j/, /sh/, /zh/, /s/, /z/, /m/, /n/, /ll/, /lj/, /r/, /rr/, /nj/, /ng/, /d/.

Pësojnë ndryshime fonemat e mëposhtme: /h/, /j/, /f/, /s/, /ll/, /lj/, /l/, /r/, /nj/.

Ruhen dukuri më të vjetra të grupeve: /kl/, /gl/ dhe kalimi i këtyre grupeve në bashkëtingëllore të thjeshta /q/, /gj/ ³

Zgjidhja gjuhësore përbashkuese e njohur tashmë nga Sami Frashëri dhe Jeronim De Rada theksohej edhe në kongreset gjuhësore të organizuar.

Kongresi i parë i organizuar me nismën e Jeronin De Radës u mbajt më 1 tetor 1895 në Corigliano Calabro. Në të u mbledh shumica e intelektualëve arbëreshë që përfaqësonin thuajse të gjitha komunitetet arbëreshe të Kalabrisë. Pika e parë e rendit të ditës që u diskutua gjatë në kongres kishte të bënte me nevojën e forcimit të marrëdhënieve kulturore me atdheun mëmë, së dyti iu kërkua qeverisë italiane të hapet katedra e gjuhës dhe letërsisë shqipe pranë Institutit Oriental të Napolit, ku të studionin arbëreshë dhe shqiptarë.

Nisur nga nevoja që kishte arbërishtja për studime të thelluara, kongresistët hartuan një program. U vendos të përdorej gramatika që kishte shkruar Jeronim De Rada, u caktua një komision me detyrën të hartonte një fjalor të shqipes; së fundi, duke u paraprirë vendimeve të Kongresit të Manastirit të vitit 1908, u vendos për shkrimin e shqipes të përdorej një alfabet i vetëm. Tentativa e parë mbarëshqiptare për një bashkim kulturor.

Kongresi i dytë u mbajt më 20 shkurt 1987 në Ungër/Lungro. Ky kongres ishte vijim i të parit, vendimet që u morën ishin një përshtatje e vendimeve të Kongresit të parë. Përgëzoi Skiroin për propozimet me vlerë që kishte bërë për plotësimin e alfabetit “të përbashkët.” ⁴

Rreth 100 vjet pas këtyre Kongreseve dhe Kongresit të Manastirit, më 1972 nga gjuha mëmë erdhi një zgjidhje përbashkuese e studiuar shumë mirë shkencërisht. Në këtë kongres midis të tjerave u nënvizua se sistemi fonetik i shqipes së sotme letrare i cili i është nënshtruar një bashkëveprimi të gjerë ndërdialektor, në ndërtimin dhe kristalizimin përfundimtar të tij udhëhiqet nga parimi themelor që struktura fonetike të mos errësojë, por të ndihmojë për të ruajtur sa më të qartë strukturën morfologjike fjalëformuese e semantike të fjalës.

Prija për ruajtjen e plotë të strukturës tërësore të fjalës e ka zgjeruar e fuqizuar mjaft edhe ndikimin e parimit morfologjik të drejtshkrimit të shqipes së sotme mbi parimin fonetik e mbi drejtshqiptimin.

Baza fonetike e shqipes letrare kombëtare, përveç elementeve të përbashkëta, janë gërshetuar elemente e veçori të dy dialekteve. ⁵

Edhe pas këtyre kongreseve gjuhësore vijoi rruga e përbashkimit të të folmeve arbëreshe. Një nga alternativat vijon sipas drejtorit të “Jetës Arbëreshe”: ”Të folmave arbëreshe - mëse gjithë atyreve më të shkatërruara nga moti - mund t’i ndihjën vetëm të folmet motra arbëreshe. Vetëm kjo është udha për me shpëtuar të folmet arbëreshe nga shkatërrimi i motit...Një ndihmë që mbetet mbrenda shpisë arbëreshe. Nga gjuha “mëmë” shqiptare kem të marrim hua vetëm ato fjalë që i mungojnë të folmeve arbëreshe”.⁶

Alternativa tjetër është sipas gramatikës “Udha e mbarë” të hartuar nga Komiteti shkencor: Françesko Altimari, Matteo Mandala, Antonino Di Sparti, Leonardo M. Savoia.

Ndërtimi i gramatikës me shembuj që shoqërojnë ushtrimet kanë si qëllim përbashkësinë e të folmeve motra të arbërishtes. Pra, shembujt e sjellë janë nga një shekull më parë e më herët duke ardhur deri në ditët tona; Giuseppe Schirò, Paolo Schirò, Nikolò Figlia, Françesko Crispi Glaviano.

Po këtu përfshihen edhe autorë më të hershëm që u përkasin viteve 1700 -1800, 1900: Nicolo Brancato, Nicolo Chetta, Pietro Chiara. Vetë autorët nënvizojnë në këtë gramatikë: ”Kush mëson mënd të ketë dy mënyra kryesore të vunj sa më mirë mësimet”. Theksohen dy mënyrat për të vënë në dorë tekstin pas çdo mësimi “O si ndëlgon më mirë.”

Tekstet dhe shënimet u shkruan sipas të folurit arbërisht. Terminologjia tipike e gramatikës është ajo shqipe.

E folmja arbërisht pas Kongreseve Gjuhësore

Për shembull:” emra” në vend të “emre” arbërisht; “cilësor” në vend të “çilësor”; ”numra’ në vend të “numre”, etj.

Disa forma të shqipes së sotme ndodhen ndër kllapa pranë formave arbëreshe.⁷

Alternativat, e shkruara më lart përbashkohen në faqet e fundit të gramatikës “Udha e mbarë:” “Të folurit ndërron një thërrime nga ata të Horës, ma kur flasjëm ndëllgonemi. Për shembull ata fjalën “lule” e thonë “Ijulje”, ma kush ngë e ndëllgon? Bukur ë të jecësh brenda Siçilljes e të gjesht gjindje çë flasjën arbërisht...Rreth Horës sot ndodhen shpi të reja, gjithë gjithë ato të stisura pas dhetundjes ⁸ (shqip tërmet) të vitit 1968”.

Të folmet arbërishte me moton “O si ndëllgon më mirë” shkojnë drejt alternativave të përcaktuara tashmë shkencërisht nga gjuhëtarët.

Botimet si: Jeta Arbëreshe, botimet e universiteteve e sidomos ato të katedrës së Universitetit të Kalabrisë, Gramatikë e De Radës, Udha e mbarë janë model për të folurin arbërisht, si popullsi shkollore dhe çdo folës tjetër arbëresh.

LA PARLATA ARBËRESHE DOPO I CONGRESSI LINGUISTICI - L'autore ha trattato il linguaggio arbëresh, la comunicazione, e quale si presenta chiaramente come il ruolo del totale dei parlanti individui (I1+I2+I3...+In) sia anche determinante nello sviluppo della lingua. Riflette che cosa possiede nel suo magazzino il parlante giovane, la competenza linguistica nella memoria a lungo termine e che cosa tramanda, per realizzare il linguaggio nella vita quotidiana e a scuola.

Si mette in evidenza il ruolo di individui particolari, che possono lasciare tracce visibili nello sviluppo della lingua. Questi sono, in primo luogo, i cultori della lingua. Le parole create all'inizio sono fatti del discorso. Ma quando la totalità dei parlanti le assimila esse ritornano in fatti del discorso, fatti della lingua, cioè entrano nella lingua, nel segmento scritto (SSH) o orale (SG). Si sottolinea il lavoro realizzato dai linguisti, scrittori, altri parlanti sulla strada dell'unione delle parlate arbëreshe dopo i Congressi Linguistici realizzati da Girolamo De Rada e i congressi linguistici in madrepatria. Nello scritto trovano spazio le alternative secondo il direttore di “Jeta Arbëreshe” e secondo la grammatica “Udha e mbarë” elaborata da un comitato scientifico (F.Altimari, M.Mandalà, A.Di Sparti, L.M.Savoia).

Shënime:

- 1) Giordano, Agostino, Arbërishtja dhe shqipja, në Jeta Arbëreshe, Purçill/Ejanina (Cs-Italia), 2009, nr.63, f.3.
- 2) Cituar sipas Gj.Shkurtaj. Sociolinguistika.Tiranë, 2009, f.313.3)
- 3) Shih më gjerë F.Solano.I dialetti dell'Italia Meridionale,I,Appunti per una classificazione ,Quaderni di Zjarri, 1979.
- 4) Mandalà,M. Studime filologjike për letërsinë arbereshe. Tiranë, 2012,f.306.
- 5) Kostallari,A. Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë në Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I . Tiranë 1972,f.37.
- 6) Giordano,Agostino, Jeta Arbëreshe. nr.63,2009,f.3.
- 7) Giuseppe Schirò Di Maggio, Udha e mbarë, Romë, 2001,f.9
- 8) Giuseppe Schirò Di Maggio,Udha e mbarë, Romë, 2001,f.398.

DITET E JAVES - MUAJT E VITIT - NUMRAT

DITËT E JAVËS	maj - maggio	5 - pesë	40 - dyzet (katërdhjetë)
e hënë - lunedì	theristi - giugno	6 - gjashtë	41 - dyzet e një, ecc...
e martë - martedì	llonar - luglio	7 - shtatë	50 - pesëdhjetë
e mërkurë - mercoledì	gusht - agosto	8 - tetë	51 - pesëdhjetë e një, ecc...
e enjte - giovedì	vjesht - settembre	9 - nëndë	60 - gjashtëdhjetë
e prëmtë - venerdì	shënmitër - ottobre	10 - dhjetë	61 - gjashtëdhjetë e një, ecc...
e shtunë - sabato	shënmartir - novembre	11 - njëmbëdhjetë	70 - shtatëdhjetë
e diell - domenica	shëndre - dicembre	12 - dymbëdhjetë	71 - shtatëdhjetë e një, ecc...
MUAJT E VITIT	NUMRAT (njëra njëqind)	20 - njëzet	80 - tetëdhjetë
janar - gennaio	1 - një	21 - njëzet e një	81 - tetëdhjetë e një, ecc...
februar - febbraio	2 - dy	22 - njëzet e dy	90 - nëndëdhjetë
mars - marzo	3 - tre-tri	30 - tridhjetë	91 - nëndëdhjetë e një, ecc...
prill - aprile	4 - katër	31 - tridhjetë e një	100 - njëqind
		32 - tridhjetë e dy, ecc...	

Tematika e proverbave në revistën 'Fiamuri Arbërit'

Manjola Lubishtani Msc.

Universiteti AAB, Prishtinë

Jeronim de Rada është një nga figurat qendrore të letërsisë shqipe dhe një ndër kontribuesit më të mëdhenj në krijimin e një letërsie artistike kombëtare, bartëse dhe përçuese e frymës përparimtare të Rilindjes. Një kontribut mjaft të çmuar jo vetëm për letërsinë shqipe, por veçanërisht për çështjen kombëtare dhe revista *Fiamuri Arbërit* (1883-1887), drejtor i së cilës qe vetë ai. Në faqet e saj De Rada i dha hov njohjes dhe zhvillimit të letërsisë arbëreshe, analizimit të strukturave gramatikore e argumentimit të lashtësisë së gjuhës shqipe, nxitjes së vetë dijes kombëtare për planet e synimet grabitqare të fqinjëve të Shqipërisë.

Një rëndësi të veçantë ai i ka kushtuar mbledhjes së folklorit arbëresh, duke i vënë vetes si qëllim që *krijimtarinë poetike dhe tërë veprimtarinë t'ia kushtojë kombit të vet "aq bujar e aq të braktisur"*¹. Me të njëjtin qëllim, De Rada boton në revistën *Fiamuri Arbërit* 43 fjalë të urta (të paraqitura në 4 numra), të cilat janë ruajtur me fanatizëm nga vetë arbëreshët, si dëshmi e pasurisë shpirtërore, përvojave jetësore e lidhjes së pashkëputshme me atdheun e tyre, Shqipërinë.

Fjalët e urta, ose proverbat, janë thënie të shkurtra kolektive që, në mënyrë shumë sintetike, shprehin mendime e gjykime për ngjarje, dukuri e çështje të ndryshme.² Meqenë se në to mishërohet vetë përvoja shumëshekullore e punës dhe e jetës së popullit, rëndësia e tyre është mjaft e madhe. Proverbat e botuara si në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe në mënyrë të tërthortë-figurative janë përçuese të mprehtësisë së gjykimit dhe të aftësisë për ta shprehur mendimin në forma të ndryshme:

- si përfundim logjik: *Kush bën të keqen, e qan vetë atë*.³
- si parim ose si ligj: *Peshku qelbet nga koka*.
- si këshill a sugjerim: *Kush lë të vjetrën për të renë, di çfarë lë, por nuk di çfarë gjen*.

Tematika e këtyre proverbave është e larmishme. Duke pasqyruar, veçanërisht në mënyrë indirekte, shqetësimet dhe realitetin që përjetonte populli shqiptar, ato shërbejnë si shtysë për vetëdijësimin e zgjimin e ndjenjave kombëtare, të respektimit të familjes e të marrëdhënieve brenda asaj, si dhe të kultivimit të vlerave njerëzore që sjellin përparim e zhvillim. Temat kryesore që trajtojnë, janë:

1. **Atdheu** (atdhedashuria, liria, qëndresa ndaj pushtuesve): *Fëmijës, që nuk qan, nuk i japin gji. Nëse bëhesh dele, të ha ujku*.

Shprehja e mendimit në mënyrë sintetike, karakteri i tyre përgjithësues e formulimi figurativ e nënkuptues bën që fjalët e urta të përdoren me disa kuptime. Një rol kyç, në zbërthimin kuptimor të tyre, luan koha, vendi dhe rasti kur thuhet.⁴ Duke pasur para sysh kontekstin historik, kur De Rada ngre fuqishëm zërin kundër synimeve e qëllimeve grabitqare ndaj Shqipërisë, ne mund të argumentojmë mesazhin që përcjellin proverbat e mëposhtëm si thirrje për syçeltësi ndaj intrigave të tilla aneksuese: *Më mirë kokë m'u, se bisht luani. Kur grinden mullisët, ruaj miellin*.

2. **Familja** (raportet brenda asaj, respekti e vlerësimi i barabartë i gruas shqiptare, fqinjësia e mirë): *E di luga se ç'ka ena brenda. Burri me qerre e gruaja me lugë dalin baras. Mishi nuk ndahet nga thoi. Më pranë e ke fqinjin se të afërmin*.

3. **Puna** (rëndësia e saj, dobisë e bashkëpunimit mes njerëzve, shfrytëzimi i kohës në dobisë të mirave materiale): *Pula që ecën kthehet me gushën plot. Njëra dorë lan tjetrën, të dyja lajnë fytyrën. Kush kërkon, gjen. Dielli ngroh atë që sheh*.

4. **Morali** (e mira dhe e keqja, mbizotërimi i së drejtës, përballja me pasojat që sjell e liga, virtytet e veset, vetëpërmbytja, modestia): *Fjala e mirë shpon gurin. Kush bën të keqen e qan vetë atë. Gjuha kocka s'ka e kocka thyen. Ku del gangrena i vënë zjarrin. Ç'bën, gjen. Kush bën varrin shokut, bie vetë brenda. Pështyma që gjuan lart të kthehet në fytyrë. Kush e shan gomarin, e blen. Djalli nuk ka lesh e shet mbulesa. Dardha e ka bishtin prapa. Jo çdo mizë bën mjalte. Njeriu nuk duhet të hajë sa ka e të thotë sa di*.

Proverbat e mësipërm janë shembull dhe mishërim i mençurisë dhe i mjeshtërisë së popullit për të transmetuar, kryesisht në mënyrë figurative, përvojën dhe preokupimet e tij që nga kohët e hershme e deri në ditët tona. Besnikëria, me të cilën ato janë ruajtur e trashëguar, meriton një konsideratë të çmuar dhe

Tematika e proverbave në revistën 'Fiamuri Arbërit'

vlerësim të pamasë, si dëshmi të një enciklopedie filozofike të ngritur ndër shekuj nga populli ynë.

Literatura:

Panajoti, Jorgo- Hyso, Riza. Folklori shqiptar, Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1989.
Shuteriqi, Dhimitër et al., Historia e letërsisë shqipe I-II, Prishtinë, 1968.

Shenime:

- 1) Dh. Shuteriqi et al., Historia e letërsisë shqipe I-II, Prishtinë, 1968, f.307.
- 2) J. Panajoti, R. Hysa, Folklori shqiptar, ShBLSH, Tiranë, 1989, f.232.
- 3) Të gjithë proverbat, në këtë punim, janë paraqitur në gjuhën standarde.
- 4) Po aty, f.233.

LA TEMATICA DEI PROVERBI NELLA RIVISTA "FIAMURI ARBËRIT" - Girolamo De Rada, una delle figure centrali della letteratura albanese, con la sua creatività ha fatto da battistrada alla fondazione di una letteratura nazionale, che educasse negli Albanesi il sentimento dell'amore per la patria, per la cultura e la lingua albanese. Con questo intento egli si dedica alla raccolta del folklore arbëresh, interesse che lo accompagnerà per tutta la sua vita.

E' appunto la rivista Fiamuri Arbërit (1883-1887), che si pubblicherà sotto la sua direzione, che servirà come tribuna della promozione della questione nazionale e della letteratura arbëreshe, creando un ponte unificante tra gli albanesi in tutte le parti del mondo.

Nelle sue pagine, accanto alla pubblicazione di opere importanti di autori arbëreshë e di corrispondenze con personalità note a quei tempi, troviamo pubblicato anche un certo numero di proverbi, la cui tematica corrisponde alle esperienze di vita e alla pratica multisecolare del nostro popolo. Per mezzo di essi De Rada riesce a veicolare messaggi importanti, che anche oggi suonano attuali.

Le parole-chiav: proverbi, ricchezza spirituale, esperienza di vita, patria, lavoro, famiglia, morale.

BIBLIOTEKA E JETËS ARBËRESHE

"Veprat" e zotit Emanuele Giordano:

Vangjeli, i pjerrë arbërisht – 2006 – ff. 230	€ 10
Mbledhje këndimesh arbëreshë – 2006 – ff. 160	€ 10
Himne Liturgjike Bizantino-Arbëreshe – 2005 – ff. 217	€ 10
Gramatikë Arbëreshe – 2005- ff. 70 (fotok.)	€ 10
Fjalor - edic. 2000 - ff. 715	€ 30
Shpata e Skanderbekut, di B.Bilotta – 1967 - ff. 217	€ 15
Folklore albanese in Italia - 1957 - (fotok.)	€ 10

"Pro Manuscript", me ndihmën e të nipit A.G.:

Shërbesa e Orëvet, Lutjesorja, Mbrëmësorja e Madhe, Shërbesa e Varrimit, 2008, ff.114, (fotok.)	€ 8
Vangjeli i perëndishëm dhe i shëjtë (Evangelario), 2010, ff.280, (fotok.)	€ 10
Apostulli (Epistolario), 2010, ff. 270, (fotok.)	€ 10
Liturgjia Hyjnore e të Parashëjtëruravet (Projazmëna) , 2011, ff.100, (fotok.)	€ 8

Telefononi: (+39) 0981-32539 / Shkruani: jetarbreshe@libero.it

Veshjet Arbërore në pikturën Arbëreshe

Merita Toçila

stiliste, nga Tirana


“Mori bijë, bijë e Lalës,/ Moj e bukur, e trishtuar,/ Pse m`kujton motin e shkuar?”

Kjo thirrje lutëse si tek Gavril Dara për të risjellë në memorije të kaluarën, ndjehet herë pas here dhe në pikturën e sotme arbëreshe. Është thirrja e Unit? Rugëtimi për tek rrënjët? Apo thjesht nostalgji për të parët? Ato nota nostalgjike më tepër se tek tiparet e qëndrimet shfaqen në veshje si elementi që i rezistoi më shumë dhe më gjatë asimilimit duke marrë forma të reja, por gjithmonë në të njëjtën përmbajtje. “Mbi të gjitha Shqipëria” e titullon tablonë e tij piktori Francesco Senise dhe për të treguar vërtetësinë e fjalës vendos në qendër të tablosë një stemë heraldike me shqiponjë. Ai është objekti më i vogël në tablo krahasuar me të tjerët, por vendosja në atë pikë rëndese, krijimi i një simetrie e cila përmbillet me një trekëndësh, qendra e të cilit përkton me këtë shqiponjë e bën atë objektin më rrezatues në tablo. Në dy anët e bazës së këtij trekëndëshi janë ulur dy gra arbëreshe të cilat stimulojnë tek ne një situatë meditimi. Pse njëra mban kanën në dorë me një vështrim të përhumbur deri në pikëllim, ndërsa tjetra i ka zgjatur një kallamar me penë për të shkruar. Mos vallë ajo që kujton duhet t’i shkruajë kujtimet që ato të mos humbasin?

Çfarë ka humbur tjetër mes jetëve të kaluara? Secila prej tyre ka veshjen arbërore me jakë të madhe të bardhë të stolisur që ndërhyjnë me një të prerë vertikale në të zezën e madhe të fustanit që hapet në formë V-je duke ndihmuar dritën të përhapet në gjithë portretin e gruas. Ky kontrast bardh e zi kur veshjet e tyre kanë shumë ngjyrë, tregon për një zgjedhje të ndërgjegjshme të ikanakëve arbërorë në shek. XV drejt brigjeve të Italisë. Ata mbajtën zi për ikjen, vdekjen, humbjen, moskthimin. Zija e tyre nuk ishte vetëm e brendshme, por dhe e jashtme e shfaqur tek fustanet, xhokat, kapelet, flokët. Me kohën ashtu si dhe dhimbja zbutet erdhën duke u zbutur dhe shenjat e koduara. Veshja filloi të marrë kontraste, të fitojë ndërhyrje dhe ndikime nga kostumet fqinje, por duke ruajtur me fanatizëm zgjidhjet artistike të vendosura në shekuj.

Kontrasti bardh e zi për shumë kohë, nuk mund të ishte zgjedhje e shtresave të varfra, vetë e bardha e kufizonte këtë mundësi, shto këtu dhe të zezën që duhej të ishte solide. Këto dy fisnike të ulura rreth oxhakut, kanë posturën e një mbreti barok me mënyrën e krehjes së flokëve, me palat e bardha që mbulojnë pjesën e kraharorit duke na treguar prejardhjen e tyre me sqimë. Gruaja djathtas e ka mbështjellë trupin me dy flamuj, njëri italian, për të treguar që u përket dy vendeve, por zemra i rreh për Shqipërinë. Brusha e piktorit vizaton me shpejtësi njollat e bardha në fundin e zi, për të ndërtuar strukturën vëllimore të palave dhe rrudhat e shumta të fustanit, fashat e mëdha të ngjyrave kalojnë gjoja si shkujdesur, por me inteligjencë ndërtohen raporte ngjyrash në funksion të idesë.

Dy gra të tilla piktorja Maria Nociti i nxjerr nga interiori dhe i vendos në eksterior, por aty vendos dhe një personazh të tretë, vrojtes ose analizues (me gjasë mund të jetë ajo vetë). Kjo tablo ka një kompozim të veçantë në mënyrën si janë vendosur personazhet. Duken sikur ato vijnë nga largësia-koha në këtë rast e simbolizuar me derën në planin e fundit, para së cilës jo pa qëllim është lënë një karrige bosh, e përcaktuar për atë që do të vinte prej saj. Porta është lënë në hije të plotë për të nënkuptuar misterin e së kaluarës dhe gjërat që s’kishin më kthim. Para saj dy gra të moshuara ulur në sofat duke qëndisur si të gjitha gratë shqiptare deri para luftës dhe në planin e parë një grua e kohës sonë, gjendja e së cilës është metafizike dhe e palidhur





Veshjet Arbërore në pikturën Arbëreshe

me realitetin e së kaluarës. Ajo figurë në profil që ngurron të identifikohet, për shkak të humbjes së këtij identiteti që e lidh me gjyshet, është dëshmi e një brezi të ri të larguar nga tradita, për shkak të botës së konsumit, industrializimit dhe globalizimit. A nuk është detaji i veshjes së saj një veshje e zakonshme e çdo gruaje në një pikë çfarëdo të globit? Ajo përpiqet të sjellë ndoshta të vetmin detaj autentik që i ka mbetur, të mënyrës së kapjes së flokëve, të cilit i ka kushtuar një vëmendje të posaçme.

Në plan ballor një tjetër autor Antonio Libonati, sjell portretin e një gruaje të moshuar arbëreshe. Më tepër se veshja ai ka dashur të memorizojë tiparet karakteristike të komunitetit arbëresh. Në rrezikun ndoshta edhe të asimilimit të kësaj popullsie megjithë qëndresën e fortë kulturore, realizmi i kësaj tabloje përpiqet të kontribuojë në kujtesën historike të popullit. Plani i afërt ballor lejon të shohim edhe punimin e dantellës karakteristike të kostumit të grave, i cila krijonte një dekor të bukur përreth qafës duke evidentuar tiparet e portretit të ndriçuara nga e bardha e jakës. Nga ana tjetër kjo ishte dhe një zgjidhje teknike e arrirë përsa i përket modelimit, pasi një prerje vertikale që fillonte me një V të stërmadhe i jepte gjatësi siluetës duke ndihmuar dhe një trup të shëndoshë të dukej më elegant.

Piktori **Nando Elmo** shkon më larg në kohë dhe në mënyrën si është vizatuar modeli i tij duket si mbërritja e arbëreshëve të parë në tokat e reja. Ajo mund të jetë një grua çfarëdo, e këtij shekulli apo të kaluar, por qëndrimi i saj, nostalgjia që e ka mbytur, e kaltra e ëndërrimit që përzihet me tokësoren që e zgjon, i kujton asaj se ka mbetur aty në një vend të largët, me një veshje që nuk i ka mbetur asgjë nga kostumi i dikurshëm i saj, me shaminë e thjeshtë që i ka zëvendësuar kurorën që i zbuluronte kryet, por që ia ruan ende fisnikërinë edhe pse me këmbët zbathur, ajo është aty si provë e ekzistencës së saj. Nuk ka rëndësi nëse jeleku i saj i ka humbur dekoracionet, këmbisha dhe fundi i saj nuk janë më në materiale të zgjedhura, të jetuarit e saj për më tepër me kujtime të forta na përfshijnë në emocione të fuqishme për të kaluarën tonë të përbashkët.



Luigi Amato ndërton një interior me dy personazhe dhe e titullon “Gjyshit”. Është aq e ngrohtë dhe familjare kjo tablo, sa çdokush mund të rreket t’i kthehet kujtimeve të veta të fëmijërisë ku absolutisht prania e një gjyshi mbetet një nga momentet më përmalluese dhe si lidhja e vetme për të shkuar tek e kaluara. Vizatimi realist i karaktereve në një brendi ku shquhen objekte të kohës japin një informacion mbi mënyrën e jetesës, dekorimin interiorëve, kompozimin e veshjeve të individëve, si dhe marrëdhëniet e ndërtuara midis brezave. Të gjithë këto elementë ndërtojnë botën arbëreshe të një shekulli më parë, ardhur aq natyrshëm nëpërmjet penelit të piktorit.

Giulia Morselli krijon një model tip me veshje tradicionale dhe e vendos në një situatë ceremoniale. Për nga mënyra si e kompozon tablonë, si e zgjedh vizatimin e figurës, si e shmanng perspektivën duke i vendosur personazhet në një sfond të sheshtë të kujton piktorin Abdurrahim Buza, aq shumë i tërhequr pas traditës kombëtare. Asaj i intereson të arkivojë në këndvështrimin e vet artistik. Dëshiron ta qëndisë kostumin e gruas me të gjitha detajet që përmban ajo veshje, preferon të mos humbasë ngjyrën, formën këmbanore, bustin dhe krehjen e flokëve. Të gjitha të zgjidhur thjesht, gati të habit se me aq elementë të kursyer arrin

Veshjet Arbërore në pikturën Arbëreshe

të ndërtojë kostumin. Po të njëjtën përkujdesje i kushton edhe figurës së burrit me gajde, i cili ka elementët karakteristikë si jelekun, brekeshat deri tek gjunjët me çorapet e lidhura kryq dhe këmbishën e bardhë. Ngjitur me këto figura plot gjestikulacione, pa u lodhur, ajo vendos figurën e Skënderbeut me kalë ashtu siç mund të jetë përfytyrimi i saj për të dhe siç mund të jetë impresionuar prej pikturave të kohës e gojëdhënave për të. Ajo bën atë që kishte bërë dhe Mikel Trota dekada më parë, kur e solli Skënderbeun në vështrim realist, si një pikë referimi prezent në të kaluarën, të sotmen dhe të ardhmen.



Nando Elmo ndikohet dhe nga ngjarje të kohës, pjesë e të cilave ndjehet se i përket duke realizuar tablonë “Kosova”, referuar luftës së Kosovës në 1999. Aty nuk dallohen shumë detaje të veshjeve sepse trajtimi është si kokat e Idromenos para portës së ferrit në ditën e gjykimit, por këtu shkaku i pasojës nuk janë vetë njerëzit e atyshëm dhe kjo shpjegon revoltën e madhe dhe të fuqishme. Në qendër të tablosë është figura e një plakut Kosove me rubën e bardhë që klith nga dhembja e madhe, jo aq për vete sesa për gjithë tokën e tij dhe bijve të tij dhe ata flamuj të kuq që rrinë mbi kokat e të gjithëve në përpjekjen për të qëndruar.

Duket se nostalgjia është një emocion që shoqëron veprat e Elmos, pasi në eksplorimin e tij artistik, ka marrë një detaj nga përrallat me temën “Orët” ose “Shtojzavallet”, dhe e kthen në motiv të tablosë së tij, një motiv i përrallshëm që vazhdon të ushqejë brezat këtej e përtej kufijve tash sa mot. Kjo na bën të mendojmë se kjo nevojë për t’u ushqyer vazhdimisht nga trangu i përbashkët, kjo kërkesë e vazhdueshme për kthimin tek rrënjët, na bën të jemi më të vëmendshëm dhe jo indiferentë për artin që zhvillohet në kushtet e lirisë së zgjedhjes, por robërisë së shpirtit nga dashuria për mëmëdheun e të parëve. Po të kërkojmë më tepër në kohë, do të mund të zbulojmë vepra të mrekullueshme të arbëreshëve të çdo kohe, të cilët përvec pasqyrimit të realitetit dhe ndjesive që u provokonte koha, nuk kanë lënë mënjane dhe kostumin e tyre të mrekullueshëm me elementë të fortë identitare, që padyshim na intrigojnë për të studiuar gjatë zhvillimin e veshjes së kësaj popullsie në brigjet jugore të Italisë, me bindjen e plotë se do të gjejmë një pjesë të historisë brenda saj.

Lab-Labëri, Arbër-Arbëri

dr. Zamira Metaj Alimemaj

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Me emrat "Labëri" dhe "labë" kuptojmë vendin dhe banorët e njerit nga grupet etniko-historike të jugut të Shqipërisë, që mori pjesë në formimin e grupit të madh e të përbashkët të quajtur Toskëri. Të dhënat e para për trevën e Labërisë i përkasin shek. XI dhe vijnë nga një burim perëndimor. Bëhet fjalë për episodin e Baligantit në Këngën e Rolandit, të cilin bizantinistët Henri Gregoire et Raoul de Keyzer e lidhin me ekspeditën e Robert Guiskardit më 1081-1085 në viset perëndimore të gadishullit të Ballkanit, në zonën nga Butrinti në Durrës. Sipas studiuesit Rami Memushaj, i cili ka bërë një studim mbi prejardhjen e emrit "lab" e "Labëri", mund të pohojmë me siguri, se të paktën që nga shekulli XI, territori i Labërisë quhej Arbëri. Lidhur me përmbajtjen e emrit Arbër, studiuesit shqiptarë i përmbahen teorisë sipas së cilës: nga emri i fisit Albanoi, që shënon Ptolomeu, i cili lokalizohet diku në Shqipërinë Qëndrore, ky emërtim u përhap vëllë drejt periferisë.

Një hipotezë tjetër mbi përhapjen e emrit "arbër" është edhe ajo e J. Tunman-it, i cili "mendonte që emri Albani, që i takonte më parë një fisi iliro-maqedon, u përdor më pas nga autorët byzantinë për gjithë banorët e krahinës iliro-epirote". Emrat Arbër, Arbëri dhe Arbëresh janë ruajtur në kujtesë brez pas brezi, deri në ditët tona, nga populli i krahinës së Labërisë.

Sh. Agaj, një njohës i mire i kësaj krahine, thotë: "Labërit kanë edhe një emër tjetër: Arbër dhe Arbëreshë. Sot e 40-50 vjet, qytetarët e Vlorës nuk thoshin që erdhi një lab, po erdhi një Arbër ose Arbëresh; dhe kur arratisesh ndonjë fajtor për në Labëri, thoshin: "Mori Arbërinë përjetë".

Termi Labëri e Lab si njësi etno-kulturore, është evidentuar dhe nga autorë të huaj. Sipas H. Holand: "Popullsia e Shqipërisë thyhet në disa fise, ndarja e të cilëve, nisur nga saktësia me të cilën e përcaktojnë vendsit, duhet të ketë ekzistuar për një periudhë shumë të gjatë. Gegët, Labët, Liucët, Toskët, Çamët dhe fise të tjera më të vogla ose që rrjedhin prej tyre, kanë gjithë dallimet, për të cilat është i vetëdijshëm çdo shqiptar, i cili i dallon ata si nga dialekti, ashtu edhe nga territori i tyre. Është e domosdoshme të sqarojmë prejardhjen e termave lab dhe Labëri. Shpjegimi i termit Labëri nuk ka sjellë ndonjë vështirësi të madhe për studjuesit. Sipas tyre mund të shihet ose si një formim nga shumësi i fjalës labër, ashtu sikurse nga Arbëri në arbër, ose si një formim normal nga lab, me prapashtesën-ëri, ashtu sikundër janë formuar dhe krijuar edhe fjalë të tjera, si Arbëri, Toskëri, Gegëri, Shqipëri etj, të cilat formohen nga temat gjegjëse dhe të dyja zgjidhjet janë njëlloj të pranueshme.

Vështirësi për një përshkrim më të saktë paraqet rrënja e kësaj fjale, pra lab. Me këtë fjalë ashtu sikurse edhe me fjalën arb, janë marrë shumë studjues si gjuhëtarë, historianë, albanologë etj. Si E. Çabej, R. Memushi e ndonjë tjetër të cilët në të shumtën e rasteve kanë dhënë versionet e tyre. Pavarësisht përpjekjeve, nga ana e studiuesve, deri më sot nuk është dhënë përgjigje përfundimtare në përputhje me kërkesat shkencore dhe gjuhësore.

Përpara se të merremi me sqarimin e këtij problemi le të shikojmë fillimisht se ku shfaqet ky emër, dhe në cilën hapësirë gjeografike e hasim atë.

Sipas studimeve, popullsia labe në kohë të lashta nuk ka qenë e formuar në një grup të përbashkët krahinash etnografike, por qenë krahina të veçanta e të palidhura në mes tyre. Dalim në këtë konkluzion sepse në mesjetë nuk kanë një emër të përbashkët por kanë emra të ndryshëm si, Grisejtë, Kirilisejtë, Plesejtë (Plesati i sotshëm), Korvesejtë (Kurveleshi i sotshëm) etj. Përmenden si njësi të veçanta dhe të shkëputura nga njëra-tjetra.

Emri lab në mesin e shekullit XIX ndihej i ri për banorët e krahinës. Këtë e provon dëshmia e Hanit, i cili shkruan se: "popullsitë fqinje e përdorin këtë emërtim me një kuptim të dyfishtë, gjithnjë përbuzës, për njerëz të leckosur dhe të pistë, por edhe për hajdutë dhe brigantë" dhe për këtë arsye "autoktonët nuk e pëlqejnë këtë emër si fyes për ta".

Në trevën e Epirit banonin katërmbëdhjetë fise, si Kaonët, Molosët, Thesprotët etj. Banorët shqipfolës të kësaj treve e quajtën veten sipas viseve të tyre, përkatësisht Çamë, Labë a Arbëreshë dhe Toskë., kurse

Lab-Labëri, Arbër-Arbëri

viset përkatëse ata i quajten përkatësisht Çamëri, Labëri dhe Toskëri. Në lashtësi, krahina që sot quhet Labëri, dhe para dy shekujsh Himarë, quhej Kaoni dhe banorët e saj kaonë. Kaonët kanë qenë një nga fiset e Ilirisë Jugperëndimore, që Krishtit, në librin e tij “Udhëtim rreth botës. Gjithashtu emri i Kaonisë dhe kaonëve përmendet edhe nga bashkëkohës të tjerë të Hekateut si Skylaksit i cili thotë se “pas ilirëve vijnë Kaonët...pas Kaonisë vjen fisi i Thesprotëve”, si dhe Tuqididi në fund të shek. V para Krishtit. Emri i Kaonisë përmendet edhe nga autorë të mëvonshëm grekë e romake duke përfunduar me Stefan Bizantinin, autor i shek. VI pas Krishtit. Banorët e krahinës e kanë ruajtur më gjatë emrin e Kaonisë. Kjo vihet re në dëshmitë e shkruara si dhe në folklorin e krahinës, në një këngë labe thuhet: “Bijë e Vlorës moj Himarë / je bërë prehë e zilisë / e moj nusja margaritarë / në gjirin e Kaonisë” apo në vargjet e një kënge të vjetër, “Ata dine ç’trima janë / që në kohë të Haonisë”.

Bibliografi

Memshaj, R. (2003), Rreth hipotezës së prejardhjes lab-Labëri, nga arbër-Arbëri, Buletini Shkencor nr. 4, Universiteti “Ismail Qemali” Vlore, f. 37, Tiranë

Demiraj, Shaban, (2008), Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët, Tiranë, ISBN: 978-99956-682-2-8

Gaçe, Bardhosh, (2009), Kënga popullore e Lumit të Vlorës, Toena, Tiranë, ISBN: 978-99943-1-521-5

LAB-LABËRI, ARBËR ARBËRË - Con le parole “Labëri” e “labë” indichiamo il posto e gli abitanti di uno dei gruppi etnico-storici del sud dell’Albania, che prese parte nella formazione del gruppo grande e comune chiamato “Toscheria”. Molto si è discusso sull’origine del nome “lab” e “Labëri”. Tutte le testimonianze parlano di un’unione stretta tra loro e le parole “arbër” e “Arbëri”.

gju-ri *sm.* ginocchio

gjuhë-a *sf.* lingua

gjuhëgjatë *agg.* linguacciuto, pettegolo

gjuhëqelbur *agg.* volgare

gjuhësi-a *sf.* linguistica

gjuhësor-e *agg.* linguistico

gjuhëz-hza *sf.* battacchio della campana

gjuhëzi-zezë *agg.* dalla lingua nera (italiano)

gjumë-i *sm.* sonno

gjumëmath-dhe *agg.* dormiglione

gjumës-msi *sm.* sonnifero, papavero

Fjalorth Arbërisht- Lëtisht

Emanuele protopapas Giordano

albanolog, ka Frasnita (Cs)

(vjen ka nr.75)

gjëmë-a *sf.* fulmine, folgore; rombo; sventura;

gjëmim-i *sm.* tuono, rimbombo

gjëmonj *v.intr.tr.* tuonare, rimbombare

gjëndem *v.pass.* trovarsi

gjëndërr-drra *sf.* ghiandola, tonsilla; tumore

gjëndje-a *sf.* posizione, situazione, ritrovamento

gjënj *v.tr.* trovare, rovistare; ottenere

gjë-ri *sm.* cosa, elemento, dovere

gjëthë-t *sn.* latte materno

gjëzë-a *sf.* cosetta

gjì-ri *sm.* seno, petto; ventre

gjinde-ja *sf.* gente, popolo

gjindë-t *sn.* gente, popolo

gjiri-a *sf.* parentela, stirpe, nazione

gjiri-u *sm.* parente, affine

gjisht-i *sm.* dito

gjishtël-tla *sf.* ditale (per mietero o per cucire)

gjishtla-t *sf.pl.* ditali (un tipo di pasta di casa)

gjitòn-i/e *sm.sf.* vicino/a di casa

gjitoni-a *sf.* vicinato

gjithapàru *avv.* dappertutto, dovunque

gjithë *agg.pron.indef.inv.* tutto-a/tutti/e

gjithësi-a *sf.* universo, mondo, tutto

gjithkund *avv.* ovunque

gjithmonë *avv.* sempre

gjithnjë *avv.* tutt’uno, simile, insieme, ugualmente

gjithnjëhërje *avv.* subito, all’improvviso

gjithsëj *prof.indef.indecl.* tutto, ogni cosa

gjithshorçit *avv.indef.* tutto, ogni cosa

gjizë-a *sf.* ricotta

gjon-i *sm.* assiuolo; porco

gjonkalli-u *sm.* assiuolo

gjumth-i *sm.* sonnellino

gjurmë-a *sf.* traccia, orma, impronta, residuo

gjukim-i *sm.* giudizio

gykonj *v.tr.* giudicare, pensare, credere

gymës-msa *sf.* metà, mezzo

H

ha *v.tr.* mangiare

hahalisënj *v.intr.* sghignazzare, ridere a crepappelle

hajdhi-a *sf.* gioia, allegria; carezza; dolce

(shih më përpara)

Çështje të religjionit në poezinë “Elegji” të Zef Serembes

dr. Alisa Velaj & dr. Helena Grillo

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Në analizën e poezisë “Elegji” kemi parë të arsyeshme të diskutojmë polemikën mbi çështje të besimit fetar, duke pasur parasysh se poeti i përket besimit të krishterë, dhe mbështetur në metodën e analizës së tekstit lënda gjuhësore do të na shërbejë për të hulumtuar mbi kuptimin e poezisë së Serembes. Sipas klasifikimit tipologjik të teksteve, elemente të “Elegjisë” lidhen me fatalitet, dhimbje e humbje të mëdha ¹, por nga analiza e mëposhtme konstatohet se nuk është vetëm lloji letrar që përshkon boshtin e fatalitetit në poezinë e Serembes. Poezia “Elegji” e Zef Serembes është materia lirike ku pesimizmi serembian merr përmasa të fatalitetit dhe pikëllimi për humbjen e së dashurës shndërrohet në pikëllim kozmik. Mendimi i studiueses Klara Kodra se ky pesimizëm është më tepër dëshpërimi i çastit, dhe nuk i jep tonin mbizotërues lirikës së tij dashurore e filozofike ², del i përmbysur në analizën e kësaj poezie. Në anën tjetër, jemi plotësisht dakord me mendimin e studiuesit arbëresh Albert Stratikoi, i cili shkuan: “*Dhembja formon motivin zotërues të poezive të Serembes, por kjo dhimbje nuk e bën poetin të afetarizohet, nuk e shtyn të përdorë nëma dhe fjalë sulmuese të furishme, nuk e shtyn as që të ngrerë krye kundër shoqërisë dhe Zotit*”³. Është e justifikueshme psikologjikisht thirrja për ndihmë nga Zoti, kur shpirti klith pa rrugëdalje, në skajshmëri të dhimbjes e vuajtjes.

Ku e ka zanafillën e vet gjithë ky dyzim në poezinë “Elegji”? Elegjia si formë e lirikës ka në thelb të saj pikëllimin, vajtimin e pafund, ndërkohë që në vargjet e poetit ai krahas klithjes dëshpëruese për humbjen e pakthyeshme tokësore, ka edhe vargje ku lutet dhe i përgjërohet qiellit si besimtar i vërtetë. Sipas studiuesit S. Hamiti: “*Në poezinë Elegji ndeshim kontrast mes jetës jo të qetësishme – disharmonisë së saj dhe jonisë (harmonisë), këtë të dytën e kërkonin dhe krijonin romantikët në vizionet e tyre poetike. Disharmonia jetësore këtu është përmbledhur në fjalën ‘Vajtim’, që është gjendje shpirtërore që pason dhimbjen dhe humbjen*”. Mirëpo, duhet theksuar se në ndryshim nga romantikët, poeti nuk arratiset drejt vendeve të tjera tokësore, por si besimtar e gjen paqen vetëm në kozmos, në dashurinë e qiejve ⁴. Këtu e ka zanafillën dyzimi i poetit në “Elegji”.

Sipas orthodhoksisë, lutja para Perëndisë është edhe e tipit të vajtimit a të ankimit për kushtet e jetës dhe kuptimit të ekzistencës, veçanërisht në kohëra fatkeqësie dhe turbullirash. Serembja jo vetëm që nuk afetarizohet, por në çastin kur pikëllimi i tij merr përmasa kozmike dhe ekzistenca i duket pa asnjë rrugëdalje, në këtë pikë, ai lë mënjanë ankimin dhe i përgjërohet qiellit. “Pa e tepruar ankimi i poetit tonë, as më shumë, as më pak, i shëmbëllën ankimit të Krishtit, i cili i mërthyer në kryq e në jermi, arriti të thotë: (‘Eli, Eli, lama sabachthani’) –Zot, pse më harrove?”⁵. Ky konstatim i Xhevahir Spahiut e ka shpënë edhe më tej atë që kanë konstatuar Belmonte apo Stratikoi, ndërsa del krejt i kundërt me atë çfarë etiketojnë kritikët e arealit shqiptar të Shqipërisë londineze, të cilët duket se pak e njohin filozofinë kristiane, e pa këtë filozofi, zor se mund të kuptohet gjendja e dyzuar e poetit në këtë lirikë. Poeti arbëresh i mbërthyer në kryqin e mundimeve të tij, pasi gozhdët e hidhërimit i kanë tejshpuar edhe kockat, bën pikërisht atë lloj “blasfemie” që Bibla përshkruan në fjalët e fundit të Jezuit. Nuk mund të jetë absolutisht afetar një Serembe që në opusin e tij lirik përmban poezi të tilla si: *Shën Mërisë së Virgjër, Shën Mërisë së papërlyer, Zotit etj.* Ai klith nga dhimbjet tokësore, e më pas përgjërohet me vetëdije hyjnore. “*Dhe drita përhapet e rri / mbi gjithçka që krijoi Zoti*”.

Së pari, fataliteti në poezinë “Elegji” projektohet në kontrastin përtëritje natyrë - shpirt i lënduar i unit lirik, ndikim ky i hapur nga poezia e De Radës. Fataliteti serembian qëndron mbi atë deradian. Ndërsa Serembja rebelon kundër qiellit, De Rada e pranon vdekjen si pjesë të jetës, ai vjen më i bindur përballallë fatit që i ka paracaktuar Zoti, ndaj dhe pikëllima e tij nuk i kalon kufijtë e vetvetes. Vdekja shihet si ligj i natyrës, si natyrore.

“*S’është zemërimi i Zotit / djalit, grua, që të rrëmbeu: / dheu të gjithë na mbulon.*”

“*...Si ajo që iku / edhe rron përtej, / kështu rrojmë ne pas vdekjes*”.

Çështje të religjionit në poezinë “Elegji” të Zef Serembes

Së dyti, kontrasti në lirikën “Elegji” ngjizet në raportin dritë e pavdekshme hyjnore-dritë e shuar tokësore. Kontrasti i dytë e brendashkruan të parin dhe i gjithë ky proces plazmohet përmes simbolesh astrale si hëna, dielli dhe yjet. Drita vërshon vullshëm në poezinë “Elegji”, herë si dritë e fortë, e herë si dritë e zbehtë. Bukuria e vajzës, njësoj si edhe tek De Rada, krahasohet vazhdimisht me ndriçimin e yllit. Kemi vashën si yll që e gjejmë gjithandej folklorit arbëresh dhe shqiptar. Në anë tjetër, krahas *vashës si yll*, dhe *yllin e vashës*.

“M’u shfaq një yll i bukur”.

Kontrasti i vetmisë nuk e ka lejuar poetin t’ia zbehtë bukurinë e ndriçimin vashës së objektivizuar në yll. Megjithëse figurativisht poeti përshkruan dhimbjen e trazimin shpirtëror që i trandi zemrën, në vetdijen e tij nuk është zbehur ndriçimi i yllit. Për të nuk zbehet drita e ndritur që vjen në formën e yllit të vashës. Kjo shkon në kahe të kundërta me logjikën, pasi në këtë gjendje të trazuar ndriçimi i yllit duhet t’i pasqyrohej poetit i venitur, i zbrazët, por ai përkundrazi, megjithëse i vetëm i vjen me ndriçim të dyfishuar. Qiellorja i ndan si largësi objektore, por jo shpirtërore, sepse në hapësira qiellore nuk ka vend për distancë. Aty hapësirat bashkohen drejt kozmosit, drejt gjithësisë që i përket botës poetike e shpirttrave të lirë. Në të dy poetët arbëreshë shohim se krahas lëvizjes kohore, dielli, hëna dhe yjet marrin statusin e simbolit.

“Kur u çova për së pari, / nga Mbuzati hënëza / sipër detit llamburinte. / Kur u çova për së dyti, ylli s’ish duke vështruar / njerzit e bishat që flinin, / por u takste deleve / net me fate të mëdha. / Kur u çova për së treti, / hëna kishte perënduar...” (De Rada, Milosao).

“O! Gjer t’ikin këto ditë / e të hyj ndër yjet / të të shquaj e përrorez, larg prej shpirttrave të tjerë / më ne të mos ndahemi”.

Përshkrim poetik të ndryshëm në rrjedhën e ngadaltë të natës. Duke u zgjuar sheh qëndrimin e ri të hënës. Si tokësor koha lëviz - gjendja shpirtërore mbetet e pashpresë. Në rastin e parë hëna, dielli dhe yjet përfaqësojnë lëvizjen kohore, ndërsa në rastin e dytë yjet fitojnë statusin e simbolit.

1) **Aristoteli**, *Poetika*, Botime Çabej, 2006; 2) **Klara Kodra**, *Vendi i Serembes në letërsinë arbëreshe*, në Serembe më të bukurës në Strigari, Toena, Tiranë 2000, f. 374; 3) **Albert Stratikoi**, *Zef SEREMBE*, po aty, f.358; 4) **S. Hamiti**, *Poetika e kontrastit*, po aty, f.358. 5) **Xhevahir Spahiu**, *Ankim-përgjërimi i poetit*, po aty, f.404 .

LA QUESTIONE DELLA RELIGIONE NELLA POESIA “ELEGJI” DI ZEF SEREMBE -

Nell’analisi di confronto fra i poeti arbëreshë Serembe e De Rada, abbiamo ritenuto opportuno partecipare alla polemica sulla questione della fede religiosa, tenendo presente che i due poeti appartengono alla fede cristiana e basandoci sul metodo dell’analisi del testo; la materia linguistica ci è servita per investigare sul significato della poesia del Serembe. In primo luogo, la fatalità nella poesia “Elegia” si proietta nel contrasto di rinnovamento natura-spirito mortificato dell’Io lirico, influenza palese dalla poesia del De Rada. Il fatalismo serembiano resta sopra quello deradiano. Mentre Serembe si ribella contro il cielo, De Rada accetta la morte come parte della vita, è più convinto di fronte al destino che gli ha predestinato Dio, dunque anche il suo dolore non oltrepassa i confini di se stesso. In secondo luogo, il contrasto nella lirica “Elegia” si concentra nel rapporto ‘luce immortale divina - luce spenta terrena’. Il secondo contrasto iscrive il primo e tutto questo processo si plasma attraverso i simboli astrali come la luna, il sole e le stelle. La luce straripa impetuosa nella poesia “Elegia”, a volte come luce forte, a volte come luce soffusa. La bellezza della ragazza, ugualmente come anche in De Rada, si confronta continuamente con la luminosità della stella. Abbiamo la ‘ragazza come stella’, che troviamo dappertutto nel folklore arbëresh e albanese.

www. agm.calabria.it

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

Dr. Denisa Tare

Universiteti "A.Moisiu", Durrës

*"Emri yt o atdhetar i ndjerë
Kurrë mos të harroft no një herë
Se pate dashuri për Atdhenë
Aqë sa pak janë që mund ta kenë"*¹

Asdreni

Jeronim De Rada ka hyrë në historinë e kulturës shqiptare si një figurë komplekse e letërsisë shqipe, si një personalitet poliedrik. Ai lindi në 20 nëntor 1814 në fshatin arbëresh Makia, natyra e egër dhe e bukur e së cilës, plot ulla dhe vreshta, të kujton fshatrat tona jugore. Nga ky fshat kanë dalë figura të shquara që kanë kontribuar në favor të çështjes kombëtare shqiptare, si Françesk Avati, Jeronim De Rada, Zef De Rada (i biri i poetit), Kamil De Rada (vëllai i poetit), Françesk De Rada (nipi i poetit), Domeniko Antonio Markeze, Mikele Markianò etj.² Shtëpia e De Radajve dallohet nga godinat e tjera të fshatit. Ajo ka një portë të madhe hyrje me formë harku. Mbi të qëndron stema e familjes së poetit, e cila ka banuar këtu prej shekujsh.

Në këtë shtëpi, të zhveshur, në këtë fshat të humbur pa rrugë dhe pa lidhje postare, kaloi jetën e vet, punoi dhe luftoi De Rada i cili fitoi admirimin e gjithë shkrimtarëve të mëdhenj evropjanë. Këtu De Rada në këtë oaz të tij të vogël ai krijoi galerinë e tij të figurave të mëdha heroike me Skëndërbeun në krye, që përshkajnë veprën e tij epike. Shtëpia ku banoi De Rada në Maqë, ka qenë dikur e Markjanojvet. Më pas këtë banesë e trashëgoi e ëma e poetit, e cila rridhte nga dy familje të vjetra, Avati dhe Sqiljizi. Stërgjyshërit e babait të poetit rridhnin nga Pjetër Anton Rada nga Shqipëria, për të cilin në Arkivin e Venedikut të vitit 1300 ndodhet një kontratë shitblerjeje.³ De Rada ka lindur në gjirin e një familjeje arbëreshe me tradita të lashta atdhedashurie. Familja e Radajve ka qenë mbrojtëse e këtyre traditave, mbrojtëse e të drejtave të arbëreshëve dhe armike e kujdo që mendohej t'i merrte nëpër këmbë këto të drejta dhe t'i çkombëtarizonte arbëreshët. Paraardhësit e De Radës i shohim të militojnë në rradhët e Republikës së Napolit në vitin 1799 dhe pastaj në atë të Karbunarëve⁴ dhe të Italisë së Re⁵ të Mazzinit. Ata morën pjesë në këto lëvizje revolucionare, të cilat luftonin kundër tiranisë, dhe obskurantizmit, për çlirimin e përparimin e popujve. Jeronimi ishte djali i priftit Mikel De Rada, i cili i dha mësimet e para. Ai ishte profesor i greqishtes së vjetër dhe latinishtes në Kolegjin e Shën Adrianit. Në prill të 1822, kur ishte vetëm tetë vjeç, De Rada hyri në Kolegjin arbëresh Shën Mitër Koronës. Kolegji i Shën Mitër Koronës ishte tempulli i dijes dhe që gjatë periudhës së Rilindjes⁶ vatër e patriotizmit, sa që në revolucionin e 1848 nga ky kolegji morën pjesë nxënës dhe mësues të tij. Edhe në lëvizjen revolucionare të 1860, italo-shqiptarët ishin në linjë të parë në rradhët e këmishë-kuqëve të Garibaldit. "Kolegji- do shkruaj më vonë De Rada- u hap si derë e madhe drite të ëmbel dhe të re për të gjitha shtëpitë arbëreshe ... Aty do të fillojë të shkruhej gjuha shqipe ... Ishte ky agimi i ri i ditës sonë, megjithëse pak i largët... Në këtë kolegji u shpjegoheshin nxënësve, së pari, vetitë e bukura të heronjve të tokës së Greqisë dhe të Romës, që ndryshuan botën me bëmat e tyre të mëdha... Kolegji-thekson De Rada – ka qenë gjithnjë vatër lirie dhe dritë për ne"⁷. Ai ishte një institut fetar që kishte si qëllim të arsimonte të rinjtë shqiptarë të cilët merrnin leksione në fushën e letërsisë, shkencës, teologjisë dhe drejtime të tjera. Kur doli nga kolegji, De Rada kishte marrë një pregatitje mjaft të thellë.⁸ Ai del nga kolegji në vitin 1833 në moshën 18-vjeçare siç citon ai "i mburrur me të kaluarën dhe pa kurrfarë synimi për të ardhmen". S'ka dyshim se përveç talentit, leximet e shumta shërbyen në formimin letrar të poetit të ardhshëm. Ashtu siç do poet tjetër, De Rada e ndjeu të nevojshme të lexojë dhe studiojë poetët dhe poezinë botërore, të zgjerojë përherë e më mirë aftësitë e talentin e tij, të zgjerojë horizontin e tij kulturor-estetik.

Po atë vit (1832) ai shkroi poemën me temë historike, që frymëzohej nga mërgimi i arbëreshëve në kohën e Skëndërbeut, me titullin "Odiseu". Më vonë i ati e dërgon të kryejë studimet juridike në Napoli⁹. Më 1 dhjetor 1834, De Rada gjendet në Napoli ku u dërgua siç u citua me lart me dëshirën e të atit. Ja si shprehet

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

vetë poeti: “ Mbasi shkova në Napoli, në nëntor të vitit 1834, duke mos ditur të flas mirë italisht, për një ndrojtje që nuk munda ta mposhtja, nuk vlejta gjë për shkollë dhe kjo e shtoi kundërshtimin tim ndaj fakultetit të drejtësisë, por nuk munda të pranoj në mënyrë të heshtur, asgjësimin tim”.¹⁰ Drejtësia nuk i pëlqeu poetit tonë, por megjithatë ai nuk i ndërpreu studimet. Nga prilli i 1835 ai u pranua në shkollën e gjuhës italiane të markezit Puoti, një filolog napoletan i përmendur në atë kohë. Po as studimet e lëtërsisë nuk e tërhiqnin por ai vazhdonte t’i ndiqte për të mos brengosur të atin. Studimet për drejtësi, kursi i klasicizmit nuk e kënaqën shpirtin e poetit. Kjo qe arsyeja që ai u dha mbas lëtërsisë moderne evropiane. Periudha e parë e qëndrimit në Napoli ka rëndësi për poetin tonë, pasi ai jo vetëm që u afirmua si shkrimtar dhe folklorist, por zgjeroi më tej dhe kulturën e vet letrare. Në verë të 1836, poeti dha provimet përfundimtare në Universitetin e Napolit. Doli me rezultate të larta dhe u diplomua.¹¹

Për shtatëdhjetë vjet me rradhë, që nga viti 1832 e derisa vdiq, më 28 shkurt 1903, ai hartoi mbi 30 vepra të ndryshme, në shqip dhe në italisht, me karakter letrar, folklorik, estetik, sociologjik, publicistik. De Rada iu kushtua dy idealeve kryesore: Atdheut dhe artit. Ai i kushtoi gjithë jetën e tij poezisë dhe atdheut. Megjithëse në kushte të vështira politike, shoqërore, ekonomike dhe familjare ai ruajti përherë, kthjellsinë mendore të poetit dhe thellsinë e sintezës së dijetarit dhe lëvruarit të gjuhës.¹² De Rada krijoi një poezi në kuptimin e mirfilltë të fjalës, një poezi kombëtare artistike. Kjo poezi u mbështet fuqimisht në poezinë popullore dhe atë tradicionale. Në të gjithë veprimtarinë e tij poetike, De Rada i këndoi Shqipërisë së shekullit XV dhe heroizmit të popullit tonë, dhe lartësoi me fisnikëri personalitetin e gruas shqiptare, evokoi të kaluarën tonë të lavdishme, shprehu besimin e patundur për një të ardhme të lumtur të atdheut.

De Rada punoi shumë për përforcimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve të cilët vuanin në atdheun e të parëve prej katër shekujsh, nën zgjedhën e rëndë të osmanëve. Ai njëkohësisht punoi për lulëzimin e lëtërsisë shqiptare me frymë kombëtare dhe popullore. Me veprimtarinë e gjerë dhe me talentin e tij poetik, De Rada ndikoi në krijimin e një plejade të tërë poetësh, veprat e të cilëve hynë në fondin e artë të lëtërsisë shqiptare. Merita e tij qëndron në faktin se, i gjëndur në brendësi të komunitetit arbëresh që kishin emigruar në Itali në shekullin e XV, ai krijoi në shekullin e XIX një poezi me tipare thellësisht kombëtare, me cilësi të larta artistike. Përmes kësaj poezie De Rada arriti jo vetëm që të zgjojë ndjenjat kombëtare të atdhetarëve të tij por ajo shërbeu edhe për të zgjuar opinionin publik të Evropës për çështjet e kombit shqiptar, qënien e të cilil disa shtete e mohonin me vetëdashje.

Krahas veprimtarisë letrare De Rada u mori dhe me veprimtari shkencore duke përpunuar një varg punimesh gjuhësore rreth shqipes, shkruar në italisht dhe botuar në shumë organe të shtypit të kohës ose në libra të posaçëm. De Rada i kushtoi shumë kujdes çështjes së prejardhjes së gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve. Ai luajti një rol të rëndësishëm dhe në historinë e shkollave shqipe duke botuar dhe redaktuar shumë tekste shkollore. Në këto tekste përfshihen mjaft programe mësimore, abetare, antologji, gramatika, fjalorë, konferenca pedagogjike, libra për lëtërsinë popullore, botime të posaçme për historinë e institucioneve arsimore ndër arbëreshët e Italisë, kërkesa për themelimin e katedrës së gjuhës shqipe dhe shkolla në gjuhën shqipe. Veprimtaria e dendur shkollore atdhetare e De Radës, në lidhje me shkollat shqipe dhe me arsimin tonë kombëtar luajtën një rol me rëndësi në krijimin e një opinionit publik të huaj në favor të Shqipërisë.¹³ Pas publikimit të veprës së parë në 1833 “Odise”, aktiviteti i tij letrar dhe publicistik nuk u ndërpre por vazhdoi më tej me të tjera vepra letrare dhe botime publicistike. Në fund të 1835, De Rada shkon në zyrën e “ Omnibusit”, gazeta e parë letrare që ishte themeluar në Napoli. Aty gjeti në studion e vet drejtorin Vinçens Torelin.

I paraqiti Torelit tre poezi në shqip të cilat evokonin të kaluarën e arbëreshëve. Toreli mjaft entuziast për këtë të ri patriot dhe atdhedashës e priti me admirim dhe entuziazëm takimin me të dhe i botoi vjershat e tij të përkthyer në prozë italishte, në pesë numrat e gazetës. Te “Omnibusi” De Rada botoi këto poezi: “ Për vdekjen e Françesko Panës” patriot arbëresh të cilin De Rada e njihte mjaft mirë. Soneti u botua më 5 prill 1834.

Vepra “Vallja”, e botuar më 2 janar 1836. Kjo odë u përfshi në poemën “Milosao” që u botua në Napoli më

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

1836. “Odë shqiptare”, botuar në 9 janar 1836. “E vërteta”, “poezia “Këngë për vdekjen e Skëndërbeut”, botuar 20 shkurt 1936 etj... Këto krijime poetike, botuar te “Omnibus”, paraqesin interes për brendinë e tyre, sepse japin një pasqyrë të qartë të konceptimit të jetës nga ana e De Radës.¹⁴ Suksesi që pati te organi “Omnibus” e nxiti De Radën të përpunojë veprën “Odisea” të cilën e kishte përpiluar që në Kolegj. Më 1836 botoi veprën e tij të parë të plotë, poemën “Këngët e Milosaos”, me temë të dyfishtë: atdheu dhe dashuria. Poema spikati për bukuri dhe freski, pritet me mjaft ngrohtësi nga kritika dhe publiku, dhe vlersohet më vonë madje dhe jashtë Italisë. Tre vjet më vonë boton një tjetër vepër që ngjason me të parën nga tema dhe problematikat, por kjo vepër ka më tepër qartësi mendimi dhe ngjyrë më të theksuar historike. Vepra “Serafina Topia” botohet në vitin 1840. Kjo vepër ribotohet sërish në 1843 dhe për herë të tretë e riboton në vitin 1898, në fund të jetës së tij, nën një titull të ri “Një pasqyrë jete njëzore”. Në vitin 1848 boton një poemë prej katër novelash me titull “Rrëfime të Arbrit”, novelën “Diana” dhe një tragjedi “Numidët”.¹⁵ Poeti iu përkushtua dhe mbledhjes së këngëve popullore. Ai botoi përmbledhjen e parë me këngë popullore arbëreshe, “Rapsodie di un poema albanese” në vitin 1866.

Më vonë, De Rada riboton në gazetën e vet “Fiamuri Arbërit” me titull “Rapsodi kombëtare”. Edhe “Milosaon” si dhe “Serafinën”, poeti i ribotoi dy herë. Vepra e jetës së De Radës ishte poema e madhe “Skëndërbeu i Pafan”, të cilën e botoi në dymbëdhjetë libra. Nga këto u botuan vetëm pesë. Poema epike kishte në qëndër Skëndërbeun dhe heronj të tjerë, heroikë dhe legjendarë.¹⁶ Krahas botime të përmendura më lart De Rada ka botuar dhe vepra me karakter autobiografik, vepra të cilat meritojnë vëmendje të veçantë. Përmendim 1) Autograf botuar në 1885, 2) Autobiologjia, në katër pjesë (1898-1899), dhe Testamenti poetik (1902).¹⁷ Njohja e krijimtarisë së tij letrare, veprimtarisë shkencore, publicistike, politike dhe arsimore na bën që të njohim më nga afër figurën e De Radës. Le të njihemi pak më nga afër me poemat e tij më të rëndësishme. Më poshtë do të flas për disa nga poemat e tij, me të cilat De Rada la gjurmë në historinë e lëtrësisë shqiptare.

Poema “Këngët e Milosaos”

Më vitin 1836, De Rada botoi veprën e parë të plotë, poemën “Këngët e Milosaos”, me temë të dyfishtë atdheu dhe dashuria. Me këtë vepër poeti godet në shenjë: poema spikati për bukuri dhe freski, pritet me mjaft ngrohtësi nga kritika dhe publiku, dhe do të vlersohet më vonë madje edhe jashtë Italisë.¹⁸ Në kushtim të librit De Rada theksonte se këto këngë do të jenë dëshmi të lidhjeve shpirtërore me zakonet e lashta mes shqiptarëve dhe arbëreshëve kudo të gjindeshin ata.

De Rada, që i ri, çlirimin e atdheut të të parëve e shikon në një bashkëpunim mes të gjithë shqiptarëve, si atyre brenda Shqipërisë dhe atyre të shpërndarë në viset e tjera të botës, sidomos të arbëreshëve të Italisë të cilët kurrë nuk mund të harrojnë atdheun dhe origjinën e tyre.¹⁹ “Këngët e Milosaos” qe sprova e parë e një poeti 22 vjeçar²⁰ dhe ishte një arritje mjeshtrore e poetit. E nis si një poemë dashurie por rrugë gjatë punimit ai sensibilizon njerzit përmes figurës së heroit të tij për të luftuar për çlirimin e atdheut të tyre. Pra poema “Këngët e Milosaos” nuk është cituar thjesht si poemë lirike, por përmes së cilës bën thirrje për bashkim duke na dhënë një pasqyrë të qartë të betejave që po zhvilloheshin në Shkodër kundër osmanëve në vitet 1833-1835. Poema ka një rëndësi të madhe historike sepse me të fillon letërsia artistike, laike, demokratike dhe kombëtare shqiptare. Ajo çfarë e përshkon veprën është karakteri patriotik. Rikrijohet një periudhë e lavdishme e së kaluarës historike të popullit shqiptar. De Rada, poet i ri i kombit shqiptar, ngriti zërin për të ardhmen e Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Përmes figurës së Milosaos bën thirrje për bashkim dhe luftë të përbashkët kundër osmanëve. Kurorëzimi i veprës është vdekja e heroit në fushën e luftës kundër të huajt.

3. Vepra u prit mjaft mirë nga kritika letrare e kohës. Në tetor të 1836, meqënëse në Napoli ra kolera, De Rada rikthehet në Maqë, në katundin e vet, ku qëndroi dy vjet duke studiuar dhe iu përvesh punës që të lëvronte dhe ngrinte lart gjuhën shqipe.²¹

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

Poema “Serafina Topia”

Tre vjet më vonë pas botimit të veprës “Këngët e Milosaos”, botoi një poemë të dytë, që i ngjan nga tema dhe problemet të parës por me një qartësi më të madhe të idesë dhe një ngjyrë më të theksuar historike. Poemën nuk e lënë të shohë dritë në Italinë e Burbonëve (shqetsohen dhe i tremb ideja e një populli që do të ngrihet në luftë).²² Kjo vepër “Këngët e Serafina Topisë”, ka në qëndër tashmë jo në djalë por një vajzë me origjinë fisnike, Serafinën. Poemën “Serafina Topia” poeti nisi ta botojë, së pari si nënftetë te e përkohshmja e Konfortit në Napoli. Më pas poeti arriti ta botojë veprën pavarësisht vështirësive. Në këtë poemë poeti fliste për luftën e drejtë të një populli kundër sundimit të huaj, për luftën e popullit tonë kundër Turqisë në shekullin XV. Poema ishte njëkohësisht një thirrje për bashkim të toskëve dhe të gegëve, në kohën kur ndarja krahinore ishte pengesë për lëvizjen tonë kombëtare. Censura burbone e kuptoi mesa duket këtë vepër si një thirrje për bashkimin e Italisë. Për këtë arsye nuk e la librin të qarkullojë. Poema e Serafina Topias ishte një ekuivalent i Milosaos. Edhe në këtë vepër ajo që mbisundon është ndjenja e patriotizmit dhe e dashurisë për atdheun e shprehur në këtë vepër nga sakrificat e Serafina Topias. Letrat që ai i dërgon të atit, Mikelit, gjatë viteve 1840 dëshmojnë për interesin e madh që ngjalli botimi; se në “Këngët e Serafina Topisë”, të cilat i quante “Këngët shqiptare”, ndihet dashuria për Shqipërinë. Kjo vepër u vlersua për mbajtjen gjallë të traditës arbëreshe në dhe të huaj. Deri më sot njihen katër variante të kësaj vepre. Botimin e parë të një pjesë të kësaj vepre e gjejmë të botuar në 8 tetor 1836 në të përkohshmen “Omnibus”.²³ Varianti më i hershëm i “Serafina Topias” ndodhet në Arkivin e Shtetit. Është i shkruar me dorën e De Radës, mban titullin “Trofat e Serafinës” dhe ka njëzet këngë. Ky version mund të jetë i vitit 1834. Por në lidhje me datën ekzakte të hartimit të poemës “Serafina Topia” janë shprehur mendime kontradiktore. Varianti i dytë dhe i plotë mendohet të ketë përfunduar në 20 shtator 1839. Varianti i tretë i botimit është i vitit 1843. Poema ripërpunohet dhe ribotohet në fund të jetës së poetit në 1898, me titullin “Një pasqyrë jete njerzore”. Në vitet pasuese De Rada tërhiqet pak nga punimet e veprave të mëdha duke u lokalizuar drejt botimeve në gazeta dhe revista të kohës. Shumë artikuj ai i shkruajti në të përkohëshmen “Viaggiatore”²⁴ të Domenico Mauros ku ai shprehu hapur qëllimet dhe idealet e tij patriotike dhe revolucionare. Qëllime të cilat u mundua t’ja trasmetonte lexuesit arbëresh të Kalabrisë. Sipas tij, arbëreshët duhet të organizoheshin në një kryengritje të përbashkët kundër regjimit shtypës së mbretit të Napolit.

Në vitin 1850 ai botoi një përmbledhje me katër poema me titull “Rrëfimet e Arbrit”, më pas novelën “Diana” dhe një tragjedi “Numidët”.²⁵ Tragjedinë “Numidët” poeti e hartoi, së pari në shqip, në dialektin arbëresh, pastaj e përktheu vetë në prozë në italisht, ashtu siç veproji me të gjitha veprat e tij gjatë gjithë jetës së vet. Vepra “Rrëfime të Arbrit” u prit mjaft mirë dhe ngrohtë nga arbëreshët e Italisë. Poema “Rrëfime të Arbrit” përbëhet prej katër këngësh, ndërëlidhet dhe përshkohet nga ideja kryesore që ishte bashkimi i shqiptarëve të shpërndarë dhe lufta e tyre për çlirimin e atdheut. Tre vepra të rëndësishme të De Radës janë Autograf, Autobiologjia dhe Testamenti Politik. Në prill të vitit 1885, Jeronim De Rada shkroi në katundin Maki arbëresh disa shënime në lidhje me jetën e vet. Ato u botuan në 1909, në Trani, në një broshurë 33 faqëshe, me titull : “Një autograf i pabotuar i poetit De Rada përreth jetës së tij. Kur hartoi këto të dhëna poeti ishte 71 vjeç. Autograf hedh dritë mbi fillime e krijimtarisë poetike të De Radës. Në Autograf poeti ka bërë disa shënime kritike për veprat e tij. Autograf i De Radës u botua pas 24 vjetësh të hartimit të tij. Atë e nxori në dritë Dr.Mikel Markiano. Më mirë poetin ne e njohim përmes veprës “Autobiologjia”²⁶ (1898). De Rada përballë akuzave dashakeqëse si mbështetës i Burbonëve del i papërkulur i pasur me një krenari të fortë. Ai qëndroi i patundur në bindjet dhe besimin e tij. Në veprën “Autobiologjia” tregohen ngjatjet e jetës së De Radës nga lindja deri në moshën 34 vjeçare. Ajo është e ndarë në katër periudha, botuar në broshura të veçanta. Periudha e parë dhe e katërt u botuan në 1898, ndërsa periudha e dytë dhe e tretë u botuan më 1899. Autobiografia paraqet interes për të njohur botën shqiptërore dhe jetën plot veprimtari të poetit. Vepra mbeti e papërfunduar sepse mungojnë periudhat e tjera. De Rada ka dashur t’i vazhdojë më tej por fatkeqësitë e jetës nuk e lanë të përpunojë më tej veprën. Vepra e plotë Autobiografia u botua nga De Rada, kur ai ishte plot 85 vjeç. Katër vjet më vonë pas botimit ai u nda nga jeta duke na lënë

Jeronim De Rada, personalitet i Botës Arbëreshe

pas një dokument me shumë rëndësi kryesisht për historinë, letërsinë, folklorin, gazetarinë dhe gjuhësinë shqiptare.²⁷

Skëndërbeu i pafan

Vepra madhore e Jeronim De Radës, për të cilën punoi afro gjysëm shekulli, është “Skëndërbeu i Pafan”. Poema është krijuar nga poeti, brenda një periudhe 42 vjeçare, që nga 1837 deri në 1879. De Rada publikoi nga “Skëndërbeu Pafan”, nga seria e 12 librave, vetëm 5 libra. Synimi i shkrimit të kësaj vepre ishte dashuria e madhe për atdheun e të parëve, Shqipërinë. Përmes kësaj poeme të rëndësishme ai u përpoq të ngrejë lart vlerat e gjuhës shqipe dhe traditave shqiptare duke pasqyruar shirtin patriotik dhe heroik të popullit shqiptar.²⁸ Kjo vepër - thekson De Rada - është shkruar me qëllim që të përgatisë zgjimin e ndërgjegjes kombëtare ; rilindjen e kulturës shqiptare, besimin për të ardhmen e lumtur të ditës së çlirimit. Figura e Skëndërbeut dhe epoka e tij u bënë frymëzim për gjithë letërsinë shqipe.

De Rada ia kushtoi këtë vepër jo bëmave të Skëndërbeut por emrit të tij, heroit kombëtar, heroit të të gjithë shqiptarëve. Te figura e Skëndërbeut ai shihte simbolin e ringjalljes shqiptare.²⁹ De Rada, në poemën “Skëndërbeu i pafan”, krijoi një seri personazhesh, përmes heroizmave të të cilëve u ngjall ndjenja e dashurisë së thellë për atdheun.

(1 - vijon)

Shenime : **1)** P.Scaglione, vep. e cit, f.35; **2)** Kol Kamsi, Shqiptarët e Italisë, Shkodër, 1938, f.11; **3)** G. De Rada, Autobiologia, Cosenza, 1898, f.3; **4)** Revolucionarë italianë kryesisht me origjinë fisnike; **5)** Italia e Re (Giovane Italia) është organizatë revolucionare që krijoi Mazzini në 1833, në Marsejë; **6)** Oreste Camillo Mandalari, Girolamo De Rada precursore della Nuova Albania, Roma, Archivio storico dei reduci di guerra, 1939, f.2; **7)** Jup Kastrati, Jeronim De Rada, (Jeta dhe Veprat), 8 Nëntori, 1987, f.16; **8)** Michele Marchianò, L’Albania nell’opera di Girolamo De Rada, Trani, V.Vechi, 1902, f.20; **9)** Klara Kodra, Erdhi dita e Arbrit (me rastin e 100vjetorit të Jeronim De Radës), Erik, 2000, f.70; **10)** G. De Rada, vep e cit, f.15; **11)** J.Kastrati, vep e cit, f.39; Po aty, f.5; **12)** Po aty, f.8; **13)** Klara Kodra, Fillimet poetike të De Radës dhe poema “Këngët e Milosaos”, “Studime filologjike”, viti XXXII, nr.3, Tiranë 1978, f.72; **14)** K. Kodra, Erdhi dita e Arbrit..., f.72, **15)** Po aty; **16)** G.De.Rada, vep e cit, f.11; **17)** K.Kodra, vep e cit, f.71; **18)** Andrea Varfi, Këngët e Milosaos, Prishtinë: Rilindja, 1976, f.12; **19)** Alessandro Zotos, Jeronim De Rada dhe autorët e tjerë arbëreshë, vep e cit....f.356; **20)** G. De Rada, Autobiologia.... f.17; **21)** K.Kodra, vep e cit, f.71; **22)** Jup Kastrati, vep e cit, f.50; **23)** Po aty, f.52; **24)** K.Kodra, vep e cit, f.72; **25)** J.Kastrati, J.De.Rada, vep e cit, f.20; **26)** Po aty; **27)** E. Demetrio, vep e cit, f.78; **28)** Franco Bulgari, Girolamo De Rada e la letteratura albanese, “Rassegna di studi albanesi” nr.2, fq13, Roma 1963, Atti del 3* Convegno di Studi Albanesi, Cozenza, 23-24 novembre 1963, Edizione Italba; **29)** A.Kondo, vep e cit, f.13.

Ndëse do të kesh
Jeta Arbëreshe
<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

“Telet e Zemrës” i poetit Agostino Giordano**Bajame Hoxha-Çeliku**

ka Lushnja, rron ne Bruksel

Si çdo ditë hyra për të kontrolluar postën elektronike dhe ndër të shumtat letra, gazeta, prozë dhe poezi, hasa në një libër të tërë që e kishte nisur për kënaqësi, vetë autori drejt meje, Buzëdhelprë (Agostino Giordano): “Telet e Zemrës”. Poezi. I lashë të gjitha më një anë, dhe duke më shtyrë kureshtja, me një frymë vendosa të lexoja, e të shihja, se si kishte mundur të derdhte ndjenjat ky profesor Italian, me origjinë të vjetër shqiptare, poezitë në gjuhën shqipe. Vërtet, për këtë dijetar, gjuha shqipe është një gjuhë aq e bukur, e dashur, dhe aq e paharruar për të, sa për të gjithë brezat së bashku e pesë shekujve e gjysmë, që arbëreshët e Italisë lanë tokën mëmë. Jo vetëm që nuk e kanë lënë, e harruar gjuhën, por e duan atë, e kultivojnë dhe, siç thotë vetë autori: “Gjuha shqipe te Arbëreshët e Italisë është adhë e begatë”. Ashtu siç e deshën stërgjyshërit e tyre që lanë Shqipërinë me lot në sy, për arsye gjithnjë që dihen.

Si fillim të një rruge të gjatë letrare, autori ka nisur të botojë poezi në Arbërisht që nga vitet ‘60 të shekullit të shkuar. Pastaj provoi dhe formën e shqipes së sotme dhe ia doli! Përpara kam një përmbledhje me poezi të shkruara nga vitet 70-80, periudhë kjo, e frymëzimit djaloshar të autorit që s’u ndalë më kurrë. Kështu, autori mendoi se do të ishte më mirë të botonte një përmbledhje me poezi të të gjitha viteve së bashku, të cilat kishin mbetur jashtë një libri të duhur. Disa nga këto poezi, janë botuar gjatë viteve, ndër revista e gazeta arbëreshe si dhe ato shqiptare.

Tre vëllime të tjerë i ka botuar: në Arbëri/Itali (Hroaza, 1971), Maqedoni (Hapa mbi kalldrëm, 1976), në Shqipëri (Bota Arbëreshe, 1997).

Nga çdo gazetë, revistë, autori zgjodhi poezi, dhe ia parashtrojë kësaj Përmbledhje, “Telet e zemrës”. Për poetin, Arbëri, Shqipëri, Maqedoni, Kosovë, janë zemra të ndara të Shqipërisë Etnike, të cilat i mungojnë shumë dhe i dhembnin në kraharor pa pushim. Kosova ishte trualli i parë shqiptar që vizitoi në vitin 1976, kur mori pjesë, për herë të parë, në Seminarin Ndërkombëtar për Gjuhë, Letërsi e Kulturë Shqiptare. Një vatër kulture kjo, e rëndësishme për të, e për të gjithë Shqiptarinë. Poeti shkon shpesh në Kosovë për të freskuar shpirtin e për të mbushur mushkëritë me aromë shqiptare. Drejtorja e Seminarit të Prishtinës e nderoi, dy vjet

më parë, me çmimin: “Mirënjohje të veçantë për kontributin e dhënë në fushën e albanologjisë”.

Libri “Telet e Zemrës”

Që në faqen e parë të këtyre poezive më tërhoqi një shqipe e largët, që më dukej se këtë gjuhë e njihja fare mirë dhe ishte arbërishtja e bukur! Me pak fjalë dhe shumë dashuri, kuptova se librin me poezi autori ia ka kushtuar Gruas së tij (e Bijvet të tij):

“Sime shoqe, Terezës
T’mi bilve, Vitorit e Ndonit”

Poezia e Giordanos nis e bukur, emocionuese, domethënëse, plot figura abstrakte dhe situata erotike, dramatike e dialektore. Ne vërejmë që poeti mundohet me çdo kusht të ruajë arbërishten e tij, që e konsideron atë si gjuhë e shqipes së vjetër dhe vjen pranë lexuesit ashtu si i thotë zemra, me të gjithë forcën e shpirtit krijues.

Të gjitha poezitë tingëllojnë bukur në arbërisht se ato të japin flladin e ëmbël të jetës; janë të pasura, poetike dhe të larmishme. Një filozofi dehëse, që mundohesh ta kuptosh me dashuri. Dhe ç’është më e bukura, sa më shumë t’i lexosh të duken se ato mbartin filozofinë vërtet të ndjenjës poetike. Në këtë kontekst poetik gjen një zbrazje ndjenjash djaloshare dhe patriotike, dhe unë, do ta quaja: Poeti i poezisë intelektuale, domethënëse, që ka krijuar art. Një emocion i fuqishëm është metafora sa lozonjare aq dhe e mbushur me thjeshtësinë e njeriut të ditur. Pra, poeti zbret nga lartësitë letrare ku nuk i mungon imagjinata, talenti, dhe vargu tërheqës dhe i pasur, i zërave të mëdhenj të lirikës.

Natën,
mall*,
të gjënj në shtegun e ëndrravet
Ditën
të bier** ndë mes t’gjindve ‘ paëmër

* moj e dashur; **të bjerr

Kjo erotikë është mjaftë e bukur! E arritur dhe domethënëse. Mbart artin e vërtetë. Madje vargjet e

“Telet e Zemrës” i poetit Agostino Giordano

thurura bukur flasin për besnikëri e karakter të fortë:

Det,
mund t’fshehënj një fjalë
te gjiri yt?
Dheu s’e dish
ë’* shumë e tharët
Të taksënj** një gaz vashje
ndë një natë pa hënë

*është, **premtoj

Shumë romantike, ku metafora merr krah fluturimi,
te mrekullueshme! Poeti flet dhe për mikpritjen
shqiptare, për bukën, siç flet në poezi dhe për natyrën

...E shkoi edhe sonde
si dje
si ngaherë
Udha
qëndroi e bardhë
pa një përgjegjje
Gurët
u pyjetin
pse i shkelja ngadita
Tryesa
më dha ende
një bukë pa kripë

Si çdo poet, i ndjeshëm romantik, i këndon bukur
dhe së dashurës, dashurisë së tij, mallit të fortë që i
prek telat e zemrës. Këto imazhe shpirtërore të
kënaqin dhe sidomos kur shkon te poezitë abstrakte.

Mendoj se kështu arrin të depërtojë thellë në
ndjesitë e telave të zemrës dhe te lexuesi. Këtë poezi
që do të vijoj (Mëmës) do ta quaja një perlë! E arritur
përsosmërisht!

Do të dija sa herë qajte
e sa herë i fshijte lotë të tjerëve
sa herë qeshe
e sa herë gëzove të tjerë
sa herë na ndëleve*
e sa herë lute për ne

*fale

Te kjo tjetra (Atit tim) s’ka vend për koment! Sepse
e ka përsosur poeti. Ose:

...e unë te zëmra jote
kam rrënjët e menatës*

*së nesërme

Në poezitë e poetit Agostino Giordano, nuk ka vend
për më tepër sepse të gjitha vargjet janë gdhendur në
piedestal! E kështu, nuk duhet hequr me ngacmime
aromën e bukur të këtij lulëzimi poetik.

Poezi të fuqishme! Ku arrita në konkluzion:

Çdo fjalë, kishte një kuptim të thellë
Çdo frazë, të trokiste në zemër
Çdo strofë, të ushqente shpirtin
Çdo poezi, kishte fuqinë e dashurisë!

Djovas Jeta Arbëreshe

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Melodi që kumbojnë mbi “Tela Zemre”

prof. dr. Klara Kodra

Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Stina bashkëkohore e poezisë arbëreshe është një stinë lirike.

Lirizmi ka qenë një tipar që e ka dalluar letërsinë e arbëreshëve të Italisë që në fillimet e saj, po që ka mbetur si nënshtresë e kësaj poezie, i sfiduar dhe i mbuluar nga synimi për epos. Në kohën e sotme rryma lirike rrjedh e lirë dhe shpërthyes në letërsinë arbëreshe ku ndërthuren një realizëm i trashëguar nga tradita me modernizmin dhe pasmodernizmin.

Poezia e sotme arbëreshe synon nga një anë të afrohet me poezinë e tokës mëmë, Shqipërinë, nga ana tjetër me poezinë e vendlindjes, Italisë.

Dihet se poezia bashkëkohore shqiptare e sapodalë nga tuneli i diktaturës, ka arritur midis vonesave dhe “djegies së etapave”, në brigjet e modernizmit dhe pasmodernizmit, ndërsa poezia italiane, e prirur nga pasmodernizmi, rijeton edhe një kthim te realizmi.

Poezia e Buzëdhelprit (Agostin Jordanit) është poezi realiste, e një realizmi të ri të ndërthurrur me modernizmin, është një poezi mendimi që ndërthuret me poezinë e ndjenjës e trashëguar nga romantizmi.

Kuptimplotë është titulli i vëllimit të ri të Agostin Jordanit “Telet e zemrës” të botuar në Pri-shtinë.

Dhe akoma më kuptimplotë është fakti se vëllimet e këtij poeti kanë parë dritë në katër vende të ndryshëm, po që janë vatra të frymës shqiptare. Përveç Shqipërisë mëmë, ku ai botoi “Botën Arbëreshe” (1997), poezitë e tjera ai i botoi në ato që i quan “zemra të ndara të Shqipërisë etnike”, në “Arbërinë” e Italisë (“Hroaza”, 1971), në Maqedoni (Hapa mbi kalldrëm, 1976), dhe, së fundi, në Kosovë ku ai, si thonë në parathënie, ka vajtur të mbushë “mushkëritë me erë shqiptare”.

Poeti mendon se shumica e vjershave të këtij vëllimi i përkasin “periudhës së tij më të frymëzuar”, viteve 70-80, pra, janë “fëmijët kanakarë” të penës së tij.

Në këtë vëllim, tok me vjershat më të reja, gjejmë edhe vjersha nga më të mirat e krijimtarisë së mëparshme të këtij autori.

Agostin Jordani ka thithur nga tradita e poezisë romantike arbëreshe që ka rrezatuar “energjia romantike” mbi krijimtarinë e tij kultin e gjuhës dhe të shqiptarësisë. Jo më kot në rrembat e tij rrjedh gjaku i një poeti romantik arbëresh, Bernard Bilotës. Po ndërsa Bernardi qe poet epik që synonte një hapësirë të madhe për vargjet e veta, Agostini është poet lirik që synon një konçizitet dhe shkurtësi maksimale, siç shihet nga pjesa më e madhe e vjershave të tij që u ngjajnë vetëtimave (më të shkurtërat përmbliohen në tre vargje si “Nëng sosën grusht”, “Nëng folën sonde”, “Çastet e mallit”, “Fjalët e sheshit”, “Për vëllezërit shqiptarë” ose arrijnë në dy vargje si “Në tregun e gazeve”.

Poeti zbulon bukurinë dhe pasurinë e leksikut të arbërishtes, një dialekti të lashtë që është megjithatë rrëmb i shqipes.

Në poezinë e tij gjejmë fjalë-çelës me shije biblike si buka dhe vera, që janë elemente të një pejsazhi shqiptaro-arbëresh si rrushi, të natyrshme si bora, era, universale si loti.

Tërë poezinë e tij e mbështjell dashuria: dashuria për vashën, për prindërit, për vëllezërit shqiptarë, për njerëzit e punës.

Poeti u këndon në mënyrën e vet vlerave të përvetshme si familja dhe dashuria. Sa të veçanta

Melodi që kumbojnë mbi “Tela Zemre”

janë vjershat në të cilat Agostin Jordani u këndon prindërve të vet (“Atit tim”, “Sytë e prindëvet”, “Mëmës”)!

Poeti di t’i japë ngjyrë vetiake një teme universale!

Sa i freskët, i veçantë dhe fin është krahasimi që gjen poeti për borën! (Bie e qetme/ si mëmë që lan liveret/ natën/ e ndën vesh/ ngaçik/ ndë biltë vo fjanë). Ky ballafaqim i dukurive të natyrës me njeriun që mishëron bukurinë më të madhe bën pjesë në trashëgiminë deradiane të cilën Jordani e ka shkruar në poezinë e vet, duke mbetur megjithatë vetvetja, një poet që nuk i objektivizon ndjenjat e veta si poeti i Maqit, po i shpreh hapur.

Jordani i këndon në mënyrën e vet edhe dashurisë, me një thjeshtësi prekëse, pa idealizime, po me një ndjenjë të thellë (Më pëlqen ngaherë/ edhe kur thua se s’je e bukur/ Të kuptonj ngaherë/ edhe kur t’duket se s’të gjegjën/ Të vërenj ngaherë/ edhe kur thua se ruanj gjetkë). Në leksikun poetik të Jordanit zenë vend edhe figura të frymëzuara nga bota moderne. Të tilla janë metaforat dygjimtyrëshe që gjejmë te “Pika shiu”:

Janë autostradat e dimrit

Ku im bir shtyn makinën e mendimeve.

Një figurë e fuqishme kozmike është edhe “përqaftimi i errësirës” në vjershën anonime ku poeti zbulon brishtësinë e vet të brendshme që plotëson stoicizmin që i dallon vjershat e tjera në të cilat heroi lirik e pranon jetën si është me gëzimet dhe dhimbjet e veta.

Po poezia e Jordanit s’është veçse një poezi imazhesh, po edhe një poezi detajesh. Poeti me syrin e mprehtë zbulon edhe detaje shprehëse të jetës së përditshme. Të paharrueshme janë duart e plakut në vjershën “Dy duar të shëndoshta”: Dy duar të dridhshme/ ç’i tremben syut t’jatroit/ po i hapën të shëndoshta/ nipit që do të luanj”.

Një veçori interesante e vjershave të Jordanit është fakti se shumë nga titujt e vjershave janë fjali të plota (“Shkuan shumë vjet”, “Kur ti qeshën, mëmë”, “Nesër niset treni im”, “Do të priresh edhe sonde”, “Gjithë lumi një shpi”, “Vetë tue kërkuar njerin”).

Buzëdhelprit di të zbulojë poezinë e së zakonshmes. Ai parapëlqen vargun e lirë, ndofta ngaqë s’do ta stolisë me gjerdane rimash, ndofta për t’i qëndruar besnik poezisë popullore tradicionale arbëreshe me vargun e bardhë, po vargu i tij është më tepër se i bardhë, është i lirë. Ndër vargjet poeti zgjedh vargun e shkurtër si psherëtimë a gulçim.

Do ta mbyllja këtë shkrim me një thënie të Pol Vakrisë “Pjelloria e vërtetë e poetit nuk qëndron në numrin e vargjeve të tij, po në shtrirjen e efektit të këtyre vargjeve”.

Vargjet e Buzëdhelprit si jehonë do të mbeten gjatë në mendje e në zemër.

Shkarko
Jeta Arbëreshe

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Agostino Giordano: un poeta vero

Pierfranco Bruni

ka Sullarenxa (Cs)

La poesia è un ancestrale silenzio. Il silenzio cammina nelle parole. Tra le parole. È vita. Io ho sempre creduto, ed ora sono convinto, che la poesia che si legge in traduzione non può essere scalfita dallo studio sul linguaggio. Quando si tratta di vera poesia.

Un arricchimento in più si ha quando la poesia tradotta viene tradotta dallo stesso poeta. Ovvero non si consuma il raccordo, al quale io non ho mai dato importanza, tradurre uguale tradire.

Allora. Partendo dal presupposto che la poesia non ha mai bisogno di accademie, di giustificazioni, di spiegazioni, sottolineo, con la consapevolezza della mia esperienza e del mio mestiere, che con Agostino Giordano e la sua poesia ci troviamo davanti ad una visione di una poetica dello spazio e del tempo in un articolato sentiero in cui le lingue, quella albanese, quella arbreshe e quella italiana, sono il sostrato di una eredità non solo letteraria ma anche esistenziale. Agostino Giordano è un poeta vero.

È il più originale poeta di una generazione che ha intrecciato la cultura arbreshe con le koinè albanesi. Nel contesto Italo-albanese è il più importante poeta.

La sua caratteristica consiste non soltanto nelle articolazioni semantiche, elementi principe dei processi linguistici tra la lingua albanese e quella arbreshe, quanto nella tessitura tematica.

L'infanzia, il paese, l'amore sono un frammentare nella conquista di un "ermetico" sentiero di un incontro tra l'essere stato e lo status di un tempo incancellabile.

È chiaro che in Agostino Giordano non c'è soltanto una formazione letteraria proveniente dalla tradizione albanofana. C'è lo studioso e il conoscitore della letteratura italiana ed europea del Novecento. Nella sua poesia il verso tagliato, o breve, ha un inciso quasimodiano e in parte ungarettiano. Ma la originalità di Giordano è quella di aver saputo superare gli intrecci degli stilemi che hanno intrecciato la poesia Italo - albanese degli ultimi cinquanta anni. È grande poesia. Lo dico con forza, ma anche con quella conoscenza critica che mi permette di andare anche oltre la stessa analisi del testo.

Poesia nella poetica. Poetica tra i dettagli di esistenza. Finalmente Agostino Giordano ci porta verso una poesia vera, forte, bella, elegante, scritta da un arbresh e tradotta in italiano da un arbresh.

Djovas e Shprish **JETA ARBËRESHE**

e vetmja rivistë arbëreshe
gjashtëmujore on-line
vërtet dygjuhësh

<http://digilander.libero.it/jetarbreshe>

Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

don Lush Gjergji

Vikar Gjeneral i Ipeshkëvisë së Kosovës, Prishtinë

1. Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

Papa Gjon Pali II kishte njohuri, nderim, mbi të gjitha dashuri dhe mirëkuptim për popullin shqiptar duke i falënderuar para së gjithash Nënë Tereze.

Ja dëshmia konkrete: Më 2 shkurt 1981 ishim në audiencë private te Papa Gjon Pali II së bashku me Imzot Nikë Prelan (1918-1996), ipeshkvin e Kosovës. Në mbarim të takimit Papa na tha: *“Unë, pas popullit tim polak, më së tepërmi e dua Popullin Shqiptar, sepse, së pari, keni vuajtur tepër gjatë e tepër shumë dhe padrejtësisht, dhe së dyti, sepse na keni dhuruar Nënë Tereze”*.

Imzot Nikë Prela pas këtij takimi me Papën Gjon Pali II tha: *“Papa më priti përzemërsisht... Gjatë bisedës ai tregoi ndaj nesh një mirëkuptim të madh... Ai interesohet fare mirë për popullin tonë, gjë që tregoi shumë herë edhe botërisht në raste të ndryshme”*.¹

Kjo nuk ishte vetëm fjalë apo emocion i përkohshëm, por qëndrim dhe vlerësim, të cilin Papa e ka dëshmuar gjithnjë.

T'i përkujtojmë vetëm disa hapa dhe veprime konkrete:

Në vitin 1980 Gjon Pali II në Otranto të Italisë, pjesa më e afërt bregdetare me Shqipërinë, mbajti një fjalim të përmallshëm për Shqipërinë dhe Shqiptarët, duke nënvizuar vlerat dhe cilësitë e lashta dhe të larta dhe duke uruar ditë më të mira, paqe, liri dhe demokraci.

Në vitin 1984 Papa e vizitoi Barin e Italisë dhe ndër të tjera pati thenë: *“Prej këtij qyteti mendimi im është drejtuar poashtu kah Vëllazërit dhe Motrat të Shqipërisë, të cilët s'kanë mundësi që botërisht ta tregojnë fenë e tyre, që është e drejta themelore e njeriut. Ndërsa u porosis të luteni për ta, dëshiroj t'iu them se ata janë posaçërisht të pranishëm në zemrën time...”*.²

Më 27 prill 1986 Papa Gjon Pali II u takua me një grup besimtarësh shqiptarë katolikë që jetojnë në Romë. Me atë rast Papa iu drejtua atyre me një fjalim të preکشëm dhe plot shpresë. Ja, fjalja e Papës: *“Ky takim, i pari në Romë me bashkësinë e Shqiptarëve, më prek thellë në zemër. S'është fjala për një ngashërim rasti: them se fjala është për një përmallim të vazhdueshëm. për çdo ditë, sidomos gjatë Meshës shenjte, kërkoj të jetoj martirizimin e Popullit tuaj, të Besimtarëve tuaj, të Vëllazërve dhe Motrave tuaja Shqiptare, dhe lutëm për çdo ditë për Atdheun tuaj, për të gjithë Besimtarët e feve të ndryshme, si edhe për Kishën në Shqipëri, e cila është zhdukur sa i përket dukjes së jashtme. por e dini mirë se Kisha s'mund të zhduket nga zemrat, sepse është ndërtuar prej Shpirtit Shenjt, prej Fjalës së Krishtit, prej premtimit të Krishtit i cili gjallëron në zemrat e fetarëve. Unë bashkë me ju besoj thellë se Krishti jeton, se jeton këtu në Romë, në bashkësinë shqiptare romake, jeton edhe në Vëllazërit tonë të martirizuar të Atdheut tuaj...”*

S'mund të mbytet njeriu që e ka fenë e gjallë...Kjo është shpresa jonë...Nëse në jetën e njeriut mbytet Zoti, mbytet edhe njeriu... Fjalët e mia janë të papërshtatshme, por përmallimi im është shumë më i thellë, sepse përjetoj dhe i ndaj përzemërsisht dhe thellësisht këto vuajtje tejet të mëdha me Vëllazërit dhe Motrat Shqiptare... Me këtë lutje dëshirojmë t'ju japim pak ngushëllim shpirtëror”.³

Më 6 maj 1988 Papa Gjon Pali II pati në audiencë një grup besimtarësh katolikë shqiptarë nga Shba-ja dhe prej disa vendeve të Evropës. Ai në këtë rast ndër të tjera tha: *“Të dashur vëllazër dhe motra, me gëzim ju përshendes, të dashur Bij e Bija Shqiptare, që keni ardhur këtu nga shumë vende të Evropës e nga Amerika, me rastin e Vitit të Marisë. Gjatë shtekimit tuaj në Shenjtëroren e Gjenacanit, ku sipas traditës nderohet figurja e Zonjës së Shkodrës, pajtores së Shqipërisë... Vërtet, mirë se vini! Ky takim i mbush zemrat tona me mallëngjim. Shoh në fytyrat tuaja krenarinë e lashtë shqiptare, por shoh edhe mallin për Atdheun tuaj, Tokën Shqiptare, popull ky shumë bujar dhe me kujtime të lashta historike, traditë të lavdishme e luftë të gjatë për liri. Këtë vend, gjeografikisht kaq afër, e kam posaçërisht në zemër. E, si mos të jetë kështu, pasi atje ruhet kujtimi i pranisë së Apostujve Ndreut dhe Palit, qysh nga fillimi i apostullimit në Durrës, selia e parë ipeshkvore, martirizimi i Shën Astitit, e pastaj gjatë shekujve, një varg Martirësh e Martirësh”*

Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

Si mos ta kemi dashurinë e veçantë ndaj një Populli, bashkësia katolike e të cilit i ka mbetur besnike Selisë Apostolike dhe në rrethana më të vështira e të dhunshme?

E njoh historinë tuaj, shpeshherë të shkruar me gjak. E di se me arsye mbaheni krenarë për ligjet e traditat tuaja bujare...me zemër plot shpresë, së bashku me ju, se Kisha dymijëvjeçare, e rrënjësuar në Tokën Shqiptare, do të ketë Liri të plotë për të vijuar të jetë element afrimi kombëtar, bashkimi e paqeje në zemër të Popullit Tuaj”.⁴

Më 29 mars 1989, pas ngjarjeve të përgjakshme në Kosovë, Papa Gjon Pali II në audiencën e rëndomtë të së mërkures, foli ndër të tjera edhe për gjendjen në Kosovë dhe tha: *“U thërras të gjithë të pranishmit që në uratat tuaja ta kujtoni edhe një vend kaq të afërt,/ që është vendi i dashur jugosllav, (mendohet për Kosovën, vr. e redaksis)/, prej nga këto ditë na vijnë lajmet mbi konfliktet që shkaktuan pikëllim dhe vuajtje shumë familjeve”.*⁵

Prej vitit 1981, sidomos pas vitit 1989 e deri në luftë (1999), Papa Gjon Pali II personalisht, si dhe Shteti i Vatikanit, ka përcjellë, përkrah dhe ndikuar te të gjitha institucionet ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Nëpërmjet Sekretarisë së Shtetit të Vatikanit të gjitha Nunciaturat Apostolike të Selisë së Shenjtë (ambasadat e Vatikanit nëpër botë), kanë qenë në shërbim të çështjes tonë.

Ja vetëm disa intervenime të përzemërta, të vendosura dhe personale të Papës Gjon Pali II lidhur me **Kosovën**: *“Gjatë kësaj kohe jemi të brengosur thellë lidhur me situatën kritike që është zhvilluar në Kosovë, ku shpërthimet e dhunës edhe një herë kërcenojnë përpjekjet për dialog dhe paqe...”.*⁶

*“Jo larg nesh, në Kosovë, vendimet e dhunshme, represionet dhe arratisjet e komuniteteve nuk mund të lënë joaktiv komunitetin ndërkombëtar. Këto episode rikujtojnë historinë tragjike të Ballkanit...”.*⁷

*“Jam duke menduar veçanërisht në banorët e Kosovës që kanë rënë viktimë e dhunës së armatosur dhe gjendja e të cilëve është duke u bërë shumë më dramatike...”.*⁸

*“Jam duke menduar për Kosovën, jo larg nga këtu, ku për një kohë të gjatë popullata të tëra pësuan mizori dhe tortura në emër të rivaliteteve të pakuptimta etnike...”.*⁹

*“Tragjedia e Kosovës, ku amiqësitë shpërthyen në Natën e Kërshëndellave, është gjithnjë e pranishme në zemrën time...”.*¹⁰

*“I pikëlluar thellësisht nga situata e keqësuar në regionin e Kosovës, unë dua të shpreh afërsinë time atërore për të gjithë ata që janë sprovuar nga ngjarjet e fundit tragjike...”.*¹¹

*“Tani do të dëshiroja që t’i ofrojmë një lutje të veçantë Atit të Mëshirës që të dhurojë dhuntinë e paqes, për të cilën Kosova dhe Evropa, në veçanti kanë aq shumë nevojë sot”.*¹²

*“Këtu do të kisha dashur të përmend luftën që është duke u zhvilluar para dymijëvjeçare, në Kosovë, e cila është duke lënduar Evropën si tërësi...”.*¹³

*“Krishti është “përbuzur dhe refuzuar” në ata të sharë dhe të vlarë në luftën e Kosovës...”.*¹⁴

*“Nga Zoti i ringjallur unë lutem për dhuratën e çmuar të lirisë, mbi të gjitha për tokën e shkatërruar të Kosovës, ku lotët dhe gjaku vazhdojnë të përzihen në shfaqjen tragjike të urrejtjes dhe dhunës. Unë mendoj për ata që janë të vlarë, për ata që janë të pastrehë, për ata që janë ndarë nga familjet e tyre, për ata që janë detyruar të largohen...”.*¹⁵

Imzot Nikë Prela po ashtu prej vitit 1981 e deri në kalim në amshim e ka informuar Papën Gjon Pali II mbi gjendjen në Kosovë, si dhe të gjitha institucionet fetare dhe shtetërore botërore. Po e përkujtoj me shumë mall takimin e tyre të fundit më 17 tetor 1995, në Vatikan, kur Papa i kishte ftuar të gjithë ipeshkvijtë e ish-Jugosllavisë, për të shqyrtuar çështjet e rëndësishme fetare, kulturore, shpirtërore, politike, ekonomike dhe shoqërore.

Imzot Nikë Prela ishte në karrocë dhe pa këmbë, pa shëndet, por me shumë vullnet dhe zemër të madhe. Papa Gjon Pali II ishte dukshëm i emocionuar. U ndal, e përqafoi vëllazërisht, i lartësoi duart kah qielli dhe para të gjithëve tha: *“Kosova – Plaga dhe Shpresa jonë”.*

Edhe gjatë drekës krentore me më se dhjetë kardinaj, ndër të cilët ishin edhe Kardinal Franjo Kuhariqi, arqipeshvi i Zagrebit, Kardinal Vinko Puljiqi, arqipeshvi i Sarajevës, Papa tha para të gjithëve:

Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

“Sot kemi një rast të veçantë që të dëgjojmë drejtpërdrejt për Kosovën. Pra, lusim Imzot Nikë Prelën dhe bashkëpunëtorin e tij që të na tregojnë më hollësisht çka ngjan tani në Kosovë”.

Me atë rast Ipeshkvi ynë me pak fjalë të zgjedhura e paraqiti gjendjen tonë duke thenë : *“Kosova është ndërgjegjja e njerëzimit, sepse aty shkelen të gjitha të drejtat themelore të njeriut, por edhe ato kombëtare dhe fetare...”*.

Pastaj gjatë tërës drekës e punës vazhdova paraqitjen e gjendjes sonë, me shumë pyetje, interesime dhe përkrahje të të gjithë të pranishmëve. Papa Gjon Pali II ishte aq mirë i informuar për të gjitha, sa që shumë ipeshkvij, ndër të cilët edhe ata të diplomacisë së Vatikanit, në krye me Kardinal Angelo Sodano, mbeten të habitur.

Papa në mbarim ndër të tjera tha: “Shkëlqesi, të keni zemër dhe guxim, vetëm vazhdoni strategjinë tuaj të mirëfilltë. Zoti është me Ju...Ne jemi me ju dhe me Popullin tuaj...Kosova është varri dhe shpresa jonë” (duke menduar në vdekjen dhe ngjalljen e Jezu Krishtit, vr. ime; shënimi nga ditari im).

Nëna Tereze gjithnjë i thoshte Papës, por edhe të tjerëve, sidomos Bill Clintonit, Kofi Ananit... që të bëjnë gjithçka për shpëtimin e Kosovës, për Popullin Shqiptar. Këtë e vërtetoi edhe Bill Klintoni, gjatë vizitës së varrit të Nënës Tereze në Kalkutë, duke thenë:

“Unë e kam kryer amanetin, premtimin dhënë Nënës Tereze për Kosovën. Tani Ju luta që të ndërmjetësojë te Zoti për mua, për familjen time, për Amerikën dhe botën mbarë”.

Këtë e dëshmoi edhe Bernard Kushneri, ish-kryeadministratori i Kosovës, i cili publikisht pati thënë kështu: *“Sa isha funksioner i OKB-së, themelues dhe organizator i “Mjekëve pa kufi” me Nënë Tereze jam takuar disa herë. Ajo më tha: “Ju duhet të bëni diçka për popullin tim Shqiptar, për Kosovën. Atje ndodhin gjëra të tmerrshme...”*. Kush ka menduar që një ditë unë do të bëhem Kryeadministrator i Kosovës?” (Nga fjala e rastit në vitin 2000 për Akademinë e SHHB “Nëna Tereze”, Prishtinë, 10 maj 2000).

Këtë e ka vërtetuar edhe Sekretari i Përgjithshëm i Okb-së Kofi Anani duke përkujtuar këto ditë Papën Gjon Pali II: *“Kujtoj me dashuri takimet e mia me të, në veçanti në residencën e tij private, duke diskutuar rreth çështjeve të luftës dhe të paqes, në veçanti atëherë kur mendonim se si duhej vepruar në Kosovë”.*

Papa Gjon Pali II e vizitoi Shqipërinë më 25 prill 1993, shtetin e parë ballkanik, dhe me atë rast shuguroi katër ipeshkvinj, përtriri hirearkinë kishtarë në Shqipëri. Ai në të gjitha fjalimet e lartësoi para Evropës dhe botës historinë, traditën, kulturën, tolerancën dhe vëllazërinë gjithëshqiptare, si shembull për tolerancë fetare, për ekumenizëm, për dialog ndërfetar dhe bashkëjetesë paqësore dhe jodhunore për të gjithë.

Imzot Ivan Dias, Nunci Apostolik i atëhershëm në Shqipëri, tani kardinal, për këtë vizitë shkruan kështu: *“E bekuar, sepse takoi Kombin fisnik që i ka dhuruar botës “gruan sa të vogël me shtat, aq të madhe me vepra”, Nënë Terezën e Kalkutës. E së fundi, kjo ditë ishte e bekuar, sepse nxori në pah pasurinë e ndjenjave e të traditave të vjetra të popullit shqiptar si : mikpritja, burrëria e besa”*.¹⁶

Ja si e ka komentuar këtë pasi baritore Don David Xhuxha, drejtori i Seksionit Shqip të Radio Vatikanit: *“Në fillim dhe në mbarim të katër fjalimeve të tij, të përgatitur me urtësi, Ati i Shenjtë foli shqip: shqip përshëndeti popullin, shqip iu lut Zotit, shqip kërkoi ndërmjetësimin e Zojës së Këshillit të Mirë /Pajtores së mbarë popullit shqiptar/ për përparimin e vendit dhe në gjuhën shqipe e bekoji popullin e martirizuar, por fisnik shqiptar në tokën e vet të lavdishme”*.¹⁷

Në vitin 1994 Gjon Pali II e emroi Dom Mikel Koliqin kardinal të Kishës Katolike, simbolin e të gjitha martirizimeve të lashta dhe të afërta të Kishës dhe të popullit shqiptar, *“për dëshmi të guximshme besnikërie ndaj Krishtit, duke përballuar vuajtjet e tmerrshme të shkaktuara nga persekutimi i ashpër që shpërtheu prej regjimit totalitar... Pas dimrit të ashpër të kundërshtimit të dhunshëm, Kisha Shqiptare, së bashku me Ju mund të shohë sot me shpresë të ardhmen...”*.¹⁸

Nëpërmjet Nënës Tereze dhe Papës Gjon Pali II çështja e Kosovës, si dhe ajo e shqiptarëve në përgjithësi, është ndërkombëtarizuar dhe sensibilizuar dukshëm, sidomos të Bill Clintoni, por edhe te Kofi Anani, Bleri, Dalema, Shiraku, Shroderi dhe shumë të tjerë, dhe kështu ajo u bë “pyetje e ndërgjegjes së njerëzimit”.

Dhe ndodhi nrekullia, ndërhyri bota për shpëtimin tonë. Kjo do t'ishte e pakuptueshme, e pashpjegueshme

Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

dhe e pamundshme pa ndikimin vendimtar të Nënës Tereze dhe të Papës Gjon Pali II.¹⁹

Mos ta harrojmë edhe lumturimin e Nënës Tereze (19 tetor 2003), nderin e Kishës dhe të popullit Shqiptar, bijën dhe motrën tonë, Nënë e mbarë njerëzimit, ku delegacioni dhe shtegtarët nga Kosova ishin më së afërmi Papës Gjon Palit II me dëshirë dhe kërkesë të tij.

Me një fjalë, po të kishte qenë Gjon Pali II shqiptar, s'di çka do të kishte bërë më tepër për ne. Këtë duhet ta dimë të gjithë e mos ta harrojmë, sepse ia kemi borxh, së pari të madhit Zot, Papës Gjon Palit II, së Lumes Nënës Tereze, botës, si dhe gjakut të bijëve dhe të bijave tona.

2. Papa Gjon Pali II dhe e lumja Nëna Tereze

Njerëzit e mëdhenj të Zotit fill njihen dhe bashkëpunojnë me njëri - tjetrin, sepse janë të Zotit dhe të Popullit, kanë një burim dhe frymëzim të përbashkët, Zotin dashuri dhe Vëllaun njeri.

Ja vetëm disa pika të përbashkëta dhe bashkëpunimi mes Papës Gjon Pali II dhe Nënës Tereze.

Nëna Tereze para se ta pranonte Shpërblimin Nobel për Paqe, ndër të tjera u këshillua edhe me Papën Gjon Pali II, i cili i pati thënë kështu: *“Pranoje këtë Shpërblim dhe nderim të madh në emër të Zotit dhe të varfërve të mbarë botës, të cilëve Ti kaq shumë iu ndihmon dhe u shërben”* (nga rrëfimi gojor i Nënës Tereze, shkëputur në ditarin tim).

Fjala e parë e Nënës Tereze në aeroportin e Oslos ishte: *“E pranoj këtë Shpërblim në emër të Zotit dhe të varfërve të botës...”*²⁰

Pas pranimit të Çmimit Nobel për Paqe (Oslo 10 dhjetor 1979), Nëna Tereze e vizitoi në Romë Papën Gjon Pali II. Pas urimit dhe bisedimit të përzemërt me të, Nëna Tereze i tha Papës: *“Kam vendosur të tërhiqem nga jeta botore (publike). Do t'ju kthehem të varfërve dhe të gërbulurve...”*.

Papa, pasi e dëgjoi me vëmendje dhe me dashuri, i tha: *“Kurrsesi, sepse Ti je dëshmitarja më bindëse e Ungjillit dhe e Dashurisë së Zotit për çdo njeri. Të lutëm që të shkosh kudo që të thërrasin nëpër botë...”*. Dhe Nëna Tereze aty për aty e ndërroi mendimin, qëndrimin dhe vendimin e saj. Duke komentuar këtë më tha: *“Nuk pata tjetër zgjidhje. Fjala e Papës për mua është urdhër, është vullneti i Zotit”* (nga ditari im).

Së bashku me Papën Gjon Pali II, Nëna Tereze ishte shtegtarja e paqes dhe e dashurisë në mbarë botën, duke tejkaluar të gjithë kufinjët, ndarjet, përçarjet, dallimet, për ta dëshmuar fuqinë e së vërtetës dhe të dashurisë.

Në vitin 1980 Papa Gjon Pali II e ftoi Nënë Tereze në Romë dhe ia dhuroi çelësin e shtëpisë për fëmijë dhe nëna të braktisura.²¹

Papa Gjon Pali II nuk u ndal me kaq, sepse dëshironte ta kishte Nënë Tereze sa më afër, në Vatikan. Mu për këtë vendosi t'ia dhurojë një shtëpi strehimore në Vatikan, pranë Sallës së Audiençave “Pali VI”, si mirënjohje dhe përkrahje personale. Kjo shtëpi quhet “Dono di Maria” (Dhurata e Marisë), dhe është një ndër qendrat e rëndësishme të “Misionareve të Dashurisë” në botë.²²

Gjatë vizitës së Papës Gjon Pali II në Indi, ishin së bashku si **“dueti” i fesë dhe i dashurisë së krishterë**. Gjatë kthimit në Vatikan gazetari italian Renato Farina ndër të tjera e pyeti Papën: *“Si keni qëndruar kaq shumë gjatë këtyre ditëve të vizitës në Indi? Ne si gazetarë ishim të lodhur duke përcjellur vizitën Tuaj. Ku është burimi i gjithë kësaj fuqie?”*.

Papa u përgjigj me buzëqeshje kështu: *“Kjo nuk është vepra ime, por e Zotit... Kjo vizitë baritore ishte më e lehta, sepse afër meje, me mua ishte Nëna Tereze e Kalkutës. Mjaftonte që me gisht ta tregoja atë, dhe të gjithë e kuptonin shumë mirë dhe me pak fjalë porosinë e Krishtit, të Kishës Katolike, të Krishtërit. Ajo është dëshmitarja burimore e jetës dhe e fesë së krishterë”*.²³

Më 13 janar 1989, së bashku me Imzot Nikë Prelën dhe me shumë ipeshkvij nga ish-Jugosllavia, bashkëmeshuam me Papën Gjon Palin II. Pas meshës vijoi takimi dhe biseda me të.

Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

Unë me atë rast ia dhurova dy libra të mia në gjuhën italiane kushtuar Nënës Tereze:

Madre Teresa, prima biografia completa, Jaca Book, Milano, 1983;

Madre Teresa e le sue radici, Emi-Piemme, 1987, me këtë përkushtim:

“Papës Gjon Palit II, Mikut të madh të Nënës Tereze dhe të Popullit Shqiptar:

SHENJTËRI, këtë monografi e kemi botuar me rastin e 75-vjetorit të lindjes së Nënës Tereze, ku janë të pranishëm më se 175 autorë shqiptarë: poezi, prozë, pikturë, skulpturë dhe muzikë (katolikë, ortodoksë dhe myslimanë)”.

Papa më tha: *“Mirë, tejet mirë, sepse ajo është shqiptare. Keni bërë shumë mirë që e keni botuar një libër kaq të pasur dhe tejet të bukur. Ajo ka lindur në Shkup. Por me prejardhje ishte nga Prizreni, shqiptare, zemra e popullit tuaj, e mbarë Kishës. Kështu kultivohet dialogu, bashkëpunimi dhe bashkëjetesa mes popujve dhe feve. Urime dhe vetëm përpara!”.*²⁴

Gjatë vizitës së papës Gjon Pali II Shqipërisë, në Shkodër, ai tha për Nënë Tereze kështu:

“Të dashur, nuk mund mos ta përshëndes një njeri fort të përvuajtur, që ndodhet mes nesh. Është Nënë Tereza e Kalkutës. Të gjithë e dini nga vjen, cili është Atdheu i saj. Atdheu i saj është këtu. Edhe në kohët e izolimit të plotë të Shqipërisë ishte kjo rregulltare e përvuajtur, kjo shërbyese e përvuajtur e më të varfërve, që përçonte në tërë botën emrin e Atdheut tuaj. Në personin e Nënës Tereze Shqipëria është nderuar gjithmonë. Është ky misioni i saj dhe i të gjithë atyre që, pors i ajo, janë ndjekës të vërtetë të Krishtit, apostuj të dashurisë e të dhembshurisë.

*Ju falënderoj sot në emër të Kishës Katolike, ju falënderoj, të dashur shqiptarë, për këtë Bijë të tokës suaj, të Popullit tuaj...”.*²⁵

Papa në Tiranë për Nënë Tereze tha: *“E si mos ta kujtojmë tani, një bijë të zgjedhur të popullit shqiptar, Motrën Tereza të Kalkutës, nënë e shumë të varfërve ndër më të varfërit në botë? Me zjarrin e fesë në kraharor, kjo grua e vogël dhe e madhe njëkohësisht, sjell dhe ruan brenda vetes hovin e bujarisë së papërmbajtur dhe të pamposhtur të zemrës shqiptare”.*²⁶

Me rastin e “kthimit në Shtëpinë e Atit” – vdekjes së Nënës Tereze, (7 shtator 1997), Papa Gjon Pali II tha: *“Në këtë moment të lutjes më rri në zemër, që të kujtoj motrën tonë nga Kalkuta, Nënë Terezën, e cila para dy ditësh i dha fund jetës së vet të gjatë në tokë. Unë pata rastin ta takoj shpesh, dhe në kujtesën time rri figura saj e vogël plot jetë në shërbim të më të varfërve ndër të varfër; e cila ishte e përmbushur nga një forcë e brendshme e pashtershme: forca e dashurisë së Krishtit...Duke e gjurmuar Ungjillin, u bë për çdo njeri “samaritani i mirë”...Përderisa po ia besojmë Hyjit shpirtin e ngritur të kësaj rregulltarje të përshpirtshme dhe besimtare, e lusim Virgjërën Mari që t’u jape ngushëllim bashkëmotrave të saj dhe të gjithëve që e njohën dhe e deshën”.*²⁷

Papa Gjon Pali II lejoi përjashtimin kanonik dhe përshpejtimin e procesit të lumturimit të Nënës Tereze, dhe atë e lidhi me dy ngjarje tejet të rëndësishme: 25 vjetorin e Pontifikatit të tij në Selinë e Shën Pjetrit dhe Ditën Botërore të Misioneve. Në meshën e lumturimit të saj, në Sheshin e Shën Pjetrit në Vatikan (19 tetor 2003), ai ndër të tjera tha: *“Jam personalisht i falënderueshëm ndaj kësaj Gruaje të guximshme, të cilën gjithmonë e kam pasur afër vetes. Ikona e samaritanit të mirë, ajo shkonte gjithkund për ta shërbyer Krishtin ndër të varfër ndër më të varfër. As konfliktet dhe lufrat nuk e kanë ndaluar atë. Herë pas here vinte tek unë dhe më fliste për përvojën e saj në shërbim të vlerave ungjillore... Me ndjenja të thella jemi këtu për ta përkujtuar sot Nënë Tereze, shërbëtoreshen e madhe të të varfërve, të Kishës dhe të mbarë botës... Jeta e saj ishte e thadraur (??) në dashuri si shpallje e guximshme e Ungjillit...”.*²⁸

Duhet përmendur që, sipas dëshirës dhe kërkesës së Papës Gjon Pali II, janë përkthyer dhe botuar tre libra të Don Lush Gjergjit në polakishte, me tirazh milionash:

Madre della carita’ (Matka Teresa), 1994;

Vivere, Amare, Testimoniare, (Zyc’, Kochac’, Swiadczuc’), 1999;

dhe, për lumturimin e Nënës Tereze, L’amore in azione (Matka Teresz, Milosc w czynach), 2003.

Këto vepra autori ia ka paraqitur dhe dhuruar Papës personalisht, së bashku me botuesin italian VELAR

Papa Gjon Pali II dhe Shqiptarët

nga Bergamo, dhe botuesin polak Etërit Pallotinë nga Varsava.

Kulminacioni ishte ky: Papa i kërkoi këto botime në gjuhën polake dhe në gjuhët tjera: italisht, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, shpanisht...për t'ua dhuruar delegacioneve më të larta kishtarë dhe shtetërore gjatë vitit Jubilar 2000.

Më këtë dëshmoi edhe një herë nderimin dhe dashurinë ndaj së Lumes Nënës Tereze, si dhe ndaj Kishës dhe Popullit tonë.

Dhe në fund ta përmendi edhe këtë: Papa Gjon Pali II, ishte Miku i madh i Nënës Tereze, nëpërmjet saj edhe i Popullit Shqiptar. Qysh prej fillimit të Pontifikatit në Selinë e Shën Pjetrit (16 tetor 1978), deri të ndërrimi i jetës (2 prill 2005), për festa të mëdha si Kërshëndellat dhe Pashkët, Shën Pjetri, kur jipet Bekimi Apostolik "Urbi et Orbi" (Qytetit dhe Botës), gjithmonë ka folur dhe uruar edhe në gjuhën shqipe, bile ndër gjuhët më të para.

Edhe kjo, si dhe e tërë jeta dhe veprat e tija, dëshmojnë se na kishte në zemër.

1) Drita, Ferizaj, 1-2/1981, fq. 1; **2)** L'Osservatore Romano, 27-28. II. 1984, fq. 1; **3)** Drita, Ferizaj, 5-6/1986, fq. 1; **4)** Drita, Ferizaj, 7-8/1988, fq.1; **5)** Drita, Ferizaj, 3-4/5-6/1989, fq. 1; **6)** Selia e Shenjtë dhe kriza në Kosovë, Prizren, 2003, fq. 52 (8 mars 1998); **7/8)** Po aty, fq. 54 (9 gusht 1998); **9)** Po aty, fq. 54 (26 gusht 1998); **10)** Po aty, fq. 55(3 janar 1999); **11)** Po aty, fq. 56 (21 janar 1999); **12)** Po aty, fq. 57, (24 mars 1999); **13)** Po aty, fq. 58, (29 mars 1999); **14)** Po aty, fq. 58, (2 prill 1999); **15)** Po aty, fq. 59, (4 prill 1999); **16)** Zëri, gazetë e përditshme, 4 prill 2005, fq. 5; **17)** David Xhuxha, Papa në Shqipëri, Radio Vatikani – Drita, 1995, fq. 7; **18)** David Xhuxha, vep. e cit. fq. 9; **19)** Po aty, fq. 120; **20)** Më gjerësisht lexo: Selia e Shenjtë dhe kriza në Kosovë, vep. e cit. fq. 1-148; **21)** Mbi këtë lexo: Dr. Lush Gjergji, Nëna jonë Tereze, Drita, 1990, fq. 196-209; **22)** Lexo: Lush Gjergji, Nëna e Dashurisë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2000, fq. 218; **23)** Po aty, fq. 187; **24)** Nga dëshmia e gazetarit të njohur Italian Renato Farina dhënë Don Lush Gjergjit në Milano në vitin 1987. Më gjerësisht lexo: Drita, Ferizaj, 1-2/1989, fq. 1; **25)** David Xhuxha, Papa në Shqipëri, vep. e cit. fq. 36; **26)** Po aty, fq. 49-50; **27)** Don Pren Kola, Nënë Tereza, dëshmi, kujtime, meditime, mbresa, Fjala Hyjnore, Prishtinë, 2004, fq. 9-10; **28)** Lush Gjergji, Madre della carita', Velar, 2004, fq. 229-230.



Reka e Epërme përballë asimilimit gjuhësor e kombëtar

Mr.sc. Sejdi M.Gashi

Instituti Albanologjik, Prishtinë

Historia e Rekës së Epërme është histori komplekse dhe me vete ngërthen një varg shkaqesh e motivesh. Është histori sa krenare aq edhe trishtuese, pasi që përpjekjet e faktorit sllavë në Ballkan për ta tjetërsuar qenien shqiptare, përherë kanë qenë dhe janë prezent. Një gjë të tillë e thekson edhe gjuhëtari Qemal Murati kur thotë se *“në galerinë e komuniteteve etnike në Ballkan, rrallë mund të gjesësh një shembull tjetër të ngjashëm me atë të shqiptarëve ortodoksë të Rekës së Epërme të Gostivarit, të asimiluar etnikisht me metodat më jezuite sllave në elementin maqedonas, dhe pastaj për shkak se ata kanë ruajtur pjesërisht gjuhën e tyre amtare shqipe, të shpallur nga këta të fundit si sllavë të shqiptarizuar”* (Qemal Murati, Reka e Epërme-një fenomen ekzemplar asimilimi, në: Hetime e vjelje për gjuhën shqipe, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2012, fq. 70.).

Ndaj edhe qëllimi i këtij punimi është që propagandës armiqësore serbo-maqedonase, t'i kundërvihemi me fakte gjuhësore, historike dhe të tjera, që dëshmojnë autoktoninë shekullore të Qenies Shqiptare në Trevën e Rekës së Epërme.

Disa nga çështjet që do t'i trajtoj në këtë punim janë:

Kush janë shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme? Si trajtohen ata nga shkenca sllave? Si e ndiejnë vetën rekalinjtë e sotëm? Si ndodhi që gjuha shqipe “të këmbëhet” me atë maqedonase dhe në ç'rrethana ndodhi kjo?

Dihet mirëfilli që lufta e ashpër sllave për bjerren e qenies shqiptare është zhvilluar në disa fusha si në atë gjuhësore, historike, antropologjike, gjeografike, etnografike e folklorike, e pa dyshim që gjuha shqipe ka qenë më e sulmuara, pasi që vite më parë, studiuesi Eqrem Çabej, ka konstatuar që *“gjuha është një prej shenjave të para dalluese të kombësisë”*, dhe këtë pohim profesor Çabej e bëri me të drejtë. Më këtë mendim fuqishëm pajtohet edhe studiuesi Rexhep Qosja, - kur thotë se *“gjuha është biografi e popujve, sepse në gjuhë dhe me gjuhën, më mirë se në çdo dokument- material, ruhet historia e tyre intelektuale, sociale, morale”* (Rexhep Qosja, Panteoni i rralluar, Tiranë, 1988, fq. 621.)

Në Rekën e Epërme, krahinë kjo dikur me tipare të veçanta etnolinguistike, etnografike, por edhe racore, vite më parë gjëllinte një popullsi shqiptare ortodokse, që në kapërcyell të kohëve, qysh në vitet e dhunës sllave, duke filluar herët e më intensitet të shtuar ndërmjet viteve 1913, 1955 e më pas në vitet 1976, 1978, 1982, 1988 e deri në 1997, detyroi popullatën shqiptare të kësaj krahine të shpërngulet, kurse një pjesë tjetër iu nënshtrua asimilimit të egër, nga elementi shqiptar ortodoks, në elementin ortodoks sllavo-maqedonas.

Në rrugën e këtij asimilimi të egër, instrument kryesor i përdorur nga aparati i dhunës shtetërore serbo-maqedonase, ishte feja ortodokse.

Etimologjia e toponimit Reka

Në aspektin toponimik, Reka e Epërme (maq. Gorna Reka), emrin e sotëm e ka marrë nga fjala sllave *“reka”* (shq. *“lumë”*), pasi që siç dihet kjo krahinë e Malësisë së Mavrovës në masivin e Korabit, në afërsi ndërmjet kufirit shqiptaro-maqedonas, përshkohet nga rrjedha të shumta ujore që derdhen te Radika (emri i lashtë *Ardica*), (Qemal Murati, ibid., fq. 71)

Mbi historinë e Rekës dhe të rekalinjëve janë hartuar studime, që pos plejadës së të ashtuquajturve shkencëtarë sllavo maqedonas, rus e bullgar, nga ana e studiuesve perëndimorë, janë hartuar studime me vlerë shkencore e historike. Vlen të përmendim këtu studimin monografik të mjeshtrit të albanologjisë, Franc Baron Nopça, të titulluar *“Jeta e fshatarëve shqiptarë në Rekën e Epërme të Dibrës”*, përgatitur si dorëshkrim më 1914, por botuar në Vjenë në vitin 2007 nga studiuesi Robert Elsie. Ky studim monografik me mjaft vlerë, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe argumentuese, paraqet një tablo të një jete të zhdukur të shqiptarëve ortodoksë. Jo vetëm kaq, por ky studim i Nopçës, është i pasur edhe me materiale etnografike e gjuhësore, të përshkruara me mjeshtëri dhe akribi shkencore nga ky autor. Ky libër është përkthyer edhe në maqedonisht nga Bajazit Elmaz Doda.

Studime lidhur me Rekën janë bërë edhe nga N. Jokl dhe studiues tjerë me renome ndërkombëtare.

Në aspektin gjuhësor, nga analizat dhe hetimet e bëra nga Nopça-i dhe Jokl-i, nga pikëpamja etimologjike-gjuhësore, rezultojnë që 37% e fjalëve janë autoktone shqipe, 19% latine, 20 % sllave dhe 23% turke. Nga kjo shihet qartë se te njerëzit e Rekës së Epërme që gjuhë amtare kanë gjuhën shqipe, nuk ka asnjë mundësi tjetër,

Reka e Epërme përballë asimilimit gjuhësor e kombëtar

që ata të mos jenë shqiptarë, pasi që gjuhë amtare kanë shqipen, e nuk janë sllavë që flasin shqip, ashtu siç trumbeton propaganda sllave. Në aspektin e strukturës toponimike, Reka e Epërme, sipas regjistrimeve të vitit 1972 kishte 22 fshatra, kurse sot ka vetëm 17 fshatra, me popullsi të përzier shqipfolëse e maqedonase: Vërbjani (fshati më i madh i Rekës së Epërme, i banuar me popullsi shqiptare; Zhuzhnja, 23 shtëpi, 102 banorë. (Qemal Murati, ibid.)

Ndërkaq fshatrat e shpërngulur (shpopulluar) janë: Reçi, Strezimiri, Tërnica dhe Shtirovica, kurse fshatra të pastra shqiptare, sipas dialektologut maqedonas, Bozho Vidoeski (Božo Vidoeski, Debarskite gojori, Makedonski jazik., Institut za makedonski jazik” Krste Misirkov”, Skopje, 1968.) janë: Nivishta, Zhuzhnja, Vërbjani, Tanusha dhe Grekaj. Ndërkaq studiuesi shqiptar, Sejfedin Haruni, në studimin e tij, “E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit” (Sejfedin Haruni, E folmja shqipe e Rekës së Epërme të Gostivarit, Shkup, 1994.), thekson se fshatrat shqiptare kohëve të fundit po vijnë duke u pakësuar, kjo si pasojë e presioneve të ndryshme. Ndodh një gjë e tillë, marrë parasysh rrethanat politike, por edhe ekonomike, që kanë mbretëruar me vite të tëra e që po mbretërojnë edhe sot, pasi shteti i Maqedonisë, ndonëse aspiron integrimet euroatlantike, nga rrënjët e sistemit të vet kushtetues e politik ende nuk ka arritur që të largojë diferencimet mbi baza etnike.

Reka e Epërme me figura të ndritura të Kombit Shqiptar.

Treva e Rekës së Epërme, shquhet edhe për faktin se ka dhënë personalitete të rëndësishme në shumë fusha të jetës shoqërore. Ndër ta po përmendim, Josif Bagerin, rilindësin e shquar shqiptar nga Nistrova, i cili me talentin e rrallë, me veprimtarinë e tij të begatë intelektuale e patriotike u bë model i njeriut të civilizuar, i cili diti të çmojë vlerat njerëzore, të dojë e të çmojë kombin e tij, por të respektojë edhe pjesëtarët e përkatësive tjera etnike. Në këtë kontekst, është për t’u vlerësuar meritueshëm edhe figura e Branko Manojlovskit, me origjinë nga Reka e Epërme, i cili tash e 40- vjet jeton dhe punon në SHBA, por një pjesë të mirë të kohës e kalon në vendlindjen e tij. Gjatë vizitës që ai i bëri Kosovës, në qershor të vitit 2013, në takime me përfaqësues të Institucioneve të Republikës së Kosovës, ky atdhetar shqiptar ka rrëfyer fakte pikëlluese për fatin e rreth 300 mijë shqiptarëve ortodoks në Maqedoni, ringjalljes kombëtarëve të të cilëve, ua ka kushtuar jetën e tij prej misionari. Atdhetari Manojlovski, është shprehur optimist për suksesin e misionit të tij të vështirë: *“Shqiptarët ortodoks në Maqedoni po u kthehen rrënjëve. Dua që fëmijët tanë dhe fëmijët e fëmijëve tanë ta dinë se vijnë nga etër e gjyshër shqiptarë, e ta kuptojnë se gjaku ujë nuk bëhet”* (Pjesë nga deklarata e Branko Manojlovskit, gjatë vizitës në Prishtinë, në takim me kryeparlamentarin e Kosovës, Jakup Krasniqi, më 14 qershor 2013),- është shprehur veprimtari nga Reka e Epërme, duke përkujtuar rilindësin e madh shqiptar të asaj treve, Josif Bagerin.

Po ashtu nuk duhet harruar pa përmendur edhe intelektualin, poetin, përkthyesin e shquar, anëtarin e Akademisë së Shkencave të Maqedonisë, Mateja Matevski. I lindur në Stamboll, në një familje shqiptare të shpërngulur nga Reka, ndonëse deklarimin publik se është shqiptar e bëri relativisht vonë, një gjë e tillë nuk mund të mos mbetet pa vlerësuar.

Ky akt patriotik i Matevskit duhet të shërbejë si model për të gjithë ata që vetën e ndiejnë shqiptarë, që publikisht ta deklarojnë përkatësinë e tyre shqiptare, pasi që siç thotë një fjalë arbëreshe, *gjaku i arbrit ndonëse i shpërndarë, ai ende rron*.

Nga ana tjetër duhet të na mendojë fakti që “shqiptarët ortodoksë nuk janë komunitet zyrtar në Maqedoni, madje shumë prej tyre deri pak kohë më parë kishin frikë të deklaroheshin si shqiptarë... pasi që pushteti sllav shkoi deri në atë nivel sa që shumë familjeve shqiptare ua imponoi mbiemrat e rinj”¹ - sipas tipologjisë sllavo-maqedonase. (Qemal Murati, ibidem, faqe 160).

Për fund të kësaj paraqitjeje më lejon të theksoj se shqiptarët ortodoksë të Rekës së Epërme duhet ta kenë të drejtën e tyre historike që t’i rikthehen identitetit të të parëve të tyre shqiptarë. E jemi të bindur se një gjë e tillë do të arrihej vetëm atëherë kur faktori politik shqiptar do të ishte më i bashkuar, më i vetëdijshëm ndaj kësaj kauze kombëtare shqiptare dhe vetëm atëherë, do të ndikohej në përmirësimin e këtij fataliteti historik që më vite ka goditur këtë pjesë të trungut shqiptar. Këtë gjë nuk po e themi si dëshirë për vetën tonë dhe si urrejtje ndaj të tjerëve, por ky pohim yni i ka rrënjët mbi bazën e objektivave dhe parametrave etnik, historik, gjeografik, etnologjik, e gjuhësor.

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare

Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës

Prishtinë, Rruga Nënë Tereza, pn. KOSOVË

Tel. +38138 222 970

E-mail: seminari1974@yahoo.com, bardhrugova@yahoo.com, blerta.ismajli@gmail.com

Drejtor: Prof. asoc. dr. Bardh Rugova

Bashkëdrejtor: Prof. dr. Aljula Jubani

Sekretar: Prof. ass. dr. Nysret Krasniqi

Bashkësekretar: Prof. asoc. dr. Persida Asllani

Sekretar profesional: Mr. Blertë Ismajli

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është themeluar në vitin 1974 pranë Fakultetit të Filologjisë (atëherë: Fakulteti Filozofik) të Universitetit të Prishtinës. Ky Seminar organizohet për studentë e studiues që merren me probleme të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare, po edhe me albanologjinë përgjithësisht. Seminari ka zhvilluar gjithsej tridhjetë e dy sesione. Në vitin 1991 është ndërprerë veprimtaria e tij nga organet e dhunshme serbe. Në vitet 1995 e 1996 sesionet e këtij Seminari u mbajtën në Tiranë në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Nga viti 2000 Seminari zhvillohet sërish në Prishtinë. Sesionet 19 dhe 20 (2000-2001) janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Seminari XXXIII do t'i zhvillojë punimet në Prishtinë, nga 18 gusht – 30 gusht 2014

Arritja e seminaristëve në Kosovë, më 17 gusht 2014 (e diel).

Hapja solemne e Seminarit XXXIII, më 18 gusht 2014 në orën 11:00.

Programi bazë i Seminarit XXXIII:

1. Kurse intensive të mësimit të shqipes (tri shkallë); 2. Ligjërata të veçanta të gjuhësisë; 3. Ligjërata për letërsinë shqiptare; 4. Referime shkencore; 5. Ligjërata të përgjithshme; 6. Tryezë e rumbullakët; 7. Program kulturor plotësues për t'i njohur seminaristët me bukuritë natyrore, me veprimtaritë kulturore e të mira të tjera në qendra të Kosovës.

Sesioni Shkencor (29 – 30 gusht 2014)

- Gjuha shqipe dhe ideologjia
- Letërsia shqipe dhe kodet e mëdha

Drejtorja e Seminarit do t'i mbulojë shpenzimet e vendosjes dhe të ekskursioneve eventuale në Kosovë. Shpenzimet e rrugës për Prishtinë dhe e kundërta i heqin vetë pjesëmarrësit. Paraqitja për të marrë pjesë në

Seminarin XXXIII duhet të arrijë në Drejtori të Seminarit deri më 24 qershor 2014 në një prej adresave të sipërsënuara.

Drejtorja e Seminarit

Disa nga publikimet shkencorë të prof. dr. Imri Badallaj-t

Të fillosh e të mbarosh, mbrenda dyzetë vjetsh, tërë karrierën universitare tek (pothuaj) i vetmi Universitet Shtetëror i Kosovës, ture pësuar hallet e dy diktaturash serbe, s'është punë e le. Të mos mendosh - as ndë mes t'tragjedisë së një gjenocidi etnik - të pështosh mëgjakun me familje e t'lypsh azil politik, s'është i gjithëve. Kur 't'qëndrosh' është marrëzi, i marri qëndron. Profesori realist 'ka e s'ka' besë tek e nesërmja; e, përveç punës universitare, punon edhe në t'jerë sektore. Imri Badallaj bën profesorin e fare mëgjë. Mijëra trima e vasha i mëson, i diplomon; qindra e qindra i bën magjistra, doktorë e profesorë. Merr pjesë në pakund Kuvende, Seminare, Kongrese, jashtë e mbrënda Kosovës. E harron edhe të mbanjë llogarinë më të thjeshtë. Së fundi, u bind të vërë rregull në Bibliografinë e tij. (D.)

- Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit, *Gjurmime albanologjike*, nr.5, Prishtinë, **1976**
- Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë, *Zëri i Arbëreshvet*, nr. 10, Eianina (Itali), **1977**
- Veçoritë e zanoreve hundore dhe vlara e tyre fonologjike, *Bota e re*, nr.9 -10, Prishtinë **1978**
- Reflektimi i nazalizimit në toponime dhe mikrotoponime të lokalitetit të Zhurit, *Onomastika e Kosovës - edicion i Institutit Albanologjik*, Prishtinë , **1979**
- Edhe diçka rreth nazalizimit në gjuhën shqipe, *Rilindja*, nr. 6884, Prishtinë , **1979**
- Kapërcimi i disa veçorive dialektore në shkollën tonë, *Bota e re*, **1980**
- Disa fenomene fonetike në të folmen e Hasit, *Gjurmime albanologjike*, nr. 16, Prishtinë, **1988**.
- Vendi dhe karakteri i theksit në të folmen e Hasit, *Gjurmime albanologjike*, nr. 21, Prishtinë, **1992**.
- Sistemi konsonantik i së folmes së Hasit, *Gjurmime albanologjike*, nr. 23, Prishtinë, **1993**.
- Rreth kuantitetit të vokaleve në “ Mesharin” e Gjon Buzukut, *Seminari XVII Ndërkombëtar për Gjuhën , Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Tiranë **1995**.
- Realizime dialektologjike në sferën e shqipes, *Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Tiranë, **1996**.
- Format e kohës së ardhme të shqipes krahasuar me ato të serbishtes, *Seminari XVIII Ndërkombëtar për Gjuhën , Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Tiranë , **1996**.
- Probleme të objektit dhe të metodës së studimeve në sferën e dialektologjisë, *Filologji*, nr.1, Prishtinë **1996**.
- Sistemi i zanoreve në të folmen e Hasit , *Filologji*, nr. 2, Prishtinë **1996**.
- Maksimilian Lamberci - albanolog i shquar, *STUDIME,(ASHAK)* , nr.3, Prishtinë , **1997**.
- Vështrim mbi sistemin foljor të së folmes së Hasit, *Filologji*, nr.3, Prishtinë **1997**.
- Karakteri i nazalizimit në gjuhën shqipe , *Dardania sacra*, nr.1, Prishtinë **1999**.
- Disa pikëpamje të Eqrem Çabejt rreth kuantitetit të vokaleve të shqipes, *Filologji*, nr. 8, Prishtinë **2000**.
- Rreth paskajores në gjuhën shqipe, *Seminari XIX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, **2001**.
- **E FOLMJA E HASIT**, (monografi, 302 fq.), Prishtinë **2001**
- Nyjat në të folmet e Vërrinit, *Seminari XXI Ndërkombëtar për Gjuhën , Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, **2001**.
- Maxmilian Lambert per gli Arbëreshë, *Jeta Arbëreshe*, nr.1, Eianina (Italia), **2002**.
- Përmbledhje punimesh : Norbert Jokli (1877-1942) - albanolog i shquar austriak, Universiteti i Shkodrës “ Luigj Gurakuqi” Shkodër , **2003**.
- Rreth konceptit të Eqrem Çabejt mbi kuantitetin dhe vlerën fonologjike të vokaleve të shqipes, në *Përmbledhje kumtesash shkencore, të mbajtura në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Eqrem Çabej dhe Kultura Shqiptare”* , Gjirokastrë , **2004**.
- Revista “Jeta Arbëreshe” dhe rëndësia e saj në ruajtjen e italo-arbërishtes, në *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë **2004**.

Disa nga publikimet shkencorë të prof.dr. Imri Badallaj-t

- Rreth programeve të gjuhës shqipe në Kosovë, në *Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar*, Tiranë, **2004**
- E ardhmja e minoritetit arbëresh, në “*Jeta Arbëreshe*”, nr. 31 – 32, Eianina, Itali, **2004**
- Rreth fjalorëve të Gjorgje Pulevskit, në *Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë*, Tiranë **2005**.
- Shqip, shqiptar, Shqipëri, në “*Jeta Arbëreshe*”, nr 33, Eianinë, Itali, **2005**
- Meshari i Gjon Buzukut, në “*Jeta Arbëreshe*”, nr 34, Eianinë, Itali, **2005**
- Risi në programet e shqipes në Kosovë, “*Jeta Arbëreshe*”, nr 36, Eianinë, Itali, **2005**
- Carlo Tagliavini, gjuhëtar me përmasa të mëdha, në “*Jeta Arbëreshe*”, nr 40, Eianinë, Itali, **2005**
- Figura e Skënderbeut në revistën “Ekskluzive”, në “*Jeta Arbëreshe*”, nr 42, 43, 44, Eianinë, Itali **2005**
- Presidenti dr. Ibrahim Rugova, në “*Jeta Arbëreshe*”, nr 44, Eianinë, Itali, **2006**.
- E ardhmja e minoritetit arbëresh, “*Jeta Arbëreshe*”, 31-32. Eianinë (ITALI), **2006**.
- Kontributi i Emanuil Xhordanit në leksikografinë arbëreshe, *Filologji*, nr.14, Prishtinë, **2006**.
- Rreth pikëpamjeve të Idriz Ajetit mbi fonetikën historike të shqipes, *Studime (ASHAK)*, Prishtinë, **2006**.
- Si është ruajtur italo-arbërishtja, *Filologji*, nr. 15, Prishtinë **2007**.
- Shqipja standarde dhe dialektet e saj, *SNGJLKSH*, Prishtinë, **2007**.
- Koncepti i Eqrem Çabejt mbi kuantitetin e vokaleve të shqipes, *SNGJLKSH*, Prishtinë, **2008**.
- Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së prof. Eqrem Çabejt, “*Jeta Arbëreshe*”, nr. 57,(Itali), **2008**.
- La figura di Scanderbeg nella rivista “Ekskluzive”, në *Giorgio Castriota Scanderbeg nella storia e nella letteratura*, Napoli (ITALI), **2008**.
- Arbëreshët e Italisë dhe ruajtja e gjuhës së tyre, në *Seminari 27 Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë **2009**.
- Atlasi dialektologjik i gjuhës shqipe, në *Koha për kulturë*, nr. 4191, Prishtinë **2009**.
- Pse çalon realizimi i shqipes standarde, në *Jeta Arbëreshe*, nr. 63, Eianina (Itali), **2009**.
- Edhe një Fjalor i italo-arbërishtes, në *Jeta Arbëreshe*, nr. 67, Eianina (Itali) **2010**
- Vështrim mbi tipat e formave foljore me vlerën e së ardhmes, në *vëllimin e punimeve të Konferencës shkencore: Çështje të studimeve diakronike të shqipes* (botim i ASHAK), Prishtinë **2010**.
- **CHIEUTI E LA SUA PARLATA ARBËRESHE** (Imri Badallaj - Mario Massaro), Mo nografi , 598 faqe), Apricena (Fg, Itali), **2010**.
- Sa, dhe si, realizohet shqipja standarde në shkollë dhe në universitet, në ‘*Shqipja në etapën e sotme: Politikat dhe e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit*’, Tiranë **2011**.
- Dy fjalorët e Gjorgje Pulevskit, në *Filologji*, nr 18, Prishtinë **2011**
- Mbi veprimtarinë gjuhësore të profesor Besim Bokshit (Në 80-vjetorin e lindjes), *Studime* nr. 18, (Organ i ASHAK), Prishtinë **2012**.
- Mbi Gramatikën historike të shqipes të autorit akademik Kolec Topalli, në *Studime* (rev. e ASHAK), Prishtinë **2012**.
- Në dhjetëvjetorin e Jetës Arbëreshe, në *Jeta Arbëreshe*, nr. 72, Eianina (Itali), **2012**.
- Infinitivi në shqipen dhe në serbishten, në ‘*Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit*’, Prishtinë **2012**.
- Si shkruanin autorët italo-arbëreshë para Kongresit të Manastirit, në ‘*Studime për nder të Rexhep Ismajlit*’, Prishtinë **2012**.
- Studimet e Bojka Sokolovës mbi të folmet e shqiptarëve të Mandricës, në *Seminarin XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë **2013**.
- Qëndresa shumëshekullore italo-arbëreshe, në *Jeta Arbëreshe*, nr. 73, Eianina (Itali), **2013**.

Ndodhen në procesin e botimit dy vëllime:

- Vrojtme gjuhësore (580 faqe)
- La parlata Albanese di Casavecchio di Puglia (335 faqe).

(1- është më)

Arbëria ndër revistat shqiptare**Gjuha Jonë**

(revistë gjashtëmujore e Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë)
(1981-2002)

E.Lafe, V.Bici, Kursi i parë i gjuhës shqipe dhe i kulturës shqiptare në Shën Mitër dhe Mbuzat (Kalabri), jeta shkencore, Gjuha jonë, 1/81,f.128

Shkurtaç Gjo., Arritje të studiuesve të sotëm arbëreshë në fushën e shqipes, Gjuha jonë, 2/81,f.91

Varfi Andrea, Sesion shkencor kushtuar 250-vjetorit të themelimit të Kolegjit arbëresh të Sh.Adrianit, jeta shkencore, Gjuha jonë, 1/83,f.121

Xoxi K., Në Shën Mitër Koronë (Itali) përkujtohet 250-vjetori i Kolegjit të Sh.Adrianit, jeta shkencore, Gjuha jonë, 2/83,f.116

Bala Vehbi, Ndriçimtari I shquar Jeronim De Rada, Gjuha jonë, 2/84,f.90

Altimari Françesko, Vëzhgime mbi mësimin dhe përdorimin e shqipes letrare në mjedisin arbëresh, Gjuha jonë, 2/85,f.63

Shkurtaç Gjo., Arbërishtja e Italisë si gjuhë e shkruar, Gjuha jonë, 2/86,f.42

Kastrati Jup, Gramatika e pare e gjuhës shqipe (1716) dhe autori i saj, Gjuha jonë, 4/86,f.93

Fortino Italo Kostante, Rreth gjuhës së Arbëreshëve të Italisë, Gjuha jonë, 3/88,f.31

Çeliku M., Kurs i gjuhës së sotme letrare shqipe në Sicili, - jeta shkencore, Gjuha jonë, 4/88,f.111

Fionda Pjetër, Fjalë nga Arbëreshët e Italisë, Gjuha jonë, 1/89,f.84

Shkurtaç Gjo., Shoku Enver Hoxha për Arbërishtët e Italisë dhe gjuhën e tyre, Gjuha jonë, 2/89,f.16

Skirò Di Maxho Xhusepe, Nga arbërishtja te shqipja, Gjuha jonë, 1/91,f.41

Xhiku Ali, Zef Skiroi ndër mëdyshjet e zhvillimit të shkrimit të shqipes, Gjuha jonë, 1-2/99,f.18

Fortino Italo Kostante, Seminar për Mitrush Kutelin në Institutin Universitar Oriental të Napolit, jeta shkencore, Gjuha jonë, 1-2/99,f.132

Lafe Emil, Françesko Solano (18/11/1914-20/3/1999), nekrologji, Gjuha jonë, 1-2/99,f.138

Turano Xhusepina, Tipare leksikore e sintaksore të disa foljeve shqipe dhe arbëreshe, Gjuha jonë, 1-2/2002,f.54

Belusho Xhani, Drejtime te politikës gjuhësore të monarkisë dhe te republikës në dokumente syrtare të shtetit shqiptar, Gjuha jonë, 1-2/2002,f.66

Fortino Italo Kostante, Seminari “Vepra dhe gjuha e Ndre Mjedës” në Institutin Universitar të Napolit, jeta shkencore, Gjuha jonë, 1-2/2002,f.134

Samara Miço, Veprimtari shkencore për veprën e J.Varibobës, jeta shkencore, Gjuha jonë, 1-2/2002,f.136

Shkurtaç Gjo., Kongresi XXVIII ndërkombëtar i studimeve shqiptare në Sicili, jeta shkencore, Gjuha jonë, 1-2/2002,f.138

Arësimi Popullor

(e përnuajshme arësimore, organ i Ministrisë së Arësimit dhe Kulturës, Tiranë)
(1961 -)

Çabej Eqrem, Poezia popullore e Arbëreshve të Italisë, Are.Pop.,10/1961,f.78

Revista Pedagogjike

(organi i Institutit të Studimeve Pedagogjike, Tiranë)
(1972 (XXVII)-1990)

Kastrati Jup, De Rada për shkollën shqipe, Re.Ped.,5/1972,f.145

Shuteriqi S.Dhimitër, Një rilindës arbëresh i orëve të para, Ëngjëll Bazile, Re.Ped.,6/1973,f.101

Sinani Beqir, Jeronim De Rada dhe katedra e gjuhës shqipe, Re.Ped.,2/1974,f.134

Arbëria ndër revistat shqiptare

Revista Pedagogjike

Çabej Eqrem, Disa burra të shquar të arbëreshëve të Italisë, Re.Ped.,4/1974,f.140

Kastrati Jup, Katedra e gjuhës shqipe ndër Arbëreshët themeluar nga Jeronim De Rada, 1849-1852, 1889-1903; Re.Ped.,3/1977,f.116

Kashari Qazim, Kolegji arbëresh i Shën Adrianit, vatër e rëndësishme arsimit dhe kulture, Re.Ped.,2/1983,f.100

Shkurtaj Gjo., Gjuha shqipe në shtypin e sotëm të arbëreshëve të Italisë, Re.Ped.,3/1989,f.119

Studime Historike

(revistë tremujore, Akademia e Shkencave e RPSH, instituti i Historisë, Tiranë)

(1966 (XVI ?) - 2003)

F.L., Botime historike me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, jeta shkencore - Stu.Hist., 3/67, f.249

Bihiku Koço, Traditat e epokës së Skënderbeut në historinë e arbëreshëve të Italisë, Stu.Hist., 1/68, f.113

Kondo Ahmet, Të dhëna mbi lëvizjen tonë kombëtare në letërkëmbimin e Efthim Mitkos me De Radën (1879-1888), Stu.Hist., 1/69, f.103

Kastrati Jup, Arbëreshët për ruajtjen e studimin e trashëgimisë kulturore të popullit tonë, Stu.Hist., 3/76, f.91

Bala Vehbi, Francesco Guida: Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale Albanese – kritikë e bibliografi - Stu.Hist., 4/84, f.185

Malltezi Luan, Lorenzo Tacchella:Giorgio Kastrioti Skanderbeg e i romani pontefici nel sec.XV, Verona '87, recension - Stu.Hist.,1/90, f.229

Mehmeti Drita, Të dhëna mbi qëndrimin e Italisë ndaj kryengritjes shqiptare te vitit 1911, Stu.Hist.,2/90, f.113

Dedja Sokol, Emigrimi shqiptar në Itali në fund të mesjetës si problem historiografik, Stu.Hist.,1-2/2001, f.7

(7 - është më)

meritojnë një statore: janë e mbledhjen gjithë atë ç'është pa mbledhur, gjithë fjalët që gjëjnë ndër katundet arbëreshë. Po ish mirë të shtijin informatorët e tyre jo vet t'e foljnë arbrishtin po edhe t'e shkruajnë. Ka fjala ka t'shkoket te penda. Vet kështu një popull rritet. Vet kështu ka një t'ardhme.

Scilippa Marg, *Trëndafilë rërje - poezi / Rose di sabbia, poesie*, Pitti Edizioni Palermo 2014

I pari libër poezish është një *mbëkat*, i dyti një '*ëthe e hollë*'. E poetesha jonë - që ka për shoq një vullkan si Zef Skjirò i Majit, s'ka më mundësi të shërohet: o digjet o frymëzohet. Margeritës i vate mirë. E fizionomia 'saj poetike qëndron e freskët, origjinale, më e pjekur. Urime, Marg, e...kujdes vullkanit!

Frate Giovanni, *La Corsa dei Carri nella diocesi di Larino*, Grafiche Arcobaleno, Ururi (Cb) 2013

Një zakon i moçëm "Rrjedhja e qerrevet"/la Carrese që intereson tre katunde arbëreshë (Qefi, Ruri, Portkanuni) e një të ish-arbëresh (San Martino in Pensilis), në Dioqezën e Larino-s. Autori ynë shkruan poezi arbëreshë të bukura, po pra, kur folen për folklor e histori, na shkruan lëtisht. Po ka ky libër xëmi aq shurbise të rea. Të venë përpara, sa më shumë, kërkime mbi folklorin si këta, ku zakoni nani lidhet ngusht me dokumentet e nani... zgjidhet.

Perri Francesco, *Pasquale Scura - l'Italia una e indivisibile - La sua vita attraverso i documenti*, Lepisma edizioni, Roma 2011

Libre si ky i Perrit o si i V.Librandi-t (mbi Vakarinin), si i I.Elmit (mbi Shën Bendhitin), etj...çë kërkimevet historikë i kushtuan vitra, dalshin nga vit më shumë. Arbërisë libre si këta i duhen si buka. Njera sot vënë përpara me kujtimet e popullit e me dokumente të s'trejtës dorë. Zëm e shkruami historinë tonë të vërtetë: shohmi si, e njera ku, përputhen kujtesa e popullit me dokumentet e arkivevet e bibliotekavet. I bëmi nderë Arbërisë e jemi më të besueshëm.

Fusca Francesco, *Scritti - tra Pedagogia e Letteratura*, Edizioni Espressiva, Spezzano Albanese 2013

Mbi këtë libër të F.Fuskës shkruan këto katër rreshta sepse, ndë mes t'gjithë libret e artikujvet ç'shkruajti, te gjithë kuvendet ç'organizoi e ku foli, problemin e arbëreshvet e patë ngaherë në grietë. Po shkruajti pak arbrisht, pak muaj bëri Proveditorin Kosenxë. Frank Fuska bëri e bën, po mund t'kish bën edhe më shumë. Hereherë marrmi nj'udhë e s'priremi më prap. Gjuha arbëreshë i hapën horizontet, s'i mbëllin. Këtu nderonj pendën e palodhshme te mikut. Spixanjot e poet.

Bellusci Costantino, **D'Agostino Flavia**, *Arbashkuar, Fjalor ilustruar italisht - arbërisht - shqip*, mbi Historinë dhe Gjuhën e katundavet arbëreshë të Firmozës, Fermës, Ungrës, Picilisë, Spixanës dhe krahasuar me gluhan shqipe, vol.III, Ediz.Orizzonti Meridionali 2014.

Duall i trejti vëllim i Arbashkuar-it. Këta dy autorë

Fjalorth Arbërisht - Lëtisht

(vjen ka faqja 54)

protopapas Emanuele Giordano

albanolog ka Frasnita (Cs)

hajdhjër-e *agg.* nobile, gentile, corretto
 halë-a *sf.* spina, lisca di pesce, resta della spiga
 halkom-i *sm.* rame
 halkomë-a *sf.* caldaia di rame
 hap-i *sm.* passo
 hapashala *avv.* a cavalcioni
 hapënj *v.tr.* aprire, divulgare
 hapësirë-a *sf.* atmosfera, estensione, spazio, distesa
 hapët *avv.* apertamente, palesemente
 haraksënj *v.intr.* alberggiare, far giorno
 hardhagjël-i *sm.* specie di uva dal chicco lungo
 hãrdhël-dhla *sf.* lucertola
 harë-ja/-a *sf.* gioia, allegria, esultanza
 harepsënj *v.tr.* rallegrare; *pass.-em* rallegrarsi
 haresh-ëm (i,të) -shme *agg.* allegro, lieto, ilare
 harezë-a *sf.* gioia
 haristisënj *v.tr.* ringraziare
 harràm-e *agg.* smemorato, distratto
 harrim-i *sm.* dimenticanza, oblio
 harronj *v.tr.* dimenticare, trascurare
 hekur-i *sm.* ferro, catena, ferro da stiro
 hekuri-a *sf.* ferramenta, attrezzi di ferro
 hekurt (i,e,të) *agg.* ferreo, di ferro
 helm-i *sm.* dolore, amarezza; veleno
 hëlmëz-mza *sf.* singhiozzo
 helmonj *v.tr.* addolorare, amareggiare; avvelenare
 helmor-e *agg.* dolente, doloroso, infausto
 helmuar (i,e,të) *agg.* triste, addolorato, mesto
 helq *v.tr.* tirare, attirare, trascinare
 helqur (i,e,të) *agg.* attratto, tirato, condotto
 hell-i *sm.* spiedo; spada
 herehërë *avv.* a volte
 hëret *avv.* un tempo, anticamente, una volta
 herë-a *sf.* ora, orario; volta, tempo, occasione; fato
 hershëm (i,të) hershme (e) *agg.* di allora, di un tempo
 hënë-a *sf.* luna
 hënë-a (e) *sf.* lunedì
 hënëz-nza *sf.* luna
 hëngëllim-i *sm.* nitrito
 hi-t /-u *sn.sm.* cenere
 hidhërim-i *sm.* afflizione, dolore, amarezza, ira
 hilnar-i *sm.* lucerna, lanterna, lampada
 hinj *v.intr.* entrare
 hipënj *v.tr.* salire
 hir-i *sm.* grazia, favore; piacere, desiderio

hirëplotë (i,e,të) *sm.* avvenente, pieno di grazie
 hirrë-a *sf.* siero
 histori-a *sf.* storia
 hith-i (-it) *sm.sn.* ortica
 hjë-a *sf.* ombra; onore, grazia, protezione; fantasma
 hjëdhur (i,e,të) *agg.* ventilato, mondato
 hjemàth-dhe *agg.* onorabilissimo, amatissimo
 hjersë-a *sf.* terreno incolto, terreno sterile
 hjeshëm (i,të) -shme (e) *agg.* bello, avvenente
 hjetë-a *sf.* treccia
 hjëtull-a *sf.* nastro con cui si intrecciano i capelli
 hjeth *v.tr.* ventilare, lanciare, versare, diffondere
 hjidhem *pass.di* hjeth preciparsi, avventarsi
 hjidhi-a *sf.* amarezza, abbattimento, malinconia
 hjimaz *avv.* in campagna, in giù, fuori
 hjiromerë-t / -i *sn.sm.* lardo
 hjiropane-ja *sf.* straccio, cencio da cucina
 hjirovol-i *sm.* manipolo di spighe di grano
 hol-i *sm.* arnia, favo di miele
 holla-t (të) *sf.pl.* denaro; legna sottili da ardere
 hollë (i,e,të) *agg.* fino, sottile, delicato; astuto
 hollësisht *avv.* sottilmente, minuziosamente
 hon-i *sm.* burrone, baratro, abisso
 hòpti-hòpti *avv.* a cavallo, al trotto
 horë-a *sf.* città
 horrjàt-e *agg.* poveretto, smemorato, sciagurato
 hroazë-a *sf.* dipinto, figura, ritratto
 hu-ri *sm.* palo, bastone, manico; batosta
 hua *avv.* in prestito
 huaj (i,e,të) *agg.* forestiero, straniero; nemico; ospite
 huanj *v.tr.* prestare
 hudhër-dhra *sf.* aglio; colazione
 hullonj *v.tr.* affinare, snellire, aguzzare
 humbënj *v.tr.* perdere, smarrire, distruggere
 humbje-a *sf.* perdita, smarrimento; rovina
 hundë-a *sf.* naso, puntiglio, broncio
 hundëngrëjtur (i,e,të) *agg.* schifiloso, altezzoso
 hundim-i *sm.* amante, sposo; affanno; vergogna
 hundonj *v.tr.* imbambolare, meravigliare, rimbecillire
 hunduar (i,e,të) *agg.* meravigliato, sorpreso, afflitto

(Fjalë të nxjerra ka "Fjalori" i E.Giordano-s / është më)